



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____.2026

VENDIM

Nr. XX, datë XX.XX.2026

PËR LANDFILLET E MBETJEVE¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, 7 dhe 9 të nenit 34, pika 4 e nenit 35, pika 4 e nenit 36, dhe nenin 80 të ligjit nr. 57, datë 16.10.2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

OBJEKTI DHE QËLLIMI

1. Me qëllim reduktimin e depozitimit të mbetjeve në landfill, veçanërisht të mbetjeve që mund të riciklohen ose t’i nënshtrohen proceseve të tjera të rikuperimit, si dhe për kalimin drejt një ekonomie qarkulluese, parandalimit të ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, tokës, ajrit dhe mjedisit në tërësi, përfshirë ndikimet klimatike dhe ato të gazeve me efekt serrë dhe rreziqet për shëndetin e njeriut gjatë gjithë ciklit të jetës së landfillit, ky vendim përcakton:
 - a. kriteret, procedurat dhe standardet për studimin, projektimin, ndërtimin, funksionimin dhe mbylljen e landfilleve;
 - b. procedura dhe kriteret për pranimin e mbetjeve në landfill dhe kryerjen e një vlerësimi për sigurinë e asgjësimit nëntokësor të mbetjeve sipas Shtojcës 2 dhe Shtojcës 5;
 - c. kërkesat për reduktimin progresiv të asgjësimit të mbetjeve në landfill, veçanërisht të mbetjeve

¹ Ky vendim transponon direktivën e Këshillit 1999/31/EC të 26 prillit 1999 për landfillet e mbetjeve (31999L003. OJ L 182/1, datë 16.7.1999, dhe vendimin e Këshillit 2003/33/EC të 19 dhjetorit 2002, (32003D0033), i cili vendos kriteret dhe procedurat për pranimin e mbetjeve në landfill, në zbatim të nenit 16 të shtojcës II të direktivës 1999/31/EC. OJ L 11/27, datë 16.1.2003.

- që janë të përshtatshme për riciklim ose rikuperime të tjera;
- ç. masat dhe procedurat për parandalimin e efekteve të sipërpërmendura.
 - d. kërkesat për raportimin dhe mbledhjen e të dhënave për trajtimin e mbetjeve në landfill-e;
 - dh. rregullat dhe procedurat për garancitë financiare të landfill-it;
 - e. rregullat për llogaritjen e përmbushjes së objektivave të përcaktuara në strategjinë dhe planin e menaxhimit të integruar të mbetjeve, si dhe përjashtimin dhe ndalimin e pranimit në landfill të kategorive të caktuara të mbetjeve, përfshirë mbetjet e përshtatshme për riciklim ose për ndonjë lloj tjetër rikuperimi si dhe
 - ë. dispozitat kalimtare për landfill-et ekzistuese dhe venddepozitimet që janë në funksionim.

Neni 2

PËRKUFIZIME

1. Termat “mbetje”, “mbetje e rrezikshme”, “mbetje jo e rrezikshme”, “mbetje bashkiake”, “krijues i mbetjeve”, “zotërues i mbetjeve”, “menaxhim i integruar i mbetjeve”, “grumbullim i diferencuar”, “rikuperim”, “përgatitje për ripërdorim”, “riciklim”, “asgjësim”, “landfill”, “lëng kullues”, “mbetje inerte”, “mbetje bio”, “mbetje e lëngshme”, “person”, kanë kuptimin që u është dhënë sipas ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
2. Për qëllimet e këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a. “Eluat” ose “lëndë e holluar” nënkupton solucionin që përftohet nga një test lëngëzimi në kushte laboratorike;
 - b. “Gaz i landfillit” nënkupton të gjithë gazrat e gjeneruar nga asgjësimi i mbetjeve në landfill;
 - c. “Kërkues” është çdo person që kërkon një leje mjedisi në bazë të këtij vendimi dhe legjislacionit përkatës në fuqi.
 - ç. “Mbetje e biodegradueshme” nënkupton çdo mbetje që është e aftë t’i nënshtrohet dekompozimit anaerobik (në mungesë të oksigjenit) ose aerobik (në prani të oksigjenit), siç janë mbetjet ushqimore, mbetje bimore nga kopshtet dhe parqet, letra e kartoni.
 - d. “Operator” nënkupton personin që është përgjegjës për landfillin në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. Personi përgjegjës në fazën e përgatitjes mund të jetë i ndryshëm nga personi përgjegjës në fazën e kujdesit të mëtejshëm pas mbylljes së landfillit.
- dh. “Qendër banimi e izoluar” nënkupton një qendër:
 - i. me jo më shumë se 500 banorë për njësi administrative apo bashki dhe jo më shumë se 5 banorë për kilometër katror; dhe
 - ii. ku distanca nga qendra urbane më e afërt me të paktën 250 banorë për kilometër katror është jo më pak se 50 km, ose ka akses të vështirë rrugor në qendrat më të afërta urbane, për shkak të kushteve meteorologjike gjatë një pjese të rëndësishme të vitit.
- e. “Ruajtje nëntokë” është një strukturë e ruajtjes së përhershme të mbetjeve në një zgavër të thellë që ofron stabilitet gjeologjik, tipikisht 200 deri në 1000 metra nëntokë, si për shembull një minierë kaliumi ose kripe.
- ë “Trajtim” nënkupton proceset fizike, termike, kimike ose biologjike, përfshirë edhe ndarjen, të cilat ndryshojnë karakteristikat e mbetjeve me qëllim që të pakësojnë vëllimin dhe natyrën e rrezikshme të tyre, të lehtësojnë manovrimin ose të rrisin rikuperimin e tyre.

- f. “Vendndodhja/vendi i landfillit ekzistues” nënkupton vendndodhjen e një landfilli të pajisur me leje mjedisi dhe që është operacional në datën kur ky vendim hyn në fuqi.

Neni 3

FUSHA E ZBATIMIT

1. Dispozitat e këtij vendimi janë të aplikueshme për të gjitha landfillet sipas përkufizimit të pikës 17, të nenit 4, të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
2. Për qëllime të këtij vendimi, janë të përjashtuara nga fusha e veprimit:
 - a. Përhapja e llumrave, përfshirë llumrat nga trajtimi i ujërave të ndotura dhe ato nga pastrimi i kanaleve/përrenjve, si dhe ato nga aktivitetet e gjurmimit, apo llumra të ngjashme që shtrohen mbi tokë, kur kanë qëllim plehërimin ose përmirësimin e saj;
 - b. Përdorimi i mbetjeve inerte, që janë të përshtatshme e që përdoren në punime rihvillimi/restaurimi dhe punime mbushëse ose për qëllime ndërtimi në landfillë;
 - c. llumra të tjera jo të rrezikshme, që depozitohen përgjatë kanaleve/përrenjve, në ujërat sipërfaqësore, në shtratin e tyre dhe nën këtë shtrat;
 - ç. menaxhimi i mbetjeve që krijohen nga industritë nxjerrëse tokësore, pra mbetjet që krijohen nga kërkimi, nxjerrja, përfshirë fazën e zhvillimit para prodhimit, trajtimin dhe ruajtjen e burimeve minerale si dhe nga punimet e guroreve, për sa trajtohen nga legjislacioni i posaçëm.
3. Dispozitat e pikës 4 të nenit 6, gjurmës “g” të pikës 1 të nenit 8, gjurmës “d” të pikës 1 të nenit 9, pikës 1 të nenit 16, pikave 1 dhe 2 të nenit 11, pikave 1 dhe 5 të nenit 12, Shtojca I, seksionet 3 dhe 4, Shtojca II, seksioni 1.3.3 dhe Shtojca III, seksionet 3 dhe 5, nuk zbatohen për:
 - a. vendet e landfillëve ekzistues për mbetjet jo të rrezikshme ose inerte me një kapacitet total që nuk tejkalon 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) tonë ose me një prurje vjetore që nuk tejkalon 1 000 (një mijë) tonë, që funksionojnë në ishuj e kur ky është i vetmi landfill në atë ishull dhe është i destinuar ekskluzivisht për asgjësimin e mbetjeve të gjeneruara në atë ishull. Çdo vend i ri landfilli që ndërtohet në ishull (pasi kapaciteti total i këtij landfilli ekzistues të jetë përdorur) do të plotësojë kërkesat e këtij vendimi;
 - b. vendet e landfillëve të mbetjeve jo të rrezikshme ose inerte në qendra banimi të izoluar, në qoftë se vendi i landfillit destinohet për asgjësimin e mbetjeve të gjeneruara vetëm nga ajo qendër banimi e izoluar.

KREU II

KËRKESA PËR LANDFILLET

Neni 4

KATEGORITË E LANDFILLEVE

Landfillët klasifikohen në tri kategori:

- a. landfillë për mbetjet e rrezikshme;
- b. landfillë për mbetjet jo të rrezikshme;

- c. landfille për mbetjet inerte.

Neni 5

MBETJET DHE TRAJTIMET E PËRJASHTUARA NGA LANDFILLET

1. Nuk pranohen në landfill:
 - a. mbetjet e lëngshme;
 - b. mbetjet që, në kushtet e landfillit, janë shpërthyes, gërryese, oksiduese, të djegshme ose shumë të djegshme, siç përcaktohen në shtojcën 3 të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;
 - c. mbetjet spitalore që krijohen nga qendrat mjekësore ose veterinare, që janë infektuese (përbërësi HP 9), siç përcaktohen në shtojcën 3 të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;
 - ç. mbetjet e substancave kimike që krijohen nga veprimtaritë e kërkim-zhvillimit apo mësimdhënies që nuk janë të identifikuar dhe/ose janë të reja dhe efektet e tyre mbi njeriun dhe/ose mjedisin janë të panjohura (p.sh. mbetjet nga laboratorët etj.);
 - d. gomat e përdorura në formë të plotë, me përjashtim të gomave të përdorura si material inxhinierik, të gomave të biçikletave dhe të gomave me diametër të jashtëm mbi 1 400 mm; dh.gomat e përdorura të grira, me përjashtim të gomave të biçikletave dhe të gomave me diametër të jashtëm mbi 1 400 mm;
 - e. bateritë industriale dhe të automjeteve elektrike;
 - ë. mbetjet të cilat janë grumbulluar në mënyrë të diferencuar për ripërdorim dhe riciklim, me përjashtim të mbetjeve që janë krijuar nga operacionet e mëtejshme të trajtimit të mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar, për të cilat trajtimi në landfill jep rezultatin më të mirë mjedisor.
 - f. çdo lloj tjetër mbetjesh që nuk plotëson kriteret e pranimit, të përcaktuara në përputhje me Shtojcën II të këtij vendimi.
2. Ndalohet hollimi ose përzierja e mbetjeve, me qëllim plotësimin e kriterëve të pranimit të tyre në landfill.
3. Në përputhje me pikën 4 të nenit 35 të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, ndalohet depozitimi në landfill i mbetjeve që janë të përshtatshme për riciklim ose rikuperim, përveç rasteve kur provohet se depozitimi në landfill siguron rezultatin më të mirë mjedisor. Afatet për zbatimin e këtij ndalimi dhe kategoritë përkatëse të mbetjeve përcaktohen dhe përditësohen periodikisht nga ministria përgjegjëse për mjedisin, në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe planin përkatës të veprimit.

Neni 6

MBETJET DHE TRAJTIMET QË PRANOHEN NË LANDFILLE

1. Në landfill pranohen mbetjet që i janë nënshtruar trajtimit, me përjashtim të mbetjeve inerte

për të cilat trajtimi është teknikisht i pamundur, dhe mbetjeve të tjera kur trajtimi i tyre nuk zvogëlon sasinë e mbetjeve apo rreziqet në shëndetin e njeriut dhe në mjedis. Masat që merren për qëllim të kësaj pike, nuk pengojnë arritjen e objektivave të përcaktuara në ligjin nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, veçanërisht në lidhje me hierarkinë e mbetjeve dhe rritjen e përgatitjes për ripërdorim dhe riciklimin, në përputhje me nenin 11 të atij ligji.

2. Në landfillet e mbetjeve të rrezikshme pranohen vetëm mbetje që klasifikohen si të rrezikshme në përputhje me përkufizimin e pikës 35, të nenit 4 të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, dhe që përmbushin kriteret dhe procedurat e pranimit të përcaktuara sipas këtij seksioni dhe Shtojcës II të këtij vendimi.
3. Në landfillet e mbetjeve jo të rrezikshme pranohen vetëm:
 - a. mbetjet bashkiake;
 - b. mbetjet jo të rrezikshme të çdo origjine tjetër, që përmbushin kriteret dhe procedurat e pranimit të mbetjeve jo të rrezikshme të përcaktuara sipas këtij neni dhe Shtojcës II të këtij vendimi;
 - c. mbetjet e rrezikshme joreaktive, të qëndrueshme, (p.sh të ngurtësuara, të qelqëzuara) me veti rrjedhëse të ngjashme me ato të mbetjeve jo të rrezikshme, të referuara në gërmën “b” të kësaj pike, dhe që përmbushin kriteret dhe procedurat përkatëse të pranimit, të përcaktuara sipas këtij neni dhe Shtojcës II të këtij vendimi. Këto mbetje të rrezikshme nuk depozitohen në parcelat e destinuara për mbetjet bio.
4. Landfillet për mbetjet inerte përdoren vetëm për mbetjet inerte në kuptim të këtij vendimi.

KREU III

LEJET E MJEDISIT PËR LANDFILLET E MBETJEVE

Neni 7

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR TË GJITHA KATEGORITË E LANDFILLEVE

1. Studimi dhe projektzbatimi për ndërtimin e landfilleve hartohen nga subjekte të licencuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi për projektimin, përmbajnë dokumentacionin teknik të plotë dhe kryhen sipas kriterëve, standardeve dhe procedurave të përcaktuara në Shtojcën I të këtij vendimi.
2. Dokumentacioni i studimit dhe projektzbatimit bazohet në kërkesat e përcaktuara në Shtojcën I të këtij vendimi dhe përfshin, të paktën:
 - a. përzgjedhjen e vendndodhjes;
 - b. mbrojtjen e tokës dhe ujërave sipërfaqësore e nëntokësore;
 - c. kontrollin dhe menaxhimin e lëngjeve kulluese;
 - d. kontrollin e gazit të landfillit;
 - ç. garantimin e stabilitetit dhe sigurisë strukturore të landfillit
3. Çdo landfill i ri që ndërtohet duhet të pajiset me leje mjedisi, e cila përmban informacionin dhe kushtet sipas dispozitave të neneve 8, 9 dhe 10 të këtij vendimi.

4. Të gjitha landfillet ekzistuese të cilat janë të pajisura me një leje mjedisi dhe operojnë ose deri në hyrjen në fuqi të këtij Vendimi nuk kanë filluar ende operimin, duhet të aplikojnë për ndryshim kushtesh të lejes së mjedisit dhe të:
- plotësojnë kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;
 - plotësojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit;
 - plotësojnë kërkesat e këtij Vendimi;
 - paraqesin pranë AKM-së Planin e Përmirësuar të përcaktuar në nenin 14 të këtij Vendimi.

Neni 8

KËRKESA PËR LEJE MJEDISI

1. Në përputhje me ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 57, datë 16.10.2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, kërkesa për lejen e mjedisit, e tipit A ose B, për një landfill, përfshin edhe informacion për:

- identitetin e kërkuarit dhe të operatorit, kur ata janë entitete të ndryshme;
- përshkrimin e llojeve dhe sasi të totale të mbetjeve që do të asgjësohen, të identifikuar nga kodi përkatës sipas Katalogut të Mbetjeve;
- kapacitetin e propozuar të landfillit, si dhe volumin e nevojshëm për depozitimin e mbetjeve dhe volumin e materialeve të përdorura për mbulime ditore;
- përshkrimin e vendit, përfshirë edhe karakteristikat e tij hidrogeologjike e gjeologjike, gjeoteknike, me qëllim identifikimin e natyrës së tokave dhe masiveve shkëmbore të pranishme në zonë dhe skemën e qarkullimit të ujërave nëntokësore, të shoqëruar nga një matje të detajuar gjeologjike dhe një hetim të detajuar stratigrafik, i realizuar me marrjen e mostrave dhe provave përkatëse laboratorike në përputhje me kërkesat e akteve ligjore përkatëse në fuqi.
- metodat e propozuara për parandalimin dhe pakësimin e niveleve të ndotjes;
- planet e propozuara të operacioneve, monitorimit dhe të kontrollit;
- planin e propozuar për mbylljen e landfillit dhe procedurat e kujdesit pas mbylljes;
- raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, në zbatim të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, dhe çdo informacion që është dhënë nga zhvilluesi;
- garanci financiare nga kërkuari, siç parashikohet nga neni 36, i ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Neni 9

KUSHTET PËR PAJISJEN ME LEJE MJEDISI

Në përputhje me ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk miraton kërkesën për leje mjedisi për landfillin, në qoftë se nuk është e

bindur që plotësohen kushtet si më poshtë:

- a. projekti i landfillit është në përputhje me të gjitha kërkesat përkatëse të legjislacionit në fuqi dhe të këtij vendimi;
- b. drejtuesi teknik që do të menaxhojë vendin e landfillit ka kapacitetin e duhur teknik e menaxherial për këtë qëllim, të vërtetuar përmes dokumentacionit përkatës, duke përfshirë CV profesionale, diplomë universitare në fusha të lidhura me mjedisin, inxhinierinë ose fusha të ngjashme, certifikime profesionale dhe dëshmi të përvojës së punës në menaxhimin e mbetjeve ose veprimtari të ngjashme;
- c. operatorëve dhe stafit të landfillit u ofrohen trajnime nga ana profesionale dhe teknike;
- ç. landfilli do të operohet duke ndërmarrë masat e nevojshme për parandalimin e aksidenteve dhe për kufizimin e pasojave të tyre;
- d. janë marrë masat e duhura, përmes një garancie financiare, para fillimit të operacioneve të asgjësimit, që sigurojnë plotësimin e të gjitha detyrimeve, përfshirë ato për kujdesin pas mbylljes, të përcaktuara në lejen e mjedisit, dhe që janë ndjekur procedurat e mbylljes, të kërkuara nga ligji nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, si dhe nga ky vendim. Kjo garanci ose ekuivalenti i saj mbahen për aq kohë sa kërkohet për kryerjen e operacioneve të mirëmbajtjes e të kujdesit pas mbylljes të landfillit, në përputhje me parashikimet e nenit 13 të këtij vendimi. Kjo kërkesë nuk zbatohet për landfillet e administruara nga AKEM, në përputhje me pikën 5 të nenit 36 të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;
- dh. projekti i landfillit është në përputhje me planet përkatëse të menaxhimit të mbetjeve, të referuara në nenet 63, 64 e 65 të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Neni 10

PËRMBAJTJA E LEJES SË MJEDISIT PËR LANDFILLIN

1. Leja e mjedisit e tipit A ose B për një landfill përfshin përvec kushteve të parashikuara në përputhje me ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, edhe informacionin dhe kërkesat në vijim, për:
 - a. kategorinë e landfillit;
 - b. listën e llojeve të përcaktuara të mbetjeve që lejohen të depozitohen në landfill;
 - c. sasinë totale të mbetjeve që lejohet të depozitohet në landfill;
 - ç. kërkesat për përgatitjen e landfillit, operacionet e asgjësimit në landfill dhe procedurat e vetëmonitorimit e të kontrollit të landfillit, përfshirë edhe planet e emergjencës (Shtojca III, seksioni 4.2);
 - d. kërkesat kushtëzuese për operacionet e mbylljes dhe të kujdesit pas mbylljes;
- dh. detyrimin e operatorit për të raportuar, të paktën, një herë në vit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, për llojet dhe sasinë e mbetjeve të asgjësuara dhe për rezultatet e programit të vetëmonitorimit, në bazë të neneve 12 dhe 13 dhe Shtojcës III të këtij vendimi.
2. Mbajtja, përditësimi dhe raportimi i të dhënave për mbetjet kryhen në përputhje me nenin 70 të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

KREU IV
OPERACIONET E LANDFILLEVE

Neni 11

PROCEDURAT E PRANIMIT TË MBETJEVE NË LANDFILL

1. Zotëruesi i mbetjeve, përpara apo gjatë dorëzimit të mbetjeve në vendin e landfillit, ose përpara apo gjatë dorëzimit të parë të një serie dorëzimesh të të njëjtit lloj mbetjesh, i tregon operatorit me anë të dokumentacionit shoqërues të mbetjeve, se:
 - a. në përputhje me kushtet e lejes së mjedisit, mbetjet mund të pranohen në këtë vend;
 - b. ai i përmbush kriteret e pranimit, të përcaktuara në Shtojcën II dhe nuk bëjnë pjesë në kategoritë e mbetjeve të ndaluara për depozitim në landfill, sipas nenit 5 të këtij vendimi.
2. Operatori, para fillimit të operacioneve të landfillit, verifikon vendin e caktuar të landfillit, me qëllim që të sigurohet se vendi i propozuar është në përputhje me të gjitha kushtet përkatëse të lejes së mjedisit.
3. Operatori, para pranimit të mbetjeve në vendin e landfillit, kryen procedurat e mëposhtme të hyrjes:
 - a. kontrollon dokumentacionin shoqërues të mbetjeve;
 - b. verifikon vizualisht mbetjet në hyrje të vendit të landfillit dhe në pikën e depozitimit;
 - c. verifikon përputhshmërinë e mbetjeve me përshkrimin e dhënë në dokumentacionin e dorëzuar nga mbajtësi, përfshirë përputhshmërinë me kërkesat e nenit 5 të këtij vendimi;
 - ç. kur në zbatim të kërkesave të seksionit 1.3.3 të Shtojcës II, për verifikimet në vend, merren dhe analizohen mostra përfaqësuese të cilat ruhen për, të paktën, 1 (një) muaj;
 - d. lëshon dokument me shkrim për marrjen e çdo dërgese të pranuar në vend;
 - dh. plotëson regjistrin përkatës me sasi të dhe karakteristikat e mbetjeve të depozituara, duke shënuar origjinën, datën e dorëzimit, identitetin e krijuesit ose të grumbulluesit të mbetjeve bashkiake, kurse në rastin e mbetjeve të rrezikshme shënon edhe vendndodhjen e saktë. Ky informacion i vihet në dispozicion Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese.
4. Operatori, në rast se nuk i pranon mbetjet në landfill, refuzon marrjen e tyre dhe njofton menjëherë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për mospranimin e mbetjeve. Ky informacion i dergohet edhe strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit.
5. Operatori, për landfilllet sipas pikës 3 të nenit 3 të këtij vendimi, që përjashtohen nga dispozitat e këtij vendimi:
 - a. verifikon vizualisht mbetjet në pikën e depozitimit, për të siguruar që në vend pranohen vetëm mbetje jo të rrezikshme nga ishulli ose nga qendra e banuar e izoluar;
 - b. plotëson regjistrin për sasi të mbetjeve që janë depozituar në vend.

Neni 12

KONTROLLI DHE PROCEDURAT E VETËMONITORIMIT NË FAZËN OPERACIONALE

1. Operatori, gjatë fazës operacionale të një landfilli, kryen procedurat e kontrollit dhe vetëmonitorimit, të specifikuara në Shtojcën III.
2. Operatori informon Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për çdo ndikim negativ të rëndësishëm në mjedis, që mund të identifikohet gjatë kryerjes së procedurave të kontrollit dhe vetëmonitorimit.
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në rastet kur identifikohet ndonjë ndikim negativ i rëndësishëm në mjedis, njofton operatorin për të marrë masa dhe për kohën se kur ai duhet t'i marrë ato. Këto masa ndërmerren me shpenzimet e operatorit.
4. Leja e mjedisit specifikon periudhën kohore në të cilën operatori duhet të raportojë në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe të gjitha rezultatet e vetëmonitorimit, sipas të dhënave të grumbulluara.. në përputhje me legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit dhe tipologjinë përkatëse të lejes. Këto raporte përdoren për të treguar përputhshmërinë me kushtet e vendosura në lejen e mjedisit dhe për të rritur shkallën e njohjes për sjelljen dhe evolucionin e mbetjeve në landfill.
5. Operatori i landfillit raporton të dhënat mbi mbetjet dhe rezultatet e vetëmonitorimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 71 të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
6. Kontrolli i cilësisë së operacioneve analitike të kontrollit e vetëmonitorimit dhe/ose të analizave, të referuara në pikën 2 të nenit 11, kryhet nga laboratorë të specializuar të akredituar sipas legjislacionit në fuqi

Neni 13

PROCEDURAT E MBYLLJES DHE TË KUJDESIT PAS MBYLLJES

1. Operatori i vendit të landfillit fillon procedurat e mbylljes për të gjithë vendin e landfillit ose për një pjesë të tij, kur të paktën një nga kushtet e mëposhtme plotësohet:
 - a. janë përmbushur kushtet përkatëse, të përcaktuara në lejen e mjedisit;
 - b. kërkesa e tij për mbyllje është miratuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
 - c. kur kërkohet, me një vendim të argumentuar teknikisht, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, përpara se të vendosë mbylljen ose jo të vendit të landfillit ose një pjese të tij, kryen një verifikim teknik përfundimtar në vend dhe vlerëson të gjitha raportet e dorëzuara nga operatori.
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur vlerëson se janë përmbushur të gjitha kërkesat e vendosura në lejen e mjedisit për mbylljen e landfillit dhe që, vendi i landfillit nuk paraqet ndonjë rrezik për shëndetin e njeriut ose mjedisin, i komunikon, me shkrim, operatorit vendimin për miratimin e mbylljes së vendit të landfillit.
4. Vendimi për mbylljen dhe për kujdesin e mëtejshëm të landfillit, miratohet nga Agjencia

Kombëtare e Mjedisit, pas vlerësimit teknik të kryer prej saj dhe i njoftohet ministrit përgjegjës për mjedisin.

5. Miratimi i mbylljes së vendit të landfillit nuk ia pakëson përgjegjësinë operatorit për të përmbushur kushtet e lejes së mjedisit, përfshirë edhe përgjegjësitë specifike që vijnë:
 - a. Operatori është përgjegjës për mirëmbajtjen, vetëmonitorimin dhe kontrollin e vendit të landfillit gjatë fazës së kujdesit pas mbylljes, për atë kohë sa për periudhën kohore të përcaktuar në vendimin e mbylljes, duke marrë në konsideratë periudhën kohore gjatë së cilës vendi i landfillit mund të paraqesë rrezik për shëndetin e njeriut ose mjedisin.
 - b. Operatori njofton Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për ndonjë ndikim negativ të rëndësishëm në mjedis, të zbuluar gjatë kryerjes së procedurave të kontrollit, dhe zbaton vendimin e mbylljes, për natyrën, shkallën dhe afatin kohor të masave që duhen marrë.
 - c. Operatori i vendit, pavarësisht nga legjislacioni në fuqi për përgjegjësinë e zotëruesit të mbetjeve, është përgjegjës, sipas kërkesave të Shtojcës III, për vetëmonitorimin dhe analizimin e gazrave të landfillit, të lëngjeve kulluese dhe të regjimit të ujërave nëntokësore në afërsi të vendit, për periudhën kohore të përcaktuar në vendimin e mbylljes, në përputhje me kushtet e përcaktuara në atë vendim.

KREU V LANDFILLET E MBETJEVE

Neni 14

LANDFILLET EKZISTUESE TË PAJISURA ME LEJE MJEDISI

1. Dispozitat e këtij neni përcaktojnë rregullat kalimtare për landfillet ekzistuese që janë në funksionim në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, me qëllim përshtatjen graduale të tyre me kërkesat e këtij vendimi.
2. Operatori i një landfilli i cili është pajisur me një leje mjedisi për landfill dhe që operon një landfill ekzistues mund të vazhdojë operimin e tij, vetëm nëse përgatit një plan përmirësimi të landfillit dhe e paraqet atë për miratim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, sa më shpejtë dhe maksimalisht deri në datën 31.12.2028.
3. Plani i përmirësimit, sipas pikës 2 të këtij neni, përfshin kërkesat e përcaktuara në nenin 9 të këtij vendimi. Landfillet ekzistuese përfshihen nga plotësimi i kërkesave të seksionit 1 të Shtojcës I.
4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga marrja e planit të përmirësimit, merr vendim nëse operacionet mund të vazhdojnë në bazë të planit të përmirësimit në përputhje me kërkesat e nenit 9.
5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pasi miraton planin e përmirësimit dhe vendos për masat që duhen marrë dhe periudhën e nevojshme të tranzicionit për zbatimin e tyre, periudhë e cila në çdo rast përfundon në datën 31.12.2038, e dërgon atë së bashku me relacionin shpjegues teknik për informacion pranë ministrit përgjegjës për mjedisin. Relacioni shpjegues përmban të dhëna mbi pikëzimin e landfillit, si dhe impaktin mjedisor, ekonomik e social të zonës ku ndodhet landfilli.

6. Plani i përmirësimit i miratuar, masat e nevojshme dhe periudha e tranzicionit, e referuar në pikën 5, të këtij neni, janë pjesë e lejes së përditësuar të mjedisit për atë landfill ekzistues.
7. Agjencia kryen të gjitha veprimet e nevojshme për rishikimin e kushteve të lejeve të mjedisit.
8. Agjencia Kombëtare e Mjedisit ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për të mbyllur landfillin ekzistues sa më parë të jetë e mundur, , dhe i kërkon operatorit të zbatojë planet e propozuara për mbylljen dhe për kujdesin pas mbylljes, në përputhje me gërmën “e” të pikës 1 të nenit 8, dhe nenin 13 të këtij vendimi, në rastet e mëposhtme:
 - a. Kur vendi i një landfilli ekzistues sipas mendimit të argumentuar të AKM-së, nuk mund të sillet në kushte që përputhen me këtë vendim; dhe/ose
 - b. Kur vendi i një landfilli ekzistues nuk arrin të pajiset me leje mjedisi, në përputhje me kërkesat e nenit 9 të këtij vendimi;
 - c. Kur operatori kërkon mbylljen e landfillit ekzistues.
9. Në çdo rast, ndalohet të depozitohen apo trajtohen mbetjet e ngurta në një landfill ekzistues kur në atë zonë mbetjesh funksionon një impiant rajonal për trajtimin e mbetjeve, i cili plotëson standardet mjedisore dhe teknike.

Neni 15

PLANI I PËRMIRËSIMIT TË LANDFILLIT EKZISTUES

1. Plani i përmirësimit i përgatitur nga operatori sipas nenit 14, pika 1, duhet të përfshijë detajet teknike, operative dhe mjedisore si më poshtë:
 - a. masat për përputhjen e operacioneve të landfill-it ekzistues me kërkesat e nenit 9 të këtij vendimi, duke përfshirë trajtimin e lëngjeve kulluese, gazrave, mbetjeve monolite dhe masat e sigurimit të integritetit struktural të landfill-it;
 - b. procedurat e monitorimit dhe të raportimit për periudhën tranzitore, në përputhje me standardet e përcaktuara në Shtojcën IX (Regjimi operacional për landfill-et ekzistues);
 - c. masat për minimizimin e ndikimit mjedisor, ekonomik dhe social në zonën përreth landfill-it;
 - ç. afatet për zbatimin e masave të përmirësimit dhe kalendarin e periudhës tranzitore, duke respektuar datën përfundimtare të 31.12.2038 siç përcaktohet në nenin 14, pika 5;
 - d. planin për kujdesin pas mbylljes së landfill-it, duke u bazuar në kërkesat për garanci financiare dhe procedurat e përcaktuara në Shtojcën VII dhe VIII të këtij vendimi;
 - e. referencën e qartë në Shtojcën IX për të gjitha procedurat operative dhe monitorimin e landfill-it ekzistues.
2. Operatori i një landfilli ekzistues, përveç përmbushjes së kërkesave të planit të përmirësimit të landfillit, duhet të zbatojë procedurat e kontrollit dhe vetëmonitorimit të përshkruara në Shtojcën III të këtij vendimi, për të siguruar respektimin e parametrave mjedisorë dhe teknikë gjatë fazës së operimit dhe pas mbylljes.
3. Plani i përmirësimit i miratuar sipas këtij neni bëhet pjesë integrale e lejes së përditësuar të mjedisit për landfillin ekzistues.

KREU VI GARANCITË E LANDFILLEVE

Neni 16

RREGULLAT PËR GARANCITËE FINANCIARE

1. Tarifa e përcaktuar nga operatori, për asgjësimin e mbetjeve në landfill, në përputhje me nenin 27 të ligjit nr. 57, datë 16.10.2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” mbulon kostot e projektimit dhe operimit të landfillit, si edhe kostot e garancisë financiare të kërkuar në nenin 36 të këtij ligji dhe garancinë financiare për mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes së landfillit për një periudhë prej të paktën 30 (tridhjetë) vitesh.
2. Të gjithë operatorët publikë ose privatë që operojnë landfille të mbetjeve janë të detyruar në bazë të pikave 1 dhe 2 të nenit 36 të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të sigurojnë:
 - a. garancinë financiare për operimin e landfillimit;
 - b. garancinë financiare për mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes të landfillit, e cila mbahet për çdo qelizë që është në operim dhe fillon të shfrytëzohet në momentin që qeliza përkatëse plotëson kapacitetin e saj.
3. Në përputhje me pikën 5, të nenit 36 të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, AKEM sh.a është i përjashtuar nga zbatimi i të gjitha detyrimeve për garancitë financiare të landfillit të përcaktuara në këtë nen. Ky përjashtim nuk zbatohet për nënkontraktorët e AKEM sh.a.

Neni 17

AUTORITETI KOMPETENT PËR VLERËSIMIN E GARANCIVE FINANCIARE

1. Autoriteti kompetent për vlerësimin, miratimin, monitorimin dhe zbatimin e garancive financiare është Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
2. Garancia financiare paraqitet nga kërkuesi si pjesë e aplikimit për leje mjedisi dhe miratohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit para fillimit të operacioneve të landfillit.
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit verifikon përputhshmërinë e garancisë financiare me kërkesat e këtij vendimi, përfshirë vlerën, formën, kohëzgjatjen dhe kushtet e përdorimit të saj.
4. Të drejtat dhe detyrimet që lidhen me garancinë financiare, përfshirë rastet e përdorimit, zëvendësimit, rinovimit apo transferimit të saj, zbatohen në përputhje me kushtet e miratuara nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe dispozitat e këtij vendimi.

Neni 18

GARANCIA FINANCIARE

1. Garancia financiare për operimin e landfillit sipas gjurmës “a” të pikës 2 të nenit 16 të këtij vendimi ka për qëllim sigurimin e mbulimit të plotë të kostove të mëposhtme, që lidhen me rreziqet dhe detyrimet gjatë fazës së operimit të landfillit:
 - a. falimentimi i operatorit;
 - b. braktisja e veprimtarisë;
 - c. shkelje e rëndë e kushteve të lejes së mjedisit;
 - ç) dështimi për të kryer mbylljen brenda afatit , i cili lidhet me garancinë financiare për mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes sipas gjurmës “b” të pikës 2 të nenit 16;
 - d. ndotje e rëndë që kërkon ndërhyrje të menjëherëshme.
2. Kjo garanci mund të përfitohet nga një bankë e nivelit të dytë në formën e një garancie bankare të pakushtëzuar dhe të parevokueshme, ose nga një kompani sigurimesh. Shuma e garancisë, llogaritet në masën 2% të vlerës së ndërtimit të landfillit por në asnjë rast më e vogël se 10 milion lekë.
3. Afati i garancisë është 12 muaj dhe rinovimi është i detyrueshëm të kryhet të paktën 30 ditë përpara maturimit të garancisë në fuqi. Kjo garanci, do të kërkohej gjatë gjithë kohëzgjatjes së operimit të landfillit dhe përfundon me miratimin e mbylljes së landfillit. AKM monitoron në vazhdimësi vlefshmërinë e garancisë në zbatim të kësaj pike.
4. AKM kërkon aktivizimin e këtij instrumenti, brenda 30 ditëve nga verifikimi i njërës nga ngjarjet e mësipërme.
5. Procedura për aktivizimin e garancisë financiare fillon me vendim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në rastet e parashikuara në këtë vendim, dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për detyrimet financiare dhe kontraktuale.
6. Garancia financiare për mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes së landfillëve sipas gjurmës “b” të pikës 2 të këtij neni, ka për qëllim sigurimin e mbulimit të plotë të kostove për:
 - a. mbylljen përfundimtare teknike të qelizës përkatëse;
 - b. monitorimin dhe kujdesin pas mbylljes për një periudhë jo më të shkurtër se 30 (tridhjetë) vjet;
 - c. rehabilitimin mjedisor;
 - ç. ndërhyrjet emergjente në rast rreziku për mjedisin dhe shëndetin publik pas mbylljes së landfillit.
7. Garancia financiare mund të jetë në një ose disa nga format e mëposhtme:
 - a. garanci bankare e pakushtëzuar dhe e parevokueshme;
 - b. fond i bllokuar në llogari *escrow*;
 - c. garanci sovranë vetëm për operatorë publikë shtetërorë).
8. Afati i garancisë financiare sipas gjurmës “b” të pikës 2 të këtij neni, mund të zgjatet përtej periudhës 30 vjecare, me vendim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, nëse:
 - a. vazhdon prodhimi i lëngjeve kulluese;
 - b. ka emetime të gazrave në landfill;
 - c. ekzistojnë rreziqe për ndotje në ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore ose për mjedisin në përgjithësi.
9. Vlera e garancisë financiare për mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes së landfillit llogaritet duke marrë në konsideratë:

- a. vëllimin total të projektuar të mbetjeve;
- b. sipërfaqen dhe thellësinë e landfillit;
- c. teknologjinë e trajtimit të ujërave dhe gazrave;
- ç. koston e monitorimit për 30 vjet;
- d. indeksimin vjetor të inflacionit.

Vlera e garancisë financiare përcaktohet në mënyrë të detajuar sipas metodologjisë së parashikuar në Shtojcën VII të këtij vendimi.

10. Garancia financiare për mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes së landfillit administrohet nga:

- a. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në rolin e autoritetit mbikëqyrës për monitorimin dhe kërkimin e aktivizimit të garancisë dhe
- b. nga një institucion financiar i licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe / ose një bankë e nivelit të dytë.

11. Në rast ndryshimi të operatorit si pasojë e transferimit të pronësisë ose të licencës garancia financiare ekzistuese mbetet aktive.

12. Në rast mbylljeje të parakohshme të landfillit, garancia financiare nuk reduktohet por fillon menjëherë periudha 30-vjeçare e kujdesit pas mbylljes.

13. Me miratimin e planit të mbylljes dhe kujdesit pas mbylljes së landfillit, operatori është i detyruar të raportojë për përdorimin e garancisë financiare:

- a. çdo 6 muaj për 10 vitet e para;
- b. çdo vit për 20 vitet pasuese.

14. Përdorimi i garancisë bëhet në varësi të operacioneve për mbylljen, kujdesin pas mbylljes si të dhe intensitetit të këtyre operacioneve. 60% e shumës së garancisë përdoret brenda 10 viteve të para dhe 40% në 20 vitet në vijim. Në asnjë rast garancia financiare nuk lirohet plotësisht para afatit prej 30 vitesh pas mbylljes së landfillit.

15. Operatori i landfillit mbetet përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar nga veprimtaria e tij sipas legjislacionit civil dhe penal, edhe pas lirimit të garancisë.

16. Operimi i landfillit pa garanci financiare përbën kundërvajtje administrative sipas pikës 48 të nenit 77 të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Çdo përdorim i garancisë financiare në kundërshtim me kërkesat e këtij vendimi trajtohet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

17. Operatorët ekzistues janë të detyruar të depozitojnë garancinë financiare brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij akti. Shuma e garancisë që duhet depozituar, llogaritet në proporcion me kohën e veprimtarisë që nga fillimi i operimit të landfillit.

18. Metodologjia dhe formula për llogaritjen e garancisë financiare për mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes, përcaktohet në Shtojcën VII të këtij Vendimi.

19. Dokumentacioni i nevojshëm për vendosjen e garancisë financiare dhe procedurat për përdorimin e garancisë financiare për mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes së landfillit përcaktohen në Shtojcën VIII të këtij Vendimi.

20. Garancia financiare për mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes rishikohet çdo 5 vjet dhe rritet detyrimisht në rast zgjerimi të kapaciteteve të landfillit.

KREU VII

OBJEKTIVAT DHE AFATET PËR ASGJËSIMIN E MBETJEVE NË LANDFILL

Neni 19

PAKËSIMI I MBETJEVE TË BIODEGRADUESHME QË DEPOZITOHEN NË LANDFILL

Objektivat për pakësimin e mbetjeve të biodegradueshme që depozitohen në landfill janë:

- a. jo më vonë se 3 (tre) vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi mbetjet bashkiake të biodegradueshme që shkojnë në landfill reduktohen në (janë sa) 50% të sasisë totale (sipas peshës) të mbetjeve bashkiake të biodegradueshme, të gjeneruara në vitin 2010.
- b. jo më vonë se 10 (dhjetë) vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi mbetjet bashkiake të biodegradueshme që shkojnë në landfill reduktohen në (janë sa) 35% të sasisë totale (sipas peshës) të mbetjeve bashkiake të biodegradueshme, të gjeneruara në vitin 2010.

Neni 20

OBJEKTIVAT E ZVOGËLIMIT TË DEPOZITIMIT TË MBETJEVE NË LANDFILLE

1. Me qëllim përmbushjen e objektivave për zvogëlimin e mbetjeve që depozitohen në landfill:
 - a. deri në datën 31 dhjetor 2045, sasia e mbetjeve bashkiake që depozitohen në landfill nuk tejkalon 10% të sasisë totale të mbetjeve bashkiake të gjeneruara;
 - b. pas datës 31 dhjetor 2035, të gjitha mbetjet e përshtatshme për riciklim dhe rikuperime të tjera, vecanërisht për mbetjet bashkiake, nuk pranohen në landfill;
 - c. pas datës 31 dhjetor 2035, mbetjet e pa trajtuara nuk pranohen në landfill.
2. Zbatimi i këtyre objektivave realizohet në mënyrë progresive përmes sistemit të vlerësimit, klasifikimit dhe menaxhimit të landfillleve të përcaktuar në këtë akt, sipas Nenit 21 dhe Shtojcës përkatëse.

Neni 21

RREGULLAT E PËRLLOGARITJES SË PËRMBUSHJES SË OBJEKTIVAVE

1. Për qëllime të llogaritjes së përmbushjes së objektivave të përcaktuara në gërmën "a" të nenit 20 të këtij vendimi, si dhe në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në Aneksin IV për kërkesat e përgjithshme për landfillet ekzistuese, si mbetje bashkiake të depozituara në landfill konsiderohen:
 - a. pesha e mbetjeve bashkiake të krijuara dhe të depozituara në landfill gjatë një viti kalendarik;
 - b. pesha e mbetjeve bashkiake që rezultojnë nga operacionet e ndarjes ose trajtimit mekaniko-biologjik, përpara kryerjes së riciklimit ose rikuperimeve të tjera, të cilat më pas depozitohen në landfill.

- c. pesha e mbetjeve bashkiake që hyjnë në operacione incinerimi për qëllime asgjësimi në landfill. Sasia e mbetjeve që rezulton nga procesi i incinerimit dhe i nënshtrohet një operacioni të mëtejshëm rikuperimi, zbritet nga sasia totale e mbetjeve që hyjnë në operacion incinerimi. Sasia e materialeve që do të zbritet, llogaritet duke marrë parasysh pjesën e mbetjeve bashkiake në të gjitha mbetjet që hyjnë në impiant dhe, kur është e përshtatshme, përbërjen e mbetjeve të tjera përveç mbetjeve bashkiake që hyjnë në impiant.
 - d. dhe pesha e mbetjeve të prodhuara gjatë operacioneve të stabilizimit të fraksionit të biodegradueshëm të mbetjeve bashkiake, të cilat më pas depozitohen në landfill.
2. Sasia e mbetjeve të referuara në gërmat “b”, “c”, dhe “d” të pikës 1 të këtij neni, nuk korrigjohet kur kjo sasi zvogëlohet pas operacioneve të uljes së nivelit të lagështirës, të shqetësimeve dhe të rreziqeve. Sasia që zvogëlohet nuk raportohet si sasi mbetjesh e rikuperuar.
 3. Kur mbetjet bashkiake eksportohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për qëllime depozitimi në landfill, këto mbetje përlllogariten në sasinë e mbetjeve të depozituara në landfill në Shqipëri.
 4. Kur mbetjet bashkiake eksportohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për qëllime riciklimi apo rikuperime të tjera, sasia e mbetjeve, që rezulton nga trajtimi paraprak në shtetin e destinacionit përpara se mbetjet bashkiake të hyjnë në operacione riciklimi ose rikuperime të tjera, e cila depozitohet në landfill, ose futet në operacione incinerimi me qëllim depozitimin e mëvonshëm në landfill në shtetin e destinacionit, përfshihet në sasinë e mbetjeve bashkiake të raportuara si të landfilluara, në Republikën e Shqipërisë.
 5. Pesha e mbetjeve të krijuara pas operacioneve të riciklimit ose rikuperimeve të tjera të mbetjeve bashkiake, të cilat më pas depozitohen në landfill, nuk përfshihet në peshën e mbetjeve bashkiake të raportuara si të depozituara në landfill.
 6. Raportohen si mbetje të depozituara në landfill, mbetjet të cilat krijohen si rezultat i operacioneve të kontrollit, pastrimit dhe riparimit, për përgatitjen për ripërdorim të mbetjeve bashkiake pa ndarje ose para-procesim të mëtejshëm, dhe të cilat landfillohen.
 7. Raportohen si mbetje të depozituara në landfill, materialet të cilat hiqen në mënyrë mekanike gjatë ose pas trajtimit aerobik ose anaerobik të mbetjeve bio, dhe të cilat landfillohen.
 8. Raportohen si mbetje të depozituara në landfill, mbetjet të cilat hiqen gjatë riciklimit të mbetjeve bio, dhe të cilat landfillohen.
 9. Nuk raportohen si mbetje të depozituara në landfill, edhe kur landfillohen, mbetjet të cilat krijohen gjatë operacioneve të riciklimit të mbetjeve bashkiake.
 10. Me qëllim përmbushjen e kushteve të pikës 1 të këtij neni, AKM, nëpërmjet sistemit elektronik të të dhënave, bën kontrollin e cilësisë, koherencës dhe gjurmueshmërisë së të dhënave të mbetjeve bashkiake të asgjësuara në landfill.
 11. Rregullat e përlllogaritjes së objektivave sipas këtij neni zbatohen në përputhje me objektivat dhe treguesit e përcaktuar në Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe planin përkatës të veprimit, dhe shërbejnë si bazë për zbatimin e ndalimeve progresive të depozitimit në landfill sipas nenit 5 të këtij vendimi.

KREU VIII

RAPORTIMET

Neni 22

RAPORTIMET

1. Ministria përgatit periodikisht një raport për zbatimin e këtij vendimi dhe, në mënyrë të veçantë, të Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Planit të Veprimit, për përmbushjen e objektivave të përcaktuara në nenet 19 dhe 20 të këtij vendimi.
2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, AKEM sh.a. dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore i sigurojnë Ministrisë të gjithë informacionin mjedisor të nevojshëm për përgatitjen e raportit të referuar në pikën 1 të këtij neni.
3. Raporti i referuar në pikën 1, vihet në dispozicion të publikut.

KREU IX

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 23

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Vendimi Nr. 452, datë 11.7.2012 “Për landfillet e mbetjeve”, i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 1738 date 12.03.2015 “Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e vendepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane” shfuqizohen.
2. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T Ë R

EDI RAMA

SHTOJCA I

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR TË GJITHA KATEGORITË E LANDFILLEVE

1. Vendndodhja e landfillit

1.1. Për përzgjedhjen e vendndodhjes së një landfilli merren në konsideratë kërkesat që lidhen me:

- a) distancën nga kufiri i vendit të landfillit deri te zonat e banuara dhe zonat e pushimit/rekreative, rrjedhat e ujit, trupat ujqorë dhe zonat e tjera bujqësore ose urbane;
- b) ekzistencën e ujërave nëntokësore, ujërave bregdetare ose zonave natyrore të mbrojtura në këtë zonë;
- c) kushtet gjeologjike dhe hidrogjeologjike në këtë zonë;
- d) rrezikun e përmbytjes, fundosjes, shkarjes së dherave, ose të rënies së orteqeve në këtë vend;
- e) mbrojtjen e trashëgimisë natyrore e kulturore në këtë zonë.
- f) dispozitat e ligjit nr. 8752, datë 23.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar.

1.2. Vendndodhja e landfillit autorizohet vetëm në qoftë se karakteristikat e vendit, në përputhje me kërkesat e përmendura më sipër, ose masat e duhura korrigjuese që do të merren, tregojnë që landfilli nuk shkakton ndonjë rrezik serioz mbi mjedisin.

2. Kontrolli i ujërave dhe menaxhimi i lëngjeve kulluese nga landfilli

2.1. Në përputhje me karakteristikat e landfillit dhe kushtet meteorologjike të zonës merren masat e duhura, me qëllim që:

- a) të kontrollohen ujërat që futen në trupin e landfillit nga precipitimet/reshjet;
- b) të parandalohet futja e ujërave sipërfaqësore dhe/ose ujërave nëntokësore në mbetjet e depozituara në landfill;
- c) të grumbullohen ujërat e kontaminuara dhe lëngjet që kullojnë nga landfilli; Autoriteti kompetent mund të vendosë që kjo dispozitë të mos zbatohet në qoftë se vlerësimi paraprak, që merr në konsideratë vendndodhjen e landfillit dhe mbetjet që pranohen aty, tregon se landfilli nuk paraqet rrezik potencial për mjedisin.
- d) ujërat e grumbullura, të kontaminuara dhe lëngjet kulluese nga landfilli, të trajtohen në standardin që kërkohet për shkarkimin e tyre.

2.2 Dispozitat e mësipërme mund të mos zbatohen për landfillet e mbetjeve inerte që nuk janë të kontaminuara me mbetje të tjera.

3. Mbrojtja e tokës dhe ujit

3.1 Përzgjedhja e vendit të landfillit dhe projektimi i tij bëhen në atë mënyrë që përmbush kushtet e nevojshme për parandalimin e ndotjes së tokës, ujërave sipërfaqësore ose nëntokësore, duke siguruar grumbullimin eficient të lëngjeve që kullojnë nga landfilli, siç dhe kur kërkohet sipas seksionit 2 të kësaj Shtojce.

Mbrojtja e tokës, ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore arrihet duke kombinuar barrierën gjeologjike me:

- a) një shtresë izoluese fundore në shtratin e landfillit në fazën operacionale (aktive); dhe

b) një shtresë izoluese të sipërme në fazën pas mbylljes (pasive).

3.2 Barriera gjeologjike përcaktohet nga kushtet gjeologjike dhe hidrogeologjike në afërsi të vendit të landfillit, si më poshtë, dhe siguron kapacitet zbutës të mjaftueshëm për të parandaluar një rrezik potencial për tokën dhe ujërat tokësorë.

Baza dhe anët e landfillit konsistojnë në një shtresë minerale që përmbush kërkesat për përshkueshmërinë dhe trashësinë me një efekt të kombinuar, për mbrojtjen e tokës, ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore, të paktën të barasvlershëm me atë që rezulton nga kërkesat që vijnë:

a) Për landfillin e mbetjeve të rrezikshme:

Koeficienti i përshkueshmërisë (K) është 1.0×10^{-9} m/sekondë ose më i vogël se kaq; trashësia është 5 m ose më e madhe se kaq;

b) Për landfillin e mbetjeve jo të rrezikshme:

Koeficienti i përshkueshmërisë është 1.0×10^{-9} m/sekondë ose më i vogël se kaq; trashësia është 1 m ose më e madhe se kaq;

c) Për landfillin e mbetjeve inerte:

Koeficienti i përshkueshmërisë është 1.0×10^{-7} m/sekondë ose më i vogël se kaq; trashësia është 1 m ose më e madhe se kaq.

Barrierat gjeologjike, kur nuk i përmbushin në mënyrë natyrale kushtet e mësipërme, plotësohen artificialisht dhe përforcohen me mënyra të tjera që sigurojnë mbrojtje të njëjtë. Barriera gjeologjike artificiale duhet të ketë trashësi të barabartë me 0.5 metra ose më tepër se 0.5 metra.

3.3 Përveç barrierës gjeologjike të përshkruar më sipër, për të siguruar që sasia e lëngjeve që kullojnë nga landfilli të grumbulluara në shtratin e tij të jetë sa më e vogël, në përputhje me parimet e mëposhtme shtohet edhe sistemi i grumbullimit dhe izolimit të lëngjeve kulluese nga landfilli:

Grumbullimi i lëngjeve që kullojnë nga landfilli dhe izolimi i shtratit (pjesës së poshtme) të landfillit

Kategoria e landfillit	Mbetje jo të rrezikshme	Mbetje të rrezikshme	Mbetje inerte
Shtresë izoluese artificiale	kërkohet	kërkohet	Nuk kërkohet
Shtresë kulluese me trashësi të barabartë ose më të madhe se 0,5m	kërkohet	kërkohet	Nuk kërkohet

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në rastet kur, pas marrjes në konsideratë të rrezikut potencial për mjedisin, gjykon se duhet të parandalohet formimi i lëngjeve që kullojnë nga landfilli, në kushtet e lejes së mjedisit të atij landfilli, përfshin edhe izolimin e sipërfaqes.

Rekomandimet për izolimin e sipërfaqes (pjesës së sipërme) të landfillit

Kategoria e landfillit	Mbetje jo të rrezikshme	Mbetje të rrezikshme	Mbetje inerte
Shtresë shkarkimi për gazrat	Kërkohe	Nuk kërkohet	Nuk kërkohet
Shtresë izoluese artificiale	Nuk kërkohet	Kërkohe	Nuk kërkohet
Shtresë minerale e papërshkueshme	Kërkohe	Kërkohe	Nuk kërkohet
Shtresë kulluese me trashësi më të madhe se 0,5m	Kërkohe	Kërkohe	Nuk kërkohet
Mbulesë mbi shtresën e sipërme të tokës me trashësi më të madhe se 1m	Kërkohe	Kërkohe	Nuk kërkohet

3.4 Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në rastet kur pas vlerësimit të rrezikut për mjedisin, dhe në përputhje me seksionin 2 "Kontrolli i ujërave dhe menaxhimi i lëngjeve kulluese nga landfilli" gjykon se grumbullimi dhe trajtimi i lëngjeve që kullojnë nga landfilli nuk është i nevojshëm ose që landfilli është ndërtuar në mënyrë të tillë që nuk paraqet rrezik potencial për tokën, ujërat nëntokësore ose sipërfaqësore, i pakëson kërkesat e seksioneve 3.2 dhe 3.3 më sipër. Këto kërkesa, në rastet e landfillëve të mbetjeve inerte, mund të parashikohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për mbetjet inerte, në zbatim të neneve 34 dhe 57 të ligjit nr. 57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".

4. Kontrolli i gazit

- 4.1 Operatori i landfillit merr masat e duhura për kontrollin, grumbullimin dhe migrimin e gazit të landfillit (Shtojca III).
- 4.2 Të gjithë operatorët e landfillëve që pranojnë mbetje të biodegradueshme grumbullojnë gazin e landfillit, e trajtojnë dhe e përdorin atë. Gazi i grumbulluar, në qoftë se nuk mund të përdoret për të prodhuar energji, digjet.
- 4.3 Operatori i landfillit kryen grumbullimin, trajtimin dhe përdorimin e gazit të landfillit sipas paragrafit 4.2, në një mënyrë që minimizon dëmin ose përkeqësimin e mjedisit dhe rrezikun ndaj shëndetit të njeriut.

5. Shqetësimet dhe rreziqet

Operatori i landfillit merr masa për të minimizuar shqetësimet, problemet dhe rreziqet që vijnë nga landfilli, si rezultat i:

- a) çlirimit të erërave dhe pluhurit;
- b) materialeve që i merr era;
- c) zhurmave dhe trafikut;
- d) zogjve, krimbave dhe insekteve;
- e) krijimit të aerosolëve;
- f) zjarreve.

Operatori i landfillit merr masa për landfillin në mënyrë që papastërtitë që krijohen nga vendi i landfillit të mos përhapen në rrugët publike dhe tokën përreth tij.

6. Qëndrueshmëria

Operatori i landfillit siguron që mbetjet në vendin e landfillit të vendosen në mënyrë të tillë që masa e mbetjeve dhe e strukturave të lidhura me to, të jetë e qëndrueshme sidomos për të shmangur shkarjet. Kur vendoset barrierë izoluese artificiale, pas konsiderimit edhe të morfologjisë së landfillit, merren masa që sigurojnë që nënshtresa gjeologjike të ketë qëndrueshmëri të mjaftueshme për të parandaluar dëmtimin e barrierës/shtresës izoluese.

7. Pengesat për hyrjen në landfill

Operatori i landfillit merr masa që sigurojnë ndalimin e hyrjes së lirë në vendin e landfillit. Portat mbyllen pas përfundimit të orarit të operimit. Sistemi i kontrollit dhe aksesit në çdo impiant përmban një program masash për të zbuluar dhe dekurajuar hedhjen e paligjshme të mbetjeve në vendin e landfillit.

8. Magazinimi i përkohshëm i mërkurit metalik

Për magazinimin e përkohshëm të mërkurit metalik për më shumë se një vit, operatori i landfillit plotëson kërkesat e mëposhtme:

- a) Mërkuri metalik magazinohet i ndarë nga mbetjet e tjera.
- b) Kontejnerët magazinohen në basenë grumbullues të mbuluar me një shtresë të përshtatshme në mënyrë që të mos kenë carje dhe hapësira, si dhe të jenë të papërshkueshëm nga mërkuri metalik, dhe të kenë një volum mbajtës të përshtatshëm për sasinë e mërkurit që magazinohet.
- c) Vendndodhja e magazinimit duhet të jetë e pajisur me barriera të ndërtuara ose natyrore që janë të përshtatshme për të mbrojtur mjedisin nga emetimet e mërkurit dhe me një vëllim përmbajtës të mjaftueshëm për sasinë totale të mërkurit të magazinuar.
- d) Dyshemetë e vendit të magazinimit duhet të jenë të mbuluar me izolues rezistent ndaj mërkurit. Duhet të parashikohet një pjerrësi me një gropë grumbullimi.
- e) Vendi i magazinimit duhet të jetë i pajisur me një sistem mbrojtjeje nga zjarri.
- f) Magazinimi duhet të organizohet në një mënyrë që siguron që të gjithë kontejnerët të jenë lehtësisht të rikuperueshëm.

SHTOJCA II

PROCEDURAT DHE KRITERET E PRANIMIT TË MBETJEVE

Hyrje

Kjo shtojcë përshkruan:

- parimet e përgjithshme për pranimin e mbetjeve në kategoritë e ndryshme të landfillleve, në të cilat bazohen procedurat e klasifikimit të mbetjeve;
- kriteret që duhet të plotësohen për mbetje të rrezikshme të caktuara që të pranohen në landfillet e mbetjeve jo të rrezikshme. Këto kriteret duhet të marrin në konsideratë në veçanti aftësinë e mbetjeve për të lëngëzuar në afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë.
- kriteret që duhet të plotësohen për mbetjet që pranohen në depozitim nëntokësor. Këto kriteret marrin veçanërisht në konsideratë, që mbetjet të mos priten të reagojnë me njëra-tjetrën apo me shkëmbin përreth.

Parime të përgjithshme

Përbërja, aftësia për të lëngëzuar, sjellja afatgjatë dhe vetitë e përgjithshme të një mbetjeje që landfilllohet duhet të njihen sa më saktë.

Pranimi i mbetjeve në një landfill bazohet ose në listën e mbetjeve që pranohen ose që refuzohen, të përcaktuara sipas natyrës dhe origjinës, dhe në metoda analize të mbetjeve dhe vlera kufi për vetitë e mbetjeve që pranohen.

Procedurat për pranimin e mbetjeve në landfill bazohen në metoda të standardizuara analize dhe vlera kufi për vetitë e mbetjeve që pranohen.

Kriteret për pranimin e mbetjeve në një kategori të caktuar landfilli bazohen në aspekte që lidhen me:

- mbrojtjen e mjedisit përreth (në veçanti ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore);
- mbrojtjen e sistemeve të mbrojtjes së mjedisit (p.sh. shtresat izoluese dhe sistemet e trajtimit të lëngjeve kulluese);
- mbrojtjen e proceseve të dëshiruara të stabilizimit të mbetjeve brenda landfillit;
- mbrojtjen kundër rreziqeve për shëndetin e njeriut.

Kriteret për pranimin e mbetjeve në një kategori të caktuar landfilli të bazuara në vetitë e mbetjeve janë, por pa u kufizuar në:

- njohja e përbërjes së plotë të mbetjeve;
- kufizime mbi sasinë e lëndës organike në mbetje;
- kërkesa ose kufizime mbi biodegradueshmërinë e përbërësve organikë të mbetjeve;
- kufizime mbi sasinë e përbërësve të caktuar potencialisht të dëmshëm/rrezikshëm (në lidhje me kriteret e mbrojtjes së përmendura më sipër);
- kufizime mbi aftësinë për të lëngëzuar potenciale dhe të pritshme të përbërësve të caktuar potencialisht të dëmshëm/rrezikshëm (në lidhje me kriteret e mbrojtjes së përmendura më

sipër);

— vetitë ekotoksikologjike të mbetjeve dhe lëngjeve kulluese që rezultojnë prej tyre.

Kriteret e bazuara në vetitë e mbetjeve, për pranimin e mbetjeve, janë më të gjera për landfillet e mbetjeve inerte, dhe janë më pak për landfillet për mbetje jo të rrezikshme, dhe më të kufizuara për ato për mbetje të rrezikshme, për shkak të nivelit më të lartë të mbrojtjes mjedisore që parashikohet për këto dy të fundit.

Procedurat e përgjithshme për testimin dhe pranimin e mbetjeve

Pranimi i mbetjeve përfshin tre nivele:

Niveli 1: Karakterizimi bazë

Kjo përbën një përcaktim të plotë, sipas metodave të standardizuara të analizës dhe testimit të sjelljes, të aftësisë së lëngëzimit në afat të shkurtër dhe afat të gjatë dhe/ose të vetive karakteristike të mbetjeve.

Niveli 2: Testimi i përputhshmërisë

Kjo përfshin testime periodike me metoda më të thjeshta të standardizuara të analizës dhe testimit të sjelljes së mbetjes, për të përcaktuar nëse një mbetje përputhet me kushtet e lejes së mjedisit dhe/ose me kriteret specifike. Testet përqendrohen në variabla kryesore dhe në sjellje të identifikuara nga karakterizimi bazë.

Niveli 3: Verifikimi në vend

Kjo përfshin metoda të kontrollit të shpejtë për të konfirmuar që një mbetje është e njëjtë me atë që i është nënshtuar testimit të përputhshmërisë dhe që është përshkruar në dokumentet shoqëruese. Mund të konsistojë në një inspektim vizual të ngarkesës së mbetjeve përpara dhe pas shkarkimit në landfill.

Një lloj i veçantë mbetjeje duhet zakonisht të karakterizohet në Nivelin 1 dhe të përmbushë kriteret përkatëse për t'u pranuar në një listë referente. Për të qëndruar në një listë specifike për vendin, një lloj i veçantë mbetjeje duhet të testohet në intervale të rregullta (p.sh. çdo vit) sipas Nivelit 2 dhe të përmbushë kriteret përkatëse. Çdo ngarkesë mbetjesh që mbërrin në hyrjen e një landfilli duhet t'i nënshtrohet verifikimit të Nivelit 3.

Kërkesa të veçanta për merkurin metalik

Për qëllime të ruajtjes së përkohshme për më shumë se 1 vit të merkurit metalik, zbatohen kërkesat e mëposhtme:

A. Përbërja e merkurit

- përmbajtje mercuri më shumë se 99.9% peshë-peshë,
- pa papastërti që mund të korrodojnë çelikut (p.sh. acide nitrike, kripëra kloruri).

B. Kontejnerët

- prej çeliku të karbonit (ASTM A36) ose çeliku inox (AISI 304, 316L),
- rezistentë ndaj korrozionit dhe goditjeve,
- pa saldime, të mbyllur hermetikisht,
- me rezistencë ndaj kushteve të magazinimit,
- të testuar për rezistencë ndaj rrjedhjeve dhe rënieve,
- të mbushur jo më shumë se 80% për të shmangur shtypjen ose rrjedhjet në temperaturë të lartë.

C. Procedurat e pranimit

- Pranohen vetëm kontejnerë që plotësojnë kushtet e mësipërme,
- Bëhet një inspektim vizual para ruajtjes dhe kontejnerët e dëmtuar, që rrjedhin ose janë të korroduar nuk pranohen,
- Kontejnerët duhet të kenë një stampë të përherëshme me numrin e identifikimit, materialin, peshën e tyre bosh, prodhuesin dhe datën e prodhimit,
- Kontejnerët duhet të kenë një pllakë të fiksuar që tregon numrin e certifikatës.

D. Certifikata

- Emri dhe adresa e prodhuesit të mbetjeve,
- Emri dhe adresa e personit përgjegjës për mbushjen,
- Vendi dhe data e mbushjes,
- Sasia e merkurit,
- Pastërtia dhe përshkrimi i papastërtive (me raport analitik),
- Konfirmim që kontejnerët janë përdorur vetëm për transport/ruajtje mercuri,
- Numrat e identifikimit të kontejnerëve,
- Çdo shënim tjetër shtesë.

Certifikatat lëshohen nga prodhuesi i mbetjeve ose, në mungesë të tij, nga personi përgjegjës për menaxhimin e tyre.

Klasifikimi uniform i mbetjeve dhe procedurat që zbatohen gjatë pranimit të tyre.

Seksioni 1 i kësaj pjese parashtrohet procedurën që përcakton pranueshmërinë e mbetjeve në landfill. Kjo procedurë konsiston në karakteristikat bazë, testet e përputhshmërisë dhe verifikimin në vendin e landfillit.

Seksioni 2 i kësaj pjese parashtrohet kriteret e pranimit për çdo kategori landfilli. Mbetjet pranohen në landfill vetëm në qoftë se përmbushin kriteret e pranimit të asaj kategorie landfilli.

Seksioni 3 i kësaj pjese rendit metodat që duhen përdorur për marrjen e mostrave dhe analizat e mbetjeve.

1. Procedura për pranimin e mbetjeve në landfille

1.1. Karakterizimi bazë

Karakterizimi bazë është hapi i parë i procedurës së pranimit dhe nënkupton një përcaktim të plotë të mbetjeve, duke grumbulluar të gjithë informacionin e nevojshëm për asgjësimin e sigurt të mbetjeve në periudhë afatgjatë. Karakterizimi bazë kërkohet për çdo lloj mbetje.

1.1.1. Funkzionet e karakterizimit bazë

- a) Informacion bazë mbi mbetjet: lloji, origjina, përbërja, konsistenca, aftësia për të lëngëzuar (leachability) në landfill, dhe kur është e nevojshme dhe e mundur, veti të tjera karakteristike;
- b) Informacion bazë për të kuptuar sjelljen e mbetjeve në landfill dhe opsionet për trajtimin e tyre, siç përcaktohet në pikën 3 të nenit 34 të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
- c) Vlerësimi i mbetjeve kundrejt vlerave kufi.
- d) Gjetja e variablave/ndryshoreve kryesore (parametrat kritikë) për testimin e përputhshmërisë dhe opsionet për thjeshtimin e testimit të përputhshmërisë (që çojnë në një pakësim të konsiderueshëm të përbërësve që duhen matur, por vetëm pas demonstrimit të informacionit përkatës). Karakterizimi mund të japë edhe raportet midis karakterizimit bazë dhe rezultateve të procedurave të thjeshtuara të testeve, si edhe frekuencën e testimit të përputhshmërisë.

Në qoftë se karakterizimi bazë i mbetjeve tregon se mbetjet plotësojnë kriteret për një kategori të caktuar landfilli, siç përcaktohet në seksionin 2, mbetja konsiderohet e pranueshme në atë kategori landfilli. Në rast të kundërt, mbetja nuk pranohet në atë kategori landfilli.

Gjeneruesi i mbetjeve, ose në mungesë të tij, personi përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve, është përgjegjës për saktësinë e informacionit të dhënë për karakterizimin e mbetjeve.

Operatori mban të dhëna për informacionin e kërkuar për një periudhë prej 5 vjetësh.

1.1.2 Kërkesat themelore për karakterizimin bazë të mbetjeve

- a) Burimi dhe origjina e mbetjeve;
- b) Informacioni mbi procesin që gjeneron mbetjet (përshkrimi dhe karakteristikat e lëndëve të para dhe produkteve);
- c) Përshkrimi i trajtimit të kryer mbi mbetjet në përputhje me pikën 3 të nenit 34 të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, ose një deklaratë që sqaron arsyet pse një trajtim i tillë nuk konsiderohet i nevojshëm;
- d) Të dhëna mbi përbërjen e mbetjeve dhe aftësinë për të lëngëzuar (leachability) e mbetjeve në landfill, sipas rastit;
- e) Pamja e jashtme e mbetjeve (era, ngjyra, forma fizike);
- f) Kodi sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 19.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar për klasifikimin e mbetjeve” (Lista e mbetjeve të Bashkimit Europian);
- g) Për mbetjet e rrezikshme (që në katalog pasqyrohen me një kod 6-shifror të shoqëruar me «*»): shënohen edhe vetitë përkatëse që i bëjnë ato të rrezikshme sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
- h) Informacion që vërteton se mbetjet nuk janë të përjashtuara nga landfilli sipas neneve 34 dhe 35 të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;
- i) Kategoria e landfillit ku mund të pranohen mbetjet;
- j) Përkujdesje të tjera që duhen ndërmarrë në landfill, në qoftë se është e nevojshme;

k) Verifikim nëse mbetjet mund të riciklohen ose të rikuperohen.

1.1.3 Testimi

Si rregull i përgjithshëm, për të përftuar informacionin e mësipërm, mbetjet testohen.

Përveç kullueshmërisë së mbetjeve në landfill, me anë të testimit duhet të njihet ose të përcaktohet edhe përbërja e mbetjeve. Testet që përdoren për karakterizimin bazë përfshijnë gjithmonë edhe ato që përdoren për testimin e përputhshmërisë.

Përmbajtja e karakterizimit, shkalla e testimit laboratorik të kërkuar dhe marrëdhënia ndërmjet karakterizimit bazë dhe kontrollit të përputhshmërisë varet nga lloji i mbetjeve.

Ekziston një dallim midis:

- a) mbetjeve që gjenerohen rregullisht në të njëjtin proces;
- b) mbetjeve që nuk gjenerohen rregullisht.

Karakterizimet e detajuara në pikat (a) dhe (b) sigurojnë informacion që mund të krahasohet drejtpërdrejt me kriteret e pranimit për kategoritë përkatëse të landfillit, dhe përveç kësaj, edhe informacion përshkrues (p.sh. pasojat e depozitimit bashkë me mbetjet bashkiake).

- a) Mbetjet që gjenerohen rregullisht në të njëjtin proces

Këto janë mbetje të njëjta dhe konsistente të gjeneruara rregullisht gjatë të njëjtit proces, ku:

- instalimet dhe procesi i gjenerimit të mbetjeve njihen mirë dhe materialet që futen në proces dhe vetë procesi janë të mirëpërcaktuar,
- operatori i instalimit ofron të gjithë informacionin e nevojshëm dhe informon operatorin e landfillit për ndryshimet në proces (veçanërisht për ndryshimet lidhur me materialet që futen në proces).

Procesi shpesh kryhet në një instalim të vetëm. Mbetjet mund të jenë gjeneruar edhe ngainstalime të ndryshme, në qoftë se identifikohen si një rrymë e vetme me karakteristika të zakonshme brenda kufijve të njohur (p.sh. hiri që mbetet nga incinerimi i mbetjeve bashkiake).

Për këto mbetje karakterizimi bazë përfshin edhe kërkesat themelore të renditura në seksionin 1.1.2 dhe veçanërisht kërkesat që vijnë:

- llojshmërinë e përbërësve të mbetjeve të veçanta;
- llojshmërinë dhe ndryshueshmërinë e vetive karakteristike;
- kullueshmërinë e mbetjeve në landfill, të përcaktuar nga testi i kullueshmërisë së lëngjeve të një partie mbetjesh dhe/ose testi i përshkueshmërisë dhe/ose testi i varësisë nga pH, në qoftë se kërkohen;
- variablat/ndryshoret kryesore testohen rregullisht.

Në qoftë se mbetjet gjenerohen nga i njëjti proces në instalime të ndryshme, informacioni jepet për qëllime vlerësimi. Për pasojë, merren një numër matjesh i mjaftueshëm për të treguar llojshmërinë dhe ndryshueshmërinë e vetive karakteristike të mbetjeve. Më pas, po qe se nuk kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme në procesin e gjenerimit, mbetjet konsiderohen të karakterizuara dhe rrjedhimisht i nënshtrohen vetëm testit të përputhshmërisë.

Për mbetjet që gjenerohen nga i njëjti proces në të njëjtin instalim, rezultatet e matjeve mund të tregojnë vetëm ndryshime të vogla të vetive të mbetjeve në krahasim me vlerat kufi respektive.

Më pas, po qe se nuk kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme në procesin e gjenerimit, mbetjet konsiderohen të karakterizuara dhe rrjedhimisht i nënshtrohen vetëm testit të përputhshmërisë.

Mbetjet nga impiantet për grupimin ose përzierjen e mbetjeve, nga stacionet e transferimit të mbetjeve ose rrymat e mbetjeve të përziara nga grumbulluesit e mbetjeve, mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në vetitë e tyre. Kjo gjë merret parasysh gjatë karakterizimit bazë.

Mbetje të tilla mund të klasifikohen nën rastin (b).

b) Mbetjet që nuk gjenerohen rregullisht

Këto mbetje nuk gjenerohen rregullisht nga i njëjti proces në të njëjtin instalim dhe nuk janë pjesë e një rryme mbetjesh të mirë karakterizuar. Çdo parti mbetjesh të tilla të gjeneruara, karakterizohet. Testimi për përputhshmërinë nuk kërkohet, pasi çdo parti e gjeneruar karakterizohet.

1.1.4 Rastet kur nuk kërkohet testimi

Testimi për karakterizimin bazë përjashtohet në rastet kur:

- a) mbetja bën pjesë në një listë mbetjesh që nuk kërkojnë teste, siç përcaktohet në seksionin 2;
- b) i gjithë informacioni i nevojshëm për klasifikimin bazë është i njohur dhe i justifikuar drejt për të kënaqur plotësisht kërkesat e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit;
- c) për lloje të caktuara mbetjesh testimi është jo praktik ose kur nuk disponohen procedurat e duhura të testimit dhe kriteret e pranimit. Kjo gjë justifikohet dhe dokumentohet, duke përfshirë edhe arsyet pse mbetja është konsideruar e pranueshme në atë kategori landfilli.

1.2. Testi i përputhshmërisë

Mbetjet që, në bazë të karakterizimit bazë sipas seksionit 1, janë konsideruar të pranueshme për atë kategori landfilli i nënshtrohen më tej testit të përputhshmërisë për të përcaktuar nëse ato përputhen me rezultatet e karakterizimit bazë dhe kriteret përkatëse të pranimit, siç përcaktohet në seksionin 2.

Funksioni i testimit të përputhshmërisë kontrollon periodikisht rrymat e mbetjeve që gjenerohen rregullisht.

Parametrat që duhen testuar përcaktohen në karakterizimin bazë. Parametrat duhet të jenë të lidhur me informacionin e karakterizimit bazë; siç përcaktohet në karakterizimin bazë, për parametrat kritikë (variablat/ndryshoret kryesore) nevojitet vetëm një kontroll. Kontrolli tregon nëse mbetjet respektojnë vlerat kufi të parametrave kritikë.

Testet që përdoren për testimin e përputhshmërisë, janë një ose disa prej testeve që përdoren për karakterizimin bazë. Testimi duhet të konsistojë të paktën në një test kullueshmëriepër çdo parti. Për këtë qëllim përdoren metodat e listuara në seksionin 3.

Mbetjet që përjashtohen nga kërkesat për testim për karakterizimin bazë në seksionin 1.1.4(a) dhe seksionin 1.1.4(c) përjashtohen edhe nga testimi i përputhshmërisë. Megjithatë ato kanë nevojë të kontrollohen për përputhshmëri me informacionin e karakterizimit bazë, përveç testimit.

Testimi i përputhshmërisë kryhet të paktën një herë në vit dhe operatori siguron në çdorast që

testimi i përputhshmërisë të kryhet në kuadrin dhe frekuencën e përcaktuar ngakararakterizimi bazë.

Të dhënat e regjistruara me rezultatet e testeve mbahen për një periudhë prej 5 vjetësh.

1.3. Verifikimi në vend

Çdo ngarkesë mbetjesh e dërguar në landfill duhet të inspektohet me sy përpara dhe pas shkarkimit. Dokumentacioni shoqërues duhet të kontrollohet.

Për mbetjet e depozituara nga prodhuesi i mbetjeve në një landfill nën kontrollin e tij, ky verifikim duhet bërë në pikën e nisjes.

Mbetjet mund të pranohen në landfill, në qoftë se janë njëloj me ato që kanë qenë subjekt i karakterizimit bazë dhe testimit të përputhshmërisë, dhe që janë përshkruar në dokumentet shoqëruese. Në rast të kundërt, mbetjet nuk duhet të pranohen.

Ministri me urdhër, përcakton kërkesat e testit për verifikimin në vend, duke përfshirë aty ku është e mundur, metodat e testeve të shpejta.

Me t'u dorëzuar, kampionet duhen marrë në mënyrë periodike. Kampionet duhet të mbahen pas pranimin të mbetjeve për një periudhë jo më të shkurtër se një muaj.

2. Kriteret e pranimin të mbetjeve në landfill

Ky seksion përcakton kriteret për pranimin e mbetjeve në secilin nga kategoritë e landfillit, përfshirë kriteret për depozitim nën dhe.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur jep leje mjedisi për pranimin e mbetjeve në landfillin e kategorisë përkatëse, sipas rastit, mund të pranojë vlera deri në tri herë më të larta se vlerat kufi të parametrave specifike të renditur në këtë seksion, përveç:

- karbonit organik të tretur (DOC) në seksionet 2.1.2.1, 2.2.2, 2.3.1 dhe 2.4.1;
- BTEX (benzeni, tolueni, etilbenzeni, ksileni);
- PCBs (bifenilet e poliklorinuara) dhe vajit mineral në seksionin 2.1.2.2;
- karbonit organik total (TOC) dhe pH në seksionin 2.3.2 dhe humbjes në ndezje (LOI) dhe/ose TOC në seksionin 2.4.2; dhe
- kufizimit të rritjes së mundshme të vlerës kufi për TOC në seksionin 2.1.2.2 deri në vetëm dy herë më të larta se vlera kufi.

Pranimi i këtyre vlerave bëhet duke marrë në konsideratë:

- karakteristikat e landfillit dhe të rrethinave të tij;
- shkarkimet nga landfilli (përfshirë edhe lëngjet kulluese); dhe
- kufijtë e parametrave specifike në këtë seksion, që sipas vlerësimit të rrezikut, nuk paraqesin rrezik shtesë për mjedisin.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit mban një regjistër për numrin e lejeve të lëshuara çdo vitsipas kësaj

dispozite.

2.1. Kriteret për landfillet e mbetjeve inerte

2.1.1. Lista e mbetjeve që pranohen pa u testuar në landfillet e mbetjeve inerte

Mbetjet në listën e mëposhtme plotësojnë kriteret e përcaktuara në përkufizimin e mbetjeve inerte në ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe kriteret e renditura në seksionin 2.1.2. Këto mbetje pranohen në landfillet e mbetjeve inerte pa iu nënshtruar testimit.

Mbetjet duhet të jenë nga një rrymë e vetme (vetëm një burim) i një lloji të vetëm. Mbetjet e ndryshme që përmbahen në listë mund të pranohen së bashku, me kusht që ato të vijnë nga i njëjti burim.

Në rast dyshimi për kontaminim (si nga inspektimi vizual, ashtu edhe nga njohuritë për origjinën e mbetjeve) duhet të aplikohet testimi ose në rast të kundërt mbetjet refuzohen. Në qoftë se mbetjet e listuara janë të kontaminuara ose përmbajnë materiale ose substanca të tjera siç janë metalet, asbesti, plastikët, kimikatet, etj. në një masë që rrit shkallën e rrezikut të lidhur me mbetjet, në mënyrë të mjaftueshme për të justifikuar asgjësimin e tyre në kategori të tjera landfilli, ato mund të mos pranohen në landfillin e mbetjeve inerte.

Në qoftë se ka ndonjë dyshim që mbetjet nuk përmbushin përkufizimin e mbetjeve inerte dhe kriteret e listuara në seksionin 2.1.2 apo që mbetjet janë të kontaminuara, duhet të aplikohet testimi. Për këtë qëllim duhet të përdoren metodat e listuara nën seksionin 3.

Kodi sipas katalogut të mbetjeve	Përshkrimi	Kufizimi
10 11 03	Mbetjet nga materialet fibroze me bazë qelqi	Vetëm pa lidhës organikë
15 01 07	Ambalazhet e qelqit	
17 01 01	Betoni	Vetëm mbetje të përzgjedhura nga ndërtimet dhe shembjet ()
17 01 02	Tullat	Vetëm mbetje të përzgjedhura nga ndërtimet dhe shembjet (*)
17 01 03	Pllakat dhe qeramikat	Vetëm mbetje të përzgjedhura nga ndërtimet dhe shembjet (*)
17 01 07	Përzierje e betonit, tullave, pllakave dhe qeramikës	Vetëm mbetje të përzgjedhura nga ndërtimet dhe shembjet (*)
17 02 02	Qelqi	
17 05 04	Dherat dhe gurët	Përrjashtuar shtresat e sipërme të dheut, torfat; përjashtuar dherat dhe gurët nga vendet e kontaminuara
19 12 05	Qelqi	
20 01 02	Qelqi	Vetëm qelqi i grumbulluar në mënyrë të diferencuar

20 02 02	Dherat dhe gurët	Vetëm mbetjet nga kopshtet dhe parqet, përjashtuar shtresat e sipërme të dheut, torfat
----------	------------------	--

* Mbetjet (*), mbetje të përzgjedhura nga ndërtimet dhe shembjet: me përmbajtje të ulët të llojeve të materialeve të tjera (siç janë metalet, plastikët, dherat, përbërjet organike, druri, goma etj.). Origjina e mbetjeve duhet të jetë e njohur.

- Asnjë mbetje nga ndërtimet dhe shembjet dhe nga ndërtimet, të ndotura me substanca të rrezikshme organike ose inorganike (p.sh. për shkak të proceseve të prodhimit në ndërtim), ndotje toke, depozitimi dhe përdorimi i pesticideve ose substancave të tjera të rrezikshme, etj., në rast se nuk bëhet e qartë që ndërtimet e shembura nuk janë të ndotura në mënyrë të konsiderueshme.
- Asnjë mbetje nga ndërtimet dhe shembjet nga ndërtimet, të trajtuara, të mbuluara ose të lyera me materiale, që përmbajnë substanca të rrezikshme në sasi të konsiderueshme.

Mbetjet që nuk janë renditur në këtë listë duhet t'i nënshtrohen testimit siç parashtrahet në seksionin 1 për të përcaktuar nëse ato përmbushin kriteret për pranueshmërinë e mbetjeve në landfillet e mbetjeve inerte, siç përcaktohet në seksionin 2.1.2.

2.1.2. Vlerat kufi për mbetjet e pranueshme në landfillet e mbetjeve inerte

2.1.2.1. Vlerat kufi të lëngëzimit

Për mbetjet që pranohen në landfillet e mbetjeve inerte zbatohen vlerat kufi të lëngëzimit si më poshtë, të llogaritura si raport i vëllimit të lëngjeve të kullimit ndaj masës së materialeve të ngurta (L/S) të 2 litra/kg dhe 10 litra/kg për çlirimin total dhe të shprehura drejtpërdrejt në mg/l për C0 (eluati i parë i testit të perkolimit është L/S = 0,1 l/kg).

Përbërësi	L/S = 2 l/kg (mg/kg substancë e thatë)	L/S = 10 l/kg (mg/kg substancë e thatë)	C0 (testi i perkolimit (mg/L))
As (Arsenik)	0.1	0.5	0.06
Ba (Barium)	7	20	4
Cd (Kadmium)	0.03	0.04	0.02
Cr (total) (Krom total)	0.2	0.5	0.1
Cu (Bakër)	0.9	2	0.6
Hg (Mërkur)	0.003	0.01	0.002
Mo (Molibden)	0.3	0.5	0.15
Ni (Nikel)	0.2	0.4	0.12
Pb (Plumb)	0.2	0.5	0.15
Sb (Antimoni)	0.02	0.06	0.1
Se (Selen)	0.06	0.1	0.04
Zn (Zink)	2	4	1.2

Klorure	550	800	460
Fluorure	4	1	2.5
Sulfate	560 (*)	1000 (*)	1500
Indeksi i Fenolit	0.5	1	0.3
DOC (**)	240	500	160
TDS (***)	2500	4000	--

(*) Në qoftë se mbetja nuk i përmbush këto vlera për sulfatet, ajo ende mund të konsiderohet se i plotëson kriteret e pranimit në qoftë se lëngu i kullimit nuk kapërcen asnjë nga vlerat që vijnë: 1,500 mg/l si CO në L/S = 0,1 l/kg dhe 6,000 mg/kg në L/S=10l/kg. Për të përcaktuar vlerat kufi në L/S=0,1l/kg nën kushtet e ekuilibrit fillestar është e nevojshme të përdoret testi i perkolimit, ndërsa vlera në L/S=10l/kg mund të përcaktohet ose nëpërmjet testit të perkolimit të lëngjeve të kullimit nga një parti ose nëpërmjet testit të perkolimit në kushte të përafërta me ato të ekuilibrit lokal.

(**) Në qoftë se mbetja nuk i përmbush këto vlera për DOC në vlerën e pH-it të vet, mund të testohet në mënyrë alternative midis L/S=10l/kg dhe një pH ndërmjet 7,5 dhe 8,0.

Mbetja mund të konsiderohet se i përmbush kriteret e pranimit për DOC, në qoftë se rezultati i këtij përcaktimi nuk i kalon 500 mg/kg. (ekziston një draft metodë e bazuar në standardin prEN 14429).

(***) Vlerat për lëndët e ngurta totale të tretshme (TDS) mund të përdoret në mënyrë alternative me vlerat e sulfateve dhe klorureve.

2.1.2.2. Vlerat kufi për përmbajtjen totale të parametrave organikë

Përveç vlerave kufi të kullimit të lëngjeve nga landfilli të dhëna në seksionin 2.1.2.1, mbetjet inerte duhet të plotësojnë edhe këto vlera të tjera kufi:

Parametri	Vlera (mg/L)
Karboni organik total (TOC)	30,000 (*)
BTEX (benzeni, tolueni, etilbenzeni, ksileni)	6
PCBs (bifenilet e poliklorinuara, 7 konfigurimet)	1
Vaj mineral (C10 deri C40)	500
PAHs (hidrokarburet policiklike aromatike)	vlerat kufi duhet të përcaktohen nga ministria

(*) Në rastin e dherave, Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të lejojë një vlerë kufi më të lartë, me kusht që për L/S = 10 l/kg si për vetë pH e vetë dheut, ashtu edhe për një vlerë pH ndërmjet 7,5 dhe 8,0 të merret vlera e DOC prej 500mg/kg.

2.2. Kriteret për landfillet e mbetjeve jo të rrezikshme

Në këtë aneks, parashtrohen vlerat kufi vetëm për mbetjet jo të rrezikshme, që asgjësohen në të njëjtën qelizë me mbetje të rrezikshme që janë të qëndrueshme dhe jo reaktive.

2.2.1. Mbetjet e pranueshme pa testim në landfillet e mbetjeve jo të rrezikshme

Mbetjet shtëpiake, siç përcaktohet në ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, që klasifikohen si mbetje jo të rrezikshme në kapitullin 20 të katalogut të mbetjeve (në përputhje me listën europiane të mbetjeve), dhe që janë pjesë e mbetjeve shtëpiake jo të rrezikshme të grumbulluara në mënyrë të diferencuar, si dhe materialet e njëjta jo të rrezikshme nga burime të tjera, mund të pranohen në landfillet e mbetjeve jo të rrezikshme pa iu nënshtruar testimi.

Mbetjet mund të mos pranohen në qoftë se nuk i janë nënshtruar trajtimeve të mëparshme sipas kërkesave të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” ose në qoftë se ato janë të kontaminuara në atë masë që rrit rrezikun e tyre aq sa të justifikohet asgjësimi i tyre në impiante të tjera.

Ato mund të mos pranohen në qelizat ku pranohen mbetjet e rrezikshme të qëndrueshme jo reaktive sipas kërkesave të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

2.2.2. Vlerat kufi për mbetjet jo të rrezikshme

Vlerat kufi që vijojnë zbatohen për mbetjet granulare jo të rrezikshme që pranohen në të njëjtën qelizë me mbetjet e rrezikshme të qëndrueshme jo reaktive, të llogaritura në L/S = 2 dhe 10 l/kg për çlirimet totale dhe të shprehura drejtpërdrejt në mg/l për C0 (në eluatën e parë të testit të perkolimit në L/S = 0,1 l/kg). Mbetjet granulare përfshijnë të gjitha mbetjet që nuk janë monolite.

Përbërësi	L/S = 2 l/kg (mg/kg substancë e thatë)	L/S = 10 l/kg (mg/kg substancë e thatë)	C0 (testi i perkolimit) (mg/L)
As (Arsenik)	0.4	2	0.3
Ba (Barium)	30	100	20
Cd (Kadmium)	0.6	1	0.3
Cr (Krom total)	4	10	2.5
Cu (Bakër)	25	50	30
Hg (Mërkur)	0.05	0.2	0.03
Mo (Molibden)	5	10	3.5
Ni (Nikel)	5	10	3
Pb (Plumb)	5	10	3
Sb (Antimoni)	0.2	0.7	0.15
Se (Selen)	0.3	0.5	0.2
Zn (Zink)	25	50	15
Klorure	10,000	15,000	8,500
Fluorure	60	150	40
Sulfate	10,000	20,000	7,000

DOC (*)	380	800	250
TDS (**)	40,000	60,000	--

(*) Në qoftë se mbetja nuk i plotëson këto vlera për DOC në pH e vet, ajo mund të testohet në mënyrë alternative në L/S=10l/kg dhe në një pH 7,5-8,0. Mbetja mund të konsiderohet se i përmbush kriteret e pranimit për DOC, në qoftë se rezultati i këtij përcaktimi nuk i kalon 800 mg/kg (ekziston një draft metodë e bazuar në standardin prEN 14429).

(**) Vlerat për TDS mund të përdoren në mënyrë alternative me vlerat e sulfateve dhe klorureve.

2.2.3. Mbetjet e gipsit

Materialet jo të rrezikshme me bazë gipsi duhet të asgjësohen vetëm në landfillet e mbetjeve jo të rrezikshme në qelizat ku nuk pranohen mbetje të bio-degradueshme. Për mbetjet që asgjësohen në landfill, së bashku me materialet me bazë gipsi zbatohen vlerat limit për TOC dhe DOC që janë dhënë në seksionet 2.3.2 dhe 2.3.1.

2.3. Kriteret për mbetjet e rrezikshme që pranohen në landfillet e mbetjeve jo të rrezikshme

Mbetje të qëndrueshme, jo reaktive janë ato mbetje për të cilat, as në kushtet e zbatimit të projektit të landfillit dhe as në kushtet e aksidenteve të parashikueshme, në periudhë afatgjatë mënyra e lëngëzimit (leaching) nuk ndryshon negativisht:

- vetëm te mbetjet (për shembull, me anë të biodegradimit);
- nën ndikimin e kushteve mjedisore afatgjata (për shembull uji, ajri, temperatura, shtrëngimi mekanik);
- nga ndikimi i mbetjeve të tjera (përfshirë produktet e mbetjeve siç janë lëngjet e kullimit (leachate) dhe gazi i landfillit).

2.3.1. Vlerat kufi të lëngëzimit (leaching)

Vlerat kufi të lëngëzimit në landfill që vijnë më poshtë zbatohen për mbetjet granulare të rrezikshme që pranohen në landfillet e mbetjeve jo të rrezikshme, të llogaritura në L/S = 2 dhe 10 l/kg për çlirimin total dhe të shprehur drejtpërdrejt në mg/l të C0 (eluati i parë i testit të perkolimit në L/S = 0,1 l/kg). Mbetjet granulare përfshijnë të gjitha mbetjet që nuk janë monolite.

Përbërësi	L/S = 2 l/kg (mg/kg substancë e thatë)	L/S = 10 l/kg (mg/kg substancë e thatë)	C0 (testi i perkolimit) (mg/L)
As (Arsenik)	0.4	2	0.3
Ba (Barium)	30	100	20
Cd (Kadmium)	0.6	1	0.3
Cr (Krom) (total)	4	10	2.5

Cu (Bakër)	25	50	30
Hg (Mërkur)	0.05	0.2	0.03
Mo (Molibden)	5	10	3.5
Ni (Nikel)	5	10	3
Pb (Plumb)	5	10	3
Sb (Antimoni)	0.2	0.7	0.15
Se (Seleni)	0.3	0.5	0.2
Zn (Zink)	25	50	15
Klorure	10,000	15,000	8,500
Fluorure	60	150	40
Sulfate	10,000	20,000	7,000
DOC (*)	380	800	250
TDS (**)	40,000	60,000	--

(*) Në qoftë se mbetja nuk i përmbush këto vlera për DOC për pH e vet, ajo mund të testohet në mënyrë alternative në L/S=10l/kg dhe në një pH 7,5-8,0. Mbetja mund të konsiderohet se i përmbush kriteret e pranimit për DOC, në qoftë se rezultati i këtij përcaktimi nuk i kalon 800 mg/kg (Një draft metodë e bazuar në standardin prEN 14429 është e disponueshme).

(**) Vlerat për TDS mund të përdoren në mënyrë alternative për vlerat e sulfateve dhe të klorureve.

Ministri, me urdhër, vendos kriteret për mbetjet monolite që sigurojnë të njëjtin nivel mbrojtjeje të mjedisit që sigurohet nga vlerat kufi të mësipërme.

2.3.2. Kriteret e tjera

Përveç vlerave kufi të kullimit të lëngjeve nga landfilli të paraqitura në seksionin 2.3.1, mbetjet granulare duhet të plotësojnë kriteret shtesë që vijojnë:

Parametri	Vlera
Karboni organik total (TOC)	5% (*)
pH	Minimumi 6
Kapaciteti i neutralizimit të acideve (ANC)	Duhet të llogaritet

(*) Në qoftë se kjo vlerë nuk arrihet, Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të lejojë një vlerë kufi më të lartë, me kusht që vlera e DOC prej 800 mg/kg të arrihet në L/S = 10 l/kg, si në pH e vet materialit ashtu edhe në një vlerë pH midis 7,5 dhe 8,0.

2.3.3. Mbetjet e asbestit

Materialet e ndërtimit, që përmbajnë asbest dhe lloje të tjera mbetjesh asbesti të përshtatshme, mund të asgjësohen në landfillet e mbetjeve jo të rrezikshme pa u testuar.

Për landfillet që marrin materiale ndërtimi që përmbajnë asbest dhe mbetje të tjera asbesti të përshtatshme, duhet të plotësohen kërkesat e mëposhtme:

- Mbetjet nuk duhet të përmbajnë substanca të tjera të rrezikshme përveç asbestit të lidhur, përfshirë fibrat e lidhura nga një agjent lidhës ose të paketuara në plastikë.
- Landfilli pranon vetëm materiale ndërtimi që përmbajnë asbest dhe mbetje të tjera asbesti të

përshtatshme. Këto mbetje mund të asgjësohen edhe në një qelizë të veçantë të landfillit për mbetjet jo të rrezikshme, në qoftë se qeliza është e izoluar siç duhet.

- Me qëllim që të shmanget shpërndarja e fibrave, zona e depozitimit mbulohet me materialin e duhur çdo ditë dhe përpara çdo operacioni ngjeshjeje, dhe në qoftë se mbetja nuk është e ambalazhuar, ajo spërkatet rregullisht.
- Me qëllim që të shmanget shpërndarja e fibrave në landfill/qelizë vendoset një mbulesë sipërme përfundimtare.
- Në landfill/parcelë nuk kryhet asnjë punë që mund të çojë në përhapjen e fibrave (p.sh.shpimi i puseve).
- Pas mbylljes, ruhet plani i vendndodhjes së landfillit/qelizës, që tregon se janë depozituar mbetje asbesti.
- Me qëllim që të shmanget kontakti i njerëzve me mbetjet, merren masat e duhura për tëkufizuar përdorimin e mundshëm të tokës pas mbylljes së landfillit.

Për landfillet që marrin vetëm materiale ndërtimi që përmbajnë asbest, kërkesat e përcaktuara në aneksin I seksioni 3.2 dhe 3.3 mund të reduktohen, në qoftë se plotësohen kërkesat e mësipërme.

2.4. Kriteret për mbetjet e pranueshme në landfillet për mbetjet e rrezikshme

2.4.1. Vlerat kufi të lëngëzimit (leaching)

Vlerat kufi të lëngëzimit (leaching) që jepen më poshtë zbatohen për mbetjet granulare që pranohen në landfillet e mbetjeve të rrezikshme, të llogaritura në L/S = 2 dhe 10 l/kg për çlirimin total dhe të shprehura drejtpërdrejt në mg/l për C0 (në eluatit e parë të testit të perkolimit në L/S = 0,1 l/kg). Mbetjet granulare përfshijnë të gjitha mbetjet që nuk janë monolite.

Përbërësi	L/S = 2 l/kg (mg/kg substancë e thatë)	L/S = 10 l/kg (mg/kg substancë e thatë)	C0 (testi i perkolimit) (mg/L)
As (Arsenik)	6	25	3
Ba (Barium)	100	300	60
Cd (Kadmium)	3	5	1.7
Cr (Krom total)	25	70	15
Cu (Bakër)	50	100	60
Hg (Mërkur)	0.5	2	0.3
Mo (Molibdeni)	20	30	10
Ni (Nikel)	20	40	12
Pb (Plumb)	25	50	15
Sb (Antimoni)	2	5	1
Se (Seleni)	4	7	3
Zn (Zinku)	90	200	60

Klorure	17,000	25,000	15,000
Fluorure	200	500	120
Sulfate	25,000	50,000	17,000
DOC (*)	480	1,000	320
TDS (**)	70,000	100,000	--

(*) Në qoftë se mbetja nuk i përmbush këto vlera për DOC në pH e vet, ajo mund të testohet në mënyrë alternative edhe në L/S=10l/kg dhe pH 7,5-8,0. Mbetja mund të konsiderohet se i përmbush kriteret e pranimit për DOC, në qoftë se rezultati i këtij përcaktimi nuk i kalon 1,000 mg/kg (ekziston një draft metodë e bazuar në standardin prEN 14429).

(**) Vlerat e TDS mund të përdoren në vend të vlerave të sulfateve dhe klorureve.

2.4.2. Krite të tjera

Përveç vlerave kufi të lëngëzimit (leaching) nga landfilli sipas seksionit 2.4.1, mbetjet e rrezikshme duhet të plotësojnë edhe kriteret e mëposhtme:

Parametri	Vlera
Humbja nga ndezja (LOI)	10% (*)
Karboni organik total (TOC)	6% (**)
Kapaciteti i neutralizimit acid (ANC)	Duhet vlerësuar (llogaritur)

(*) Duhet përdorur ose LOI ose TOC.

(**) Nëse kjo vlerë nuk arrihet, Agjencia Kombetare e Mjedisit mund të lejojë një vlerë kufi më të lartë, me kusht që vlera e DOC prej 1,000 mg/kg të arrihet kur L/S = 10 l/kg, ose në pH e vetë materialit ose në një vlerë pH ndërmjet 7,5 dhe 8,0.

2.5. Kriteret për depozitimin nëntokësor

Për pranimin e mbetjeve në një landfilli nën dhe (nëntokësor), duhet të bëhet vlerësim i sigurisë për atë vend specifik siç përcaktohet në aneksin III. Mbetjet mund të pranohen vetëm nëse janë në përputhje me vlerësimin e sigurisë së atij landfilli specifik.

Në landfillet nën dhe (nëntokësore) të mbetjeve inerte, mund të pranohen vetëm ato mbetje që plotësojnë kriteret e përcaktuara në seksionin 2.1.

Në landfillet nën dhe (nëntokësore) të mbetjeve jo të rrezikshme, mund të pranohen vetëm ato mbetje që plotësojnë kriteret e përcaktuara në seksionin 2.2 ose në seksionin 2.3.

Në landfillet nën dhe (nëntokësore) të mbetjeve të rrezikshme, mbetjet mund të pranohen vetëm nëse janë në përputhje me vlerësimin e sigurisë së atij landfilli specifik. Në këtë rast, kriteret e përcaktuara në seksionin 2.4 nuk zbatohen. Megjithatë, mbetjet duhet t'inshtrohen procedurës së pranimit siç përcaktohet në seksionin 1.

3. Marrja e mostrave dhe metodat e testimit

Marrja e mostrave dhe testi për karakterizimin bazë dhe testi i përputhshmërisë kryhen nga persona dhe institucione të pavarur dhe të kualifikuar. Laboratorët duhet të kenë eksperiencë të

provuar në testimet dhe analizat e mbetjeve, si edhe një sistem eficient për sigurimin e cilësisë.

Marrja e mostrave mund të kryhet nga gjeneruesit ose operatorët e mbetjeve me kusht që, me mbikëqyrjen e duhur të personave dhe institucioneve të pavarur dhe të kualifikuar, të sigurohet arritja e objektivave të përcaktuara në këtë rregullore.

Testimi i mbetjeve mund të kryhet nga prodhuesit ose operatorët e mbetjeve nëse ata kanë ngritur një sistem të përshtatshëm për sigurimin e cilësisë përfshirë kontrollin periodik të pavarur.

Për sa kohë që një standard CEN nuk disponohet si një standard EN zyrtar, do të përdoren ose procedurat/standartet kombëtare ose projekt standardi CEN, kur ky i fundit të ketë arritur fazën e standardit prEN.

Për marrjen e mostrave të mbetjeve – për karakterizimin bazë, testin e përputhshmërisë dhe testin e verifikimit në terren – duhet të hartohet plani i marrjes së mostrave sipas pjesës 1 të standardit të marrjes së mostrave aktualisht të zhvilluar nga CEN.

Vetitë e përgjithshme të mbetjeve	
EN 13137	Përcaktimi i TOC te mbetjet, llumrat dhe sedimentet
prEN 14346	Llogaritja e lëndëve të thata nëpërmjet përcaktimit të mbetjeve të thata ose përmbajtjes së ujit
Testet e lëngëzimit (<i>leaching</i>)	
prEN 14405	Testi i përcaktimit të sjelljes së lëngëzimit – testi i perkolimit me drejtim për lart (Testi i perkolimit me drejtim lart për përbërësit inorganik)
EN 12457/1-4	Testi i përputhshmërisë së lëngëzimit të mbetjeve granulare dhe llumrave d: Pjesa 1 : L/S = 2 l/kg, madhësia e pjesëzës < 4 mm Pjesa 2: L/S = 10 l/kg, madhësia e pjesëzës < 4 mm Pjesa 3: L/S = 2 dhe 8 l/kg, madhësia e pjesëzës < 4 mm Pjesa 4: L/S = 10 l/kg, madhësia e pjesëzës < 10 mm
Digjestimi (digestion) i mbetjeve të papërpunuara	
EN 13657	Digjestimi për përcaktimin e mëtejshëm të pjesës së elementëve të tretshëm në ujë (digjestimi i pjesshëm i mbetjeve të ngurta para analizave elementare, që e lenë matricën e silikateve të paprekur)
EN 13656	Digjestimi me anë të mikrovalëve me përzierje acidi fluorhidrik (HF), acidi nitrik (HNO ₃) dhe acidi klorhidric (HCl) për përcaktimin e mëtejshëm të elementeve (digjestim total i mbetjeve të ngurta para analizave elementare)

Analizat	
ENV 12506	Analiza e eluateve — Përcaktimi i pH, arsenikut - As, bariumit - Ba, kadmiumit - Cd, klorit - Cl, kobaltit - Co, kromit - Cr, kromit VI - CrVI, bakrit - Cu, molibdenumi - Mo, nikelit - Ni, dioksidit të azotit - NO ₂ , plumbit - Pb, squfurit total - S, sulfateve- SO ₄ , vanadiumit – V dhe zinkut - Zn (analiza e përbërësve inorganikë të mbetjeve të ngurta dhe/ose eluateve të tyre; elementet madhore, minore dhe gjurmëve të tyre)
ENV 13370	Analiza e eluateve — Përcaktimi i amoniumit, përbërje organike halogjene - AOX, konduktivitetit, mërkurit - Hg, indeksit të fenolit, karbonit organik total - TOC, CN –së lehtësisht të çlirueshme, fluorit - F (analiza e përbërësve inorganikë të mbetjeve të ngurta dhe/ose eluateve (anionet) e tyre
prEN 14039	Përcaktimi i përmbajtjes hidrokarbure në diapazonin C10 deri në C40 me gaz kromatograf

Ministria amendon këtë listë me standardet e reja CEN, dhe miraton gjithashtu metodat që do të përdoren për testet dhe analizat, për të cilat nuk disponohen (akoma) metoda (CEN).

SHTOJCA III
PROCEDURAT E KONTROLLIT DHE VETËMONITORIMIT NË FAZAT E OPERIMIT
DHE KUJDESIT PAS MBYLLJES

1. Hyrje

Qëllimi i këtij Shtojce është të përcaktojë procedurat minimale të vetëmonitorimit që duhet kryer për të kontrolluar:

- që mbetjet janë pranuar të asgjësohen në përputhje me kriteret e përcaktuara për kategorinë e landfillit në fjalë;
- që proceset brenda landfillit kryhen siç duhet;
- që sistemet e mbrojtjes e mjedisit funksionojnë plotësisht siç janë planifikuar;
- që kushtet e lejes së landfillit plotësohen.

2. Të dhënat meteorologjike

Kur Agjencia Kombëtare e Mjedisit vendos që balancat e ujit të përdoren si një mjet efektiv për të vlerësuar nëse lëngjet kulluese të landfillit po rrisin nivelin e tyre në trupin e landfillit ose po rrjedhin, përmes vetëmonitorimit në landfill ose në stacionin meteorologjik më të afërt, duhet të grumbullohen këto të dhëna, në përputhje me pikën 5 të nenit 13 të këtij vendimi:

		Faza e operimit	Faza e kujdesit pas mbylljes
2.1	Vëllimi i precipitimit	Çdo ditë	Çdo ditë, shtuar te vlerat mujore
2.2	Temperatura (min, maks, në orën 14.00)	Çdo ditë	Mesatarja mujore
2.3	Drejtimi dhe forca e erës mbizotëruese	Çdo ditë	Nuk kërkohet
2.4	Evaporimi (lizimetri ose metoda të tjera të përshtatshme)	Çdo ditë	Çdo ditë, shtuar te vlerat mujore
2.5	Lagështira atmosferike (në orën 14:00)	Çdo ditë	Mesatarja mujore

3. Të dhënat për shkarkimet: kontrolli i ujit, lëngjeve kulluese të landfillit dhe gazit.

Marrja e mostrave të lëngjeve që kullojnë nga landfilli dhe ujërave sipërfaqësore (nëse janë të pranishëm) duhet të kryhet në pikat përfaqësuese. Marrja e mostrave dhe matja (vëllimi dhe përbërja) e lëngjeve kulluese të landfillit duhet të kryhet në mënyrë të veçantë në çdo pikë ku kullojnë lëngjet e shkarkuara nga ai landfill. Referencë: udhëzime të përgjithshme mbi teknologjinë e marrjes së mostrave, ISO 5667-2 (1991).

Vetëmonitorimi i ujërave sipërfaqësore (nëse janë të pranishëm) duhet të kryhet në jo më pak se dy pika në drejtimin e rrjedhjes, një përpara vendit të landfillit dhe një mbrapa tij.

Vetëmonitorimi i gazit duhet të jetë përfaqësues për çdo seksion të landfillit. Frekuenca e marrjes së mostrave dhe analizave listohet në tabelën e mëposhtme. Për lëngjet kulluese të landfillit dhe për ujin, duhet të merret për vetëmonitorim një mostër përfaqësuese e përbërjes mesatare.

Frekuenca e marrjes së mostrave duhet të përcaktohet në bazë të morfologjisë së mbetjeve në landfill (në pirlg dheu, të groposura etj.). Frekuenca e marrjes së mostrave do të specifikohet në lejen e mjedisit.

		Faza e operimit	Faza e kujdesit pas mbylljes (3)
3.1	Vëllimi i lëngjeve që kullojnë nga landfilli	Çdo muaj (1) (3)	Çdo gjashtë muaj
3.2	Përbërja e lëngjeve që kullojnë nga landfilli (2)	Çdo tremujor (3)	Çdo gjashtë muaj
3.3	Vëllimi dhe përbërja e ujërave sipërfaqësore (7)	Çdo tremujor (3)	Çdo gjashtë muaj
3.4	Shkarkimet potenciale të gazrave dhe trysnia atmosferike (4) – (metan -CH ₄ , dioksid karboni - CO ₂ , oksigjen -O ₂ , sulfur hidrogjeni -H ₂ S, hidrogjen - H ₂ , oksid karboni - CO, etj.)	Çdo muaj (3) (5)	Çdo gjashtë muaj (6)

1) Frekuenca e marrjes së mostrave mund të përcaktohet në bazë të morfologjisë së mbetjeve në landfill (në pirlg dheu, të groposura etj.). Kjo duhet të specifikohet në lejen e mjedisit.

2) Parametrat që duhen matur dhe substancat që duhen analizuar variojnë sipas përbërjes së mbetjeve të depozituara; ato duhet të parashtrohen në lejen e mjedisit dhe të pasqyrojnë karakteristikat e lëngzimit të mbetjeve.

3) Në qoftë se llogaritja e të dhënave tregon se intervalet më të gjata janë po aq efektive, mund të përcaktohet intervale më të gjata. Për lëngjet që kullojnë nga landfilli gjithmonë konduktiviteti duhet të matet të paktën një herë në vit.

4) Këto matje janë të lidhura kryesisht me përmbajtjen e materialeve organike në mbetje.

5) Metani - CH₄, dioksidi i karbonit - CO₂, oksigjeni - O₂, rregullisht, gazrat e tjera siç kërkohet, sipas përbërjes së mbetjeve të depozituara, me vizionin për të pasqyruar veçoritë e tyre të kullimit të lëngjeve.

6) Efienca e sistemit të nxjerrjes së gazit duhet të kontrollohet vazhdimisht.

7) Nisur nga karakteristikat e vendit të landfillit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të vendosë të mos i kërkojë këto matje.

Vini re që seksionet 3.1 dhe 3.2 zbatohen vetëm aty ku ka grumbullim lëngjesh kulluese të landfillit (shikoni Shtojcën I (2)).

4. Mbrojtja e ujërave nëntokësore

4.1. Marrja e mostrave

Matjet duhet të bëhen në mënyrë të tillë që të ofrojnë informacion mbi ujërat nëntokësore që mund të ndikohen nga shkarkimi i mbetjeve. Kërkohet të paktën një pikë matjeje në vendin ku këto ujëra futen në landfill dhe dy në vendin ku ato dalin prej tij. Në varësi të rezultateve të ndonjë studimi hidrogeologjik specifik dhe nevojës për një identifikim sa më të hershëm të ndonjë shkarkimi aksidental të lëngjeve kulluese të landfillit në ujërat tokësorë ky numër mund të rritet.

Mostrat duhet të merren të paktën në tri vendndodhje përpara operacioneve të mbushjes, me

qëllim që të krijojnë vlerat e referencës për mostrat e ardhshme. Referenca: kampionët e ujërave tokësorë, ISO 5667, pjesa 11, 1993.

4.2. Vetëmonitorimi

Parametrat që duhen analizuar në mostrat e marra duhet përcaktuar në varësi të përbërjes së pritshme e lëngjeve që kullojnë nga landfilli dhe të cilësisë së ujërave nëntokësore në zonë.

Në përzgjedhjen e parametrave për analiza duhet marrë parasysh lëvizshmëria në zonën e ujërave tokësorë. Parametrat mund të përfshijnë parametra indikatorë me qëllim që të sigurojnë informacion sa më të hershëm për ndryshimet e cilësisë së ujërave.

Parametrat e rekomanduar janë: pH, TOC, fenolet, metalet e rënda, fluoruret, AS (arseniku), vajrat/hidrokarburet.

		Faza operacionale	Faza e kujdesit pas mbylljes
4.2.1	Niveli i ujërave nëntokësore	çdo gjashtë muaj (1)	çdo gjashtë muaj (1)
4.2.2	Përbërja e ujërave nëntokësore	frekuenca specifike sipas vendit (2) (3)	frekuenca specifike sipas vendit (2) (3)

1) Në qoftë se nivelet e ujërave nëntokësore luhaten, frekuenca duhet të rritet.

2) Frekuenca duhet të bazohet në mundësinë për marrjen e masave rehabilituese në kohën midis marrjes së dy mostrave n.q.s. arrihet një nivel *trigger*, që do të thotë se frekuenca duhet të përcaktohet në bazë të njohurive dhe të vlerësimit të shpejtësisë së rrjedhjes së ujërave nëntokësore.

3) Kur arrihet një nivel trigger (shikoni seksionin 4.3.), është i nevojshëm të bëhet një verifikim duke përsëritur marrjen e mostrave. Kur niveli të jetë konfirmuar, duhet të ndiqet plani i emergjencës (që është përcaktuar në lejen e mjedisit).

4.3. Nivelet sinjalizuese (*trigger*)

Siç referohet në seksionet XII dhe XIII, duhet të konsiderohen se kanë ndodhur efektet negative të rëndësishme kur analiza e mostrave të ujërave nëntokësore tregon një ndryshim të rëndësishëm në cilësinë e tyre. Niveli sinjalizues duhet të përcaktohet duke marrë parasysh formacionet hidrogeologjike specifike në vendndodhjen e landfillit dhe në cilësinë e ujërave nëntokësore. Kur është e mundur, niveli sinjalizues duhet të përcaktohet në lejen e mjedisit.

Vëzhgimet duhet të vlerësohen në bazë të grafikut të kontrollit me rregulla të përcaktuara për kontrollin dhe nivelet për çdo pus me gradient nga poshtë (drejtim poshtë).

Nivelet e kontrollit duhet të përcaktohen nga ndryshimet lokale në cilësinë e ujërave nëntokësore.

5. Vetëmonitorimi sipas topografisë së vendit: të dhëna për trupin e landfillit

		Faza operacionale	Faza e kujdesit pas mbylljes
5.1	Struktura dhe përbërja e trupit të landfillit (1)	çdo vit	
5.2	Sjellja sedimentare e nivelit të trupit të landfillit	çdo vit	çdo vit

1) Të dhënat për statusin e planit të landfillit: sipërfaqja e zënë nga mbetjet, vëllimi dhe përbërja e mbetjeve, metodat e depozitimit, koha dhe kohëzgjatja e depozitimit, llogaritja e kapacitetit të mbetur që është ende i disponueshëm në landfill.

6. Kërkesa specifike për ruajtjen e përkohshme të merkurit metalik

Për qëllimet e ruajtjes së përkohshme për një periudhë më të gjatë se 1 (një) vit të merkurit metalik, zbatohen kërkesat e mëposhtme:

6.1. Kërkesat për monitorim, inspektim dhe situata emergjente

Në vendin e ruajtjes instalohet një sistem monitorimi i vazhdueshëm i avujve të merkurit, me ndjeshmëri jo më të vogël se 0,02 mg mercuri/m³. Sensorët pozicionohen në nivelin e tokës dhe në nivelin e kokës. Sistemi përfshin një sistem sinjalizimi vizual dhe akustik dhe mirëmbajtja e tij kryhet të paktën një herë në vit.

Vendi i ruajtjes dhe kontejnerët që përmbajnë merkurin kontrollohen vizualisht nga një person i autorizuar të paktën një herë në muaj. Në rast zbulimi të rrjedhjeve, operatori merr menjëherë të gjitha masat e nevojshme për të shmangur çdo lëshim të merkurit në mjedis dhe për të rivendosur sigurinë e ruajtjes së merkurit. Çdo rrjedhje konsiderohet se ka shkaktuar pasoja të dëmshme të rëndësishme për mjedisin, në kuptim të pikave 2, 3 dhe 4 të nenit 12 të këtij vendimi.

Në vendin e ruajtjes duhet të jenë të disponueshme plane emergjence dhe pajisje mbrojtëse të përshtatshme për trajtimin e merkurit metalik.

6.2. Mbajtja e të dhënave

Të gjitha dokumentet që përmbajnë të dhënat e parashikuara në seksionin 6 të Shtojcës II dhe në pikën 6.1. të këtij seksioni, përfshirë certifikatën që shoqëron kontejnerët përkatës, si dhe të dhëna që lidhen me heqjen e merkurit nga ruajtja, dërgimin e merkurit pas ruajtjes së përkohshme, destinacionin dhe trajtimin e parashikuar për të, ruhen për një periudhë prej jo më pak se 3 (tre) vjet nga data e përfundimit të ruajtjes.

SHTOJCA IV
KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR LANDFILLET EKZISTUESE

KRITERET E VLERËSIMIT DHE KLASIFIKIMIT

MBROJTJA E UJIT			
Ndotja e ujërave sipërfaqësore	Distanca nga lumi ose në breg të lumit (nëse uji përdoret vetëm për bujqësi)	Ndërmjet 0 dhe 100 m: 0 (e ndaluar) Ndërmjet 100 dhe 300 m: 3 pikë Më shumë se 300 m: 5 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 1.2 Zhvendosja e mbetjeve 1.3 Ndërtimi i një gardhi 2.1 Grumbullimi i ujit me kullimperiferik 2.2 Drenimi dhe grumbullimi i ujërave dhe gazit që dalin nga kullimi (<i>leachate</i>) 2.3 Menaxhimi i ujërave rrjedhëse 2.4 Zbatimi i ruajtjes dhe riqarkullimit të gazit dhe ujit që dalin nga kullimi (<i>leachate</i>) 2.5 Zbatimi i përpunimit të gazit dhe ujërave që dalin nga kullimi (<i>leachate</i>) 3.2 Ndërtimi i pengesave mbrojtëse/stabilizuese 5.1 Zbatimi i mbulimit final dhe mbylljes së landfillit
Ndotja e ujërave sipërfaqësore	Distanca nga bregdeti	Ndërmjet 0 dhe 100 m: 0 (e ndaluar) Ndërmjet 100 dhe 300 m: 3 pikë Më shumë se 300 m: 5 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 2.1 Grumbullimi i ujit me kullimperiferik 2.3 Menaxhimi i ujërave rrjedhëse 5.1 Zbatimi i mbulimit final dhe mbylljes së landfillit
Ndotja e ujërave sipërfaqësore	Distanca nga bregu i liqenit (nëse uji përdoret vetëm për bujqësi)	Ndërmjet 0 dhe 100 m: 0 (e ndaluar) Ndërmjet 100 dhe 300 m: 3 pikë Më shumë se 300 m: 5 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 1.2 Zhvendosja e mbetjeve 1.3 Ndërtimi i një gardhi 2.1 Grumbullimi i ujit me kullimperiferik 2.2 Drenimi dhe grumbullimi i gazit dhe ujërave që dalin nga kullimi (<i>leachate</i>) 2.3 Menaxhimi i ujërave rrjedhëse 2.4 Zbatimi i ruajtjes dhe riqarkullimit të gazit dhe ujërave nga kullimi (<i>leachate</i>)

			<p>2.5 Zbatimi i përpunimit të gazit dhe ujërave nga kullimi (<i>leachate</i>)</p> <p>3.2 Ndërtimi i pengesave për mbrojtje/stabilizim</p> <p>5.1 Zbatimi i mbulimit final dhembylljes së landfillit</p>
Ndotja e ujit të pijshëm	Rrjedha e sipërme e një burimi të përdorur të ujit të pijshëm (ujë sipërfaqësor ose nëntokësor) ose në një zonë të mbrojtur për ujin e pijshëm (zona e menjëhershme e mbulimit)	<p>Ndërmjet 0 dhe 300 m: 0 (e ndaluar)</p> <p>Ndërmjet 300 dhe 800 m: 3 pikë</p> <p>Më shumë se 800 m: 5 pikë</p>	<p>1.1 Largimi i mbetjeve</p> <p>1.2 Zhvendosja e mbetjeve</p> <p>2.1 Grumbullimi i ujit me kullim periferik</p> <p>3.2 Ndërtimi i pengesave për mbrojtje/stabilizim</p> <p>5.1 Zbatimi i mbulimit final dhembylljes së landfillit</p>
Mbrojtja e ujit/ mbrojtja e popullatës	Në një zonë ku mund të ndodhin përmytje	<p>Ndërmjet 0 dhe 100 m: 0 pikë</p> <p>Ndërmjet 100 dhe 300 m: 3 pikë</p> <p>Më shumë se 300 m: 5 pikë</p>	<p>1.1 Largimi i mbetjeve</p> <p>1.2 Zhvendosja e mbetjeve</p> <p>2.1 Grumbullimi i ujit me kullim periferik</p> <p>3.2 Ndërtimi i pengesave për mbrojtje/stabilizim</p>
Mbrojtja e ujit/ mbrojtja e nëntokës	Gjeologjia e zonës së treguar	<p>Përshkueshmëri e lartë e nëntokës: 0 pikë</p> <p>Përshkueshmëri</p>	<p>1.1 Largimi i mbetjeve</p> <p>1.2 Zhvendosja e mbetjeve</p> <p>2.1 Grumbullimi i mbetjeve me kullim periferik</p>

		mesatare e nëntokës: 3 pikë	2.2 Drenimi dhe grumbullimi i gazit dhe ujërave nga kullimi (<i>leachate</i>)
--	--	-----------------------------	---

		Përshkueshmëri e ulët: 5 pikë	
MBROJTJA E POPULLATËS DHE SHQETËSIMI			
Mbrojtja e popullatës/operatorit	Në një zonë të paqëndrueshme (risku i rrëshqitjeve të tokës)	Mbetjet e asgjësuar ose landfillit e mbetjeve paraqesin një risk të konfirmuar kolapsi: 0 pikë Mbetjet dhe landfillet e mbetjeve janë në një zonë potenciale për rrëshqitje toke: 3 pikë Mbetjet e asgjësuar apo landfillet e mbetjeve janë të qëndrueshme dhe nuk ka risk kolapsi apo rrëshqitje toke: 5 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 1.2 Zhvendosja e mbetjeve 1.3 Ndërtimi i një gardhi 3.1 Ndërtimi i digave për stabilitetin e mbetjeve 3.2 Ndërtimi i pengesave për mbrojtje/stabilizim 4.1 Zbatimi i sistemit të evakuimit të gazit
Ekspozimi i njerëzve ndaj ndotjes potenciale	Zona të afërta të banuara legalisht	Ndërmjet 0 dhe 100 m: 0 pikë Ndërmjet 100 dhe 300 m: 3 pikë Më shumë se 300 m: 5 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 1.2 Zhvendosja e mbetjeve 1.3 Ndërtimi i një gardhi 3.2 Ndërtimi i pengesave për mbrojtje/stabilizim 4.1 Zbatimi i sistemit për evakuimin e gazit
Prania potenciale e mbetjeve të rrezikshme, risku për operatorin e landfillit, banorët në afërsi dhe mjedisin	Mbetje industriale apo joubane të pranishme në mbetjet hyrëse.	Prania e mbetjeve industriale të rrezikshme: 0 pikë Prania e mbetjeve industriale inerte: 3 pikë Prania e mbetjeve	1.1 Largimi i mbetjeve 1.2 Zhvendosja e mbetjeve 1.3 Ndërtimi i një gardhi 3.2 Ndërtimi i pengesave për mbrojtje/stabilizim 4.1 Zbatimi i sistemit të evakuimit të gazit

		urbane: 5 pikë	
--	--	----------------	--

MBROJTJA MJEDISORE DHE VLERA TURISTIKE

Degradimi i peizazhit, rënia e vlerës turistike	Në vende të dukshme nga vendet turistike	Po: 0 pikë Jo: 1 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 5.1 Zbatimi i mbulimit final dhembylljes së landfillit
Vende arkeologjike, zona të trashëgimisë kulturore dhe zona të tjera të mbrojtura të përcaktuara si të tilla me VKM (vendim të Këshillit të Ministrave)	Distanca nga zonat e mbrojtura zyrtarisht	Ndërmjet 0 dhe 300 m: 0 (e ndaluar) Ndërmjet 300 dhe 800 m: 3 pikë Më shumë se 800 m: 5 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 5.1 Zbatimi i mbulimit final dhembylljes së landfillit
Ndotja e florës dhe faunës, ndikimi mbiturizmin	Në një zonë natyrore të mbrojtur (rezervuar natyror, park kombëtar etj.)	Po: 0 pikë Jo: 1 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 1.2 Zhvendosja e mbetjeve 1.3 Ndërtimi i një gardhi 2.2 Drenimi dhe grumbullimi i gazit dhe ujërave nga kullimi (<i>leachate</i>) 5.1 Zbatimi i mbulimit final dhembylljes së landfillit
Zjarri në pyje, ndotja e	Në një pyll	Po: 0 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve

florës dhe faunës	(distanca ndërmjet landfillit dhe pyllit duhet të jetë më shumë se 10 m për të shmangur zjarret)	Jo: 1 pikë	1.2 Zhvendosja e mbetjeve 1.3 Ndërtimi i një gardhi 1.4 Prerja e pyjeve dhe shkurreve, sigurimi kundër zjarreve 4.1 Zbatimi i sistemit të evakuimit të gazit 5.1 Zbatimi i mbulimit final dhembylljes së landfillit
--------------------------	--	------------	---

KRITERET E OPERIMIT

Landfilli i mbetjeve do të mbushet shumë shpejt dhe si rrjedhim nuk është e qëndrueshme	Volumi i shfrytëzimit përfaqëson një kapacitet prej më pak se 1 vit operimi ¹	Disponueshmëri a e mbetjeve < 1 vit: 0 pikë Disponueshmëri a e mbetjeve < 2 vjet: 1 pikë Disponueshmëri a e mbetjeve < 5 vjet: 3 pikë Disponueshmëri a e mbetjeve > 5 vjet: 5 pikë	3.1 Ndërtimi i digave për stabilitet të mbetjeve
--	--	---	--

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT DHE E KLASIFIKIMIT

Sa më i lartë rezultati aq më shumë prioritet do t'i jepet këtij landfillit të mbetjeve.

Landfilllet e kategorizuara në kategoritë C dhe D nuk do të lejohen të operojnë.

Klasifikimi final është bërë siç tregohet në shembullin e mëposhtëm.

Klasifikimi	Landfilli i mbetjeve	Rezultati total	Distanca e transportit në landfillin tjetër të qarkut > 2 orë	Landfilli gjendet në bregdet apo në një zonë me prioritet të lartë turistik
1	Landfilli A	18		
2	Landfilli B	11		
3	Landfilli C	10		
4	Landfilli D	8		

KRITERET E PËRJASHTIMIT

Pavarësisht nga rezultati i vlerësimit sipas pikës 1 të kësaj Shtojce dhe metodologjisë së vlerësimit në pikën 2 të kësaj Shtojce, landfilli do të lejohet ose jo të operojë sipas përcaktimit të dy kritereve të përjashtimit:

Distanca ndërmjet landfillit: në një qark, nëse dy landfille mbetjesh gjenden më shumë se 2 orë distancë udhëtimi nga njëra-tjetra, mund të merret në konsideratë lënia hapur e të dyja landfilleve të mbetjeve, për arsye operationale. Nga ana tjetër, nëse landfillet janë afër njëra-tjetrës, duhet të vihet në funksionim vetëm ajo me rezultatin më të lartë të vlerësimit.

Vlera turistike: vendosja e një landfilli mbetjesh në një vend turistik apo në zona të mbrojtjes natyrore sipas legjislacionit në fuqi, është e ndaluar.

Tabela model e vlerësimit të kritereve përjashtuese.

¹ Duke marrë në konsideratë të gjitha punimet e mundshme përmirësuese për të rritur volumin dhe kapacitetin (zgjerimin e sipërfaqes, ngritjen, gjeometrinë etj.).

Klasifikimi	Landfilli i mbetjeve	Rezultati total	Distanca e transportit për në landfillet e tjeratë mbetjeve në qark > 2 orë	Landfilli gjendet në bregtë detit ose në zona me prioritet të lartë turistik
1	Landfilli A	18	A deri në B: 3 orë A deri në C: 0.5 orë A deri në D: 4 orë	Jo
2	Landfilli B	11	B deri në A: 3 orë B deri në C: 2 orë B deri në D: 2.5 orë	Po
3	Landfilli C	10	C deri në A: 0.5 orë C deri në B: 2 orë C deri në D: 3.5 orë	Jo
4	Landfilli D	8	D deri në A: 4 orë D deri në B: 2.5 orë D deri në C: 3.5 orë	Jo

Metodologjia e vlerësimit

Në tabelën model të vlerësimit të kriterëve përjashtuese, landfilli C do të përjashtohet për shkak të afërsisë me një landfill “më të mirë” (landfilli A). Landfilli B do të përjashtohet për shkak të vendndodhjes së saj në një zonë me aktivitet të lartë turistik.

Organi i vetëqeverisjes vendore mund të vendosë për vazhdimin e funksionimit të landfillit A dhe landfillit D, megjithëse kjo e fundit ka vlerësim më të ulët, për shkak të distancës së madhe ndërmjet dy landfillëve D.

KATALOGU I MASAVE

Masat që merren për operimin e landfillit janë:

MASAT E PËRPIKTA
Largimi i mbetjeve
Zhvendosja e mbetjeve
Ndërtimi i një gardhi
Prerje e pyjeve dhe shkurreve, si siguri kundrejt zjarreve
MASAT E MENAXHIMIT TË UJIT
Mbledhja e ujit me kullim periferik
Drenimi dhe grumbullimi i gazit dhe ujërave nga kullimi (leachate)
Menaxhimi i ujërave rrjedhëse
Zbatimi i ruajtjes dhe riqarkullimit të gazit dhe ujërave nga kullimi (leachate)
Zbatimi i përpunimit të gazit dhe ujërave nga kullimi (leachate)
MASAT E STABILIZIMIT DHE E MBROJTJES
Ndërtimi i digave për stabilitetin e mbetjeve
Ndërtimi i pengesave për mbrojtje/stabilizim
MENAXHIMI I GAZIT

Zbatimi i sistemit për evakuimin e gazit
MASAT E MBYLLJES
Zbatimi i mbulimit final dhe mbyllja e landfillit

Metodologjia e zbatimit të masave


Pasi të jenë identifikuar landfillet, të cilat do të mbahen në funksionim, duhet të zbatohen masat teknike në landfill me qëllim që të përmirësohet situata dhe për të kufizuar ndikimin e tyre në mjedis.

Lidhur me vendimin për zgjedhjen e masave që janë të përshtatshme për t'u zbatuar, tabela e vlerësimit tregon masat përkatëse që duhet të zbatohen për çdo kriter. Grupi i punës si rrjedhim mund të hartojë një listë masash për çdo landfill dhe të organizojë punimet. Masat fizike do të zbatohen edhe për landfillet që do të mbyllen (shiko masat për mbylljen).


Të gjitha masat mund të përcaktohen si “praktika të mira”, prandaj asnjë masë nuk duhet të ketë ndikim negativ, nëse aplikohet me korrektësi. Edhe nëse rezultati i vendosur është 0 pikë, mund të merret në konsideratë zbatimi i masave teknike, megjithëse ato nuk mund të përbëjnë kriterin bazë të vlerësimit.

PËRSHKRIMI I MASAVE DHE MËNYRA E ZBATIMIT TË TYRE

LARGIMI I MBETJEVE	Synimet: Largimi i materialit të mbetjeve të cilat mund të krijojnë një ndikim të caktuar (rrezik apo dëm); Evitimi që mbetjet të mos shihen në zonat turistike; Evitimi që mbetjet të mos largohen nga era/uji etj.	Risqet: Ndotja e burimeve natyrore; Ndikim negativ në turizëm; Mbetjet që përhapen jashtë kufijve të landfillit; Risku që lidhet me rrëshqitjet e tokës (kolapsi i mbetjeve).
Përshkrimi	<p>Në rastet kur ka ndikim real në objektivat e ndjeshëm që janë vendosur (p.sh., burimet ujore, popullata etj.) mbetjet duhet të largohen dhe transportohen në një landfill tjetër. Para se mbetjet të largohen duhet të identifikohet më parë landfilli i destinuar dhe të miratohet nga autoritetet lokale. Me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme, kur mbetjet asgjësohen në landfille që nuk janë të rregulluara ose kur landfilli do të ndalohet të përdoret.</p> <p>Largimi i mbetjeve do të ekzekutohet me një ekskavator dhe transportimi me një kamion të mbyllur. Në të gjitha rastet, duhet të shmangët kontakti i stafit me mbetjet (të evitohet prekjja), pasi përmbajtja e tyre është e paditur dhe mund të jenë të pranishme materiale të rrezikshme edhe brenda mbetjeve të ngurta urbane. Pasi hidhen, mbetjet do të ngjeshen dhe më pas do të mbulohen me dhé. Pjerrësia nuk duhet të jetë më e madhe se 3 horizontale për 2 vertikale.</p> <p>Popullsia duhet të informohet për këtë veprim. Ky operacion mund të gjenerojë erë të keqe dhe zjarre.</p> <p>Pas largimit të mbetjeve, toka mbulohet me dhé dhe material i gjermuar nga toka, me qëllim që të pushtohet nga vegjetacioni. Kjo do ta stabilizonte tokën dhe do të ndalonte erozionin. Paralajmërim: ky operacion duhet të ekzekutohet në kushte të sigurta dhe procedura të kontrolluara. Prania e mbetjeve të rrezikshme, stabiliteti i mbetjeve dhe çlirimi i gazeve mund të vërë në rrezik operatorin. Punimet do të planifikohen nga specialistët e sektorit.</p>	

Planet/figurat/ shembujt		Shembull. Ky është rasti kur mbetjet asgjësohen në landfille që prekin apo janë afër një burimi uji të pijshëm (puse publike apo private). Mbetjet duhet të transportohen në një vend më të sigurt. Nëse kjo nuk është e mundur, burimi i ujit për popullatën duhet të zëvendësohet me një burim më të sigurt, mundësisht të lidhur me një rrjet të ujit të pijshëm.
ZHVENDOSJ A E MBETJEVE	Objektivat: Evitimi që mbetjet të shihen në zonat turistike; Evitimi që mbetjet të lëvizin nga era/uji etj.; Zvogëlimi i materialeve të mbetjeve të cilat mund të krijojnë një ndikim të caktuar (rrëshqitjet e tokës, ndikim vizual etj.)	Risqet: Ndikim negativ në turizëm; Mbetjet që përhapen jashtë kufijve të landfillit; Risku që lidhet me rrëshqitjet e tokës.
Përshkrimi	<p>Në rastin e një ndikimi real, mbetjet mund të largohen në një pjesë tjetër të landfillit (masë mbrojtjeje).</p> <p>Largimi do të ekzekutohet me një ekskavator dhe transportimi me një makinë hedhëse ose kamion. Në të gjitha rastet, duhet të shmanget kontakti i stafit me mbetjet (p.sh., prekjën), pasi përmbajtja e tyre është e panjohur dhe materialet e rrezikshme mund të jenë të pranishme dhe brenda mbetjeve të ngurta urbane.</p> <p>Operacioni mund të gjenerojë erë të keqe dhe zjarre.</p> <p>Nëse masa merret për shkak të afërsisë me një lum, mund të merret në konsideratë rihidrimi i shtratit të lumit ose të mbrohet ndërlidhja mes shtratit të lumit dhe mbetjeve (shiko masën “Ndërtimi i pengesave mbrojtëse”).</p> <p>Paralajmërimi: ky operacion duhet të ekzekutohet në kushte të sigurta dhe procedura të kontrolluara. Prania e mbetjeve të rrezikshme, stabiliteti i mbetjeve dhe çlirimi i gazeve mund të vërë në rrezik operatorin. Punimet duhet të planifikohen nga specialistët e sektorit. Zona ku janë larguar mbetjet duhet të shënjohet me qëllim që të shmanget hedhja e mbetjeve të reja në të njëjtin vend.</p>	


Plane/figura/shembuj	Ky është rasti kur mbetjet hidhen në landfille që nuk kanë stabilitet, që janë afër shtretërve të lumenjve ose burimeve ujore në afërsi të tyre (puse private).
----------------------	---

<p>NDËRTIMI I NJËGARDHI</p>	<p>Objektivat: Krijimi i një pengese ndërmjet popullatës/kafshëve dhe mbetjeve; Shmangja që mbetjet të largohen nga era/uji etj.; Kufizimi i kufijve të landfillit.</p>	<p>Risqet: Rrezik për shëndetin e popullsisë dhe kafshëve; Mbetje që përhapen jashtë kufijve të vend-depozitimit.</p>
<p>Përshkrimi</p>	<p>I gjithë perimetri i landfillit duhet të rrethohet me gardh për të shmangur hyrjen e paligjshme në landfill.</p> <p>Mund të merrni në konsideratë ndërtimin e një gardhi me tela hekuri (me një lartësi prej 2–3 m) me shtylla betoni dhe një portë për të lejuar dhe kontrolluar hyrjen e kamionëve dhe njerëzve.</p> <p>Kamionët që transportojnë mbajtjet duhet të kenë hapësirën e duhur për të lëvizur brenda landfillit, brenda gardhit të vendosur, në mënyrë që nëse derdhin mbetje gjatë lëvizjes, ato të mund të mbeten brenda kufijve të landfillit.</p> <p>Në rast se në atë vend ka erëra të forta, gardhi nga ana e drejtimit të erës duhet të jetë më i lartë për të shmangur përhapjen e mbetjeve jashtë landfillit (kjo duhet të merret në konsideratë në mënyrë të veçantë kur landfilli është afër shtëpive apo zonave turistike). Për këtë qëllim, kjo pjesë e gardhit mund të projektohet si një sistem i lëvizshëm qëllim që të lëvizet sipas ngritjes që do të pësojë vendhedhja.</p>	
<p>Plane/figura</p> <p>→ gardhi, rrugahyrjes</p>		
<p>PRERJA E PYJEVEDHE SHKURREVE</p>	<p>Objektivat: Heqja e materialeve të djegshme që ndodhen mes landfillit dhe pyllit më të afërt; Të lejohet lëvizja e duhur brenda landfillit.</p>	<p>Risqet: Zjarret në pyje s rrjedhi i zjarri në landfill. i m t</p>
<p>Përshkrimi</p>	<p>Rreziku i zjarrit në landfill është shumë i lartë. Origjina e zjarrit mund të jetë natyrale apo nga aktivitetet njerëzore. Në çdo rast duhet të shmangni përhapjen e këtyre zjarreve në pyjet më të afërta. Prania e pemëve në landfill përbën material të djegshëm që paraqet një rrezik serioz në rast se mbetjet marrin zjarr.</p> <p>Për të zvogëluar rrezikun e përhapjes së zjarrit që mund të marrin mbetjet deri te pylli më i afërt atëherë brenda landfillit apo rrotull kufijve të saj nuk duhet të ketë pemë, shkurre apo rrënjë. Nevojitet të mbahet një distancë minimale prej 10 m ndërmjet landfillit dhe pyllit më të afërt dhe duhet të mos ketë pemë dhe materiale të djegshme.</p> <p>Kjo masë duhet të përsëritet një herë në vit, preferohet në fillim të sezonit veror. Një piring me dhë duhet të përgatitet afër landfillit që do të shërbejë</p>	

	për shuarjen e zjarrit, me qëllim që të mbulohen mbetjet në rastet kur marrin zjarr.
--	--

MBLEDHJA E UJËRAVE SIPËRFAQËSO REDHE KULLIMI PERIFERIK	Objektivat: Minimizimi i prodhimit të ujit të ndotur; Minimizimi i ujit të shiut që hyn te mbetjet; Devijimi i ujit të shiut dhe ujërave rrjedhëse.	Risqe: Ndotja e ujit; Kolapsi / destabilizimi i mbetjeve; Përmbytja e landfillit.
Përshkrimi	Kullimi periferik vendoset në kufirin e landfillit, për të ndalur ujin që vjen nga zona fqinje dhe ujërat që rrjedhin nga landfillit (uji i shiut që nuk infiltrohet te mbetjet). Meqenëse ky ujë nuk infiltrohet te mbetjet ai konsiderohet si jo i ndotur dhe mund të orientohet drejt lumit më të afërt. Reduktimi i ujit që hyn te mbetjet dhe prodhimi i ujit nga mbetjet është një objektiv i rëndësishëm afatgjatë. Sipërfaqja e mbetjeve duhet të jetë e pjerrët, për të nxitur rrjedhën e ujit të shiut dhe për të shmangur krijimin e pellgjeve të përkohshme të cilat mund të destabilizojnë mbetjet dhe të	

	<p>pengojnë funksionimin e duhur të përditshëm të makinerive. Për të ulur volumin e ujit në landfillin, sipërfaqja e punës e mbetjeve të pambuluara duhet të jetë minimale. Struktura e landfillit A duhet të ndalohet dhe struktura B duhet të zbatohet.</p> <p>Reshjet e shumta të Shqipërisë detyrojnë landfillet që të jenë të pajisura me një sistem për mbledhjen e ujit nga sipërfaqja e landfillit, për të shmangur erozionin e mbetjeve. Sipërfaqja e mbetjeve duhet të organizohet në “hapa”, për çdo 5 m ngritje, për të qenë të aftë të instalohen kanale kulluese sipërfaqësore në çdo nivel.</p> <p>Kjo bëhet duke modeluar sipërfaqen e landfillit.</p> <p>Ky drenim sipërfaqësor mund të ndërtohet me gjysmëtuba ose me zgjidhje të ngjashme me këtë (beton). Kanalet kulluese drejtojnë ujërat sipërfaqësore drejt një “ujëvare”, e cila garanton lidhjen e kanaleve kulluese sipërfaqësore me kanalet kulluese periferike (shiko masën 2.3), duke shpërndarë energjinë ujore dhe duke parandaluar erozionin.</p> <p>Përmasat e kanaleve kulluese periferike duhet të përshtaten në varësi të të dhënave për reshjet dhe gjeometrinë lokale. Kanalet kulluese periferike janë të ngjashme me sistemin anësor kullues të rrugëve. Megjithatë ai mund të ndërtohet në mënyra të ndryshme, sipas strukturës së dheut në zonë: gjermime në tokë të mbuluar me gurë, elemente çimentoje të parafabrikuar, gjysmëtubash plastikë etj. Faktori i rëndësishëm që duhet marrë në</p>
--	--

	<p>konsideratë është kontrolli i stabilitetit dhe erozionit të sistemit gjatë shirave të rrëmbyeshme dhe mundësia për të pastruar dhe mirëmbajtur kanalet kulluese (d.m.th., shmangni tubat e mbyllur pasi mund të ketë dhe bllokime). Një pjerrësi prej 0.5% konsiderohet e mjaftueshme. Dalja e kanaleve kulluese periferike drejt lumit ka nevojë të forcohet për të shpërndarë energji, shmangur erozionin dhe kolapsin e strukturës (shiko masën “menaxhimi i ujërave rrjedhëse”).</p> <p>Vini re: Infiltrimi i ujit te mbetjet dhe grumbullimi i tij në fund të landfillit gjeneron gaz dhe ujëra nga kullimi (leachate) dhe mund të destabilizojë masën dhe të përbëjë një risk të madh për operatorët dhe mjedisin. Duke kapur ujërat rrjedhëse sipërfaqësore para se të infiltrohen te mbetjet, sasia e ujit të ndotur (gazit dhe ujërave nga kullimi: leachate) ulet, si risk destabilizimi.</p>
Plane/figura/shembuj	 <p>Figura 1. Lidhja e prodhimit të gazit dhe ujit nga kullimi (<i>leachate</i>) me sipërfaqen e landfillit, strukturën dhe elementet e sistemit të kullimit.</p>

<p>DRENIMI DHE GRUMBULLI MI IGAZIT DHE UJËRAVE NGA KULLIMI (<i>LEACHATE</i>)</p>	<p>Objektivat: Minimizimi i ujit që kalon nëpër mbetje; Shmangia e ujit që grumbullohet brenda landfillit me qëllim që të reduktojë riskun e rrëshqitjes nga toka.</p>	<p>Risqet: Ndotja e ujit; Kolapsi/destabilizimi i mbetjeve, rrëshqitjet e tokës.</p>
--	--	--

<p>Përshkrimi</p>	<p>Uji që kalon përmes masës së mbetjeve ekziston si ujë i ndotur (gaz dhe ujërat nga kullimi: <i>leachate</i>), i cili duhet të mbliidhet dhe përpunohet. Nëse nuk bëhet kështu, përveç ndotjes, grumbullimi i ujit në fund të landfillit mund të destabilizojë masën e mbetjeve dhe përbën një risk të madh për operatorët dhe mjedisin.</p> <p>Në landfillin ekzistuese kullimi i gazit dhe i ujërave që dalin nga kullimi (<i>leachate</i>) mund të bëhet duke sheshuar dhe ngjeshur sipërfaqen e punës (duke krijuar një pjerrësi prej 5–6%) dhe duke instaluar një shtresë për kullimin, mbi të cilën do të hidhen mbetjet në të ardhmen. Në këtë mënyrë, uji rrjedh përmes mbetjeve deri sa të arrijë shtresën e kullimit e cila devijon ujin drejt pikës më të ulët.</p> <p>Kullimi përbëhet nga dy lloje elementesh:</p> <p>Linjat e brendshme të kullimit janë linja materiali të ndara me 10 deri në 15 metra (në varësi të reshjeve vjetore). Volumi i linjës së kullimit është 1 m³ e materialit për metër linear. Materiali i përdorur për ndërtimin e “linjave të drenimit” brenda kufijve të landfillit përbëhet nga zhavorr apo gurë ose mbetje materiale të ndërtimit të përzgjedhura më mirë (tulla, gurë, beton i thyer etj.). Diametri i elementeve duhet të jetë ndërmjet 3 mm dhe 15 mm;</p>
	<p>Tubi i kanalit kullues të jashtëm (diametri i brendshëm afërsisht 15 cm) në kufijtë e landfillit, i cili mbledh gazin dhe ujin nga kullimet (<i>leachate</i>) e bëra nga linjat e zhavorrit. Dalja (pika më e ulët) e kullimit periferik lidhet me sistemin e ulluqeve ose me një sistem për përpunimin e ujit (shiko masën 2.4 dhe 2.5).</p> <p>E rëndësishme:</p> <p>Nuk duhet të përdoren materiale me një diametër prej më pak se 3 mm për material drenimi dhe fletët plastike apo të letrës duhet të largohen. Këta dy faktorë mund të shkaktojnë bllokimin e sistemit dhe mos realizimin e drenimit. Për ta zbatuar atë: kullojini materialet me një “rrjetë metalike” (që përdoret për gardhet e pulave);</p> <p>Ndërmjet linjave të materialeve të drenimit, mund të hidhen mbetjet deri sa të mbushet e gjithë shtresa. Operatorët duhet t’i kushtojnë vëmendje që të mos shkatërrohen linjat e drenimit gjatë hedhjes së mbetjeve;</p> <p>Numri i saktë i kanaleve kulluese që nevojiten do të llogaritet sipas të dhënave për reshjet lokale;</p> <p>Shtresa e kullimit duhet të vendoset mbi një sipërfaqe me mbetje të ngjeshura. Sa herë që keni mundësi, bëni ngjeshjen duke përdorur automjete apo makineri të rënda para se ta instaloni atë. Kjo vlen edhe për shtresën më të ulët të landfillëve të reja që do të rregullohen si landfillë të rregulluara.</p>

Plane/figura/
shembuj



Ose

→ Dalja e gazit dhe e ujërave nga kullimi edhe pa sistem drenazhi




Figura 2. Në foton sipër: forma e linjës së drenimit të gazit dhe e ujit nga kullimi, e ndërtuar mbi sipërfaqen e ngjedhur apo në të. Majtas: me të zeza tregohet drenimi periferik; me të kuqe janë linjat e drenimit të gazit dhe të ujit nga kullimi. Këto linja janë poshtë sipërfaqes së mbetjeve dhe mbledhin lëngjet që rrjedhin përmes mbetjeve për t'i drejtuar ato drejt përpunimit adekuat

Figura 3. Për të drenuar landfillin, sipërfaqjaku do të vendosen mbetjet duhet të ketë një pjerrësi minimalisht prej 5% në drejtim të pikës së daljes. Këshillohet një pjerrësi prej 10%, kur mbetjet janë të trasha dhe pritet të bëhet dhe ngjedhja e mbetjeve. Sipërfaqja duhet të jetë e ngjeshur, duke krijuar një shtresë kundër ujit” (që paraqitet në vizatim mengjyrën e kuqe të errët) për të kufizuar në maksimum infiltrimin e gazit dhe ujërave nga kullimi (*leachate*) në nëntokë (shigjetat e vogla ngjyrë rozë). Shtresa ngjyrë portokalli tregon ku janë vendosur linjat e drenimit për të kapur gazin dhe ujërat ngakullimi (*leachate*) dhe për t'i drejtuar drejt tubit të jashtëm të drenimit.

--	--	--






Figura 4. Uji që rrjedh përmes mbetjeve duhet të konsiderohet si gazi dhe ujërat që dalin nga kullimi (leachate). Këto gjenerohen edhe në mungesë të sistemit të drenazhit.

<p>MENAXHI MI I UJËRAVE RRJEDHËS E</p>	<p>Objektivat: Minimizimi i ndikimit të erozionit nga uji i shiut; Shmangni që uji të hyjë dhe të grumbullohet brenda landfillit.</p>	<p>Risqet: Kolapsi/destabilizimi i mbetjeve.</p>
<p>Përshkrimi</p>	<p>Reshjet e shumta të Shqipërisë detyrojnë landfillet që të kenë një sistem për mbledhjen e ujit të shiut nga sipërfaqja e landfillit për të shmangur erozionin e mbetjeve. Kjo realizohet duke modeluar sipërfaqen e mbetjeve për të arritur të “hapat” ku mund të arrihet në ndërtimin e drenimit të sipërfaqes (shiko masën 2.1).</p> <p>Lidhja mes drenimit të sipërfaqes dhe drenimit periferik është një “ujëvarë” që ka dy funksione: të kanalizojë ujin dhe të shpërndajë energjinë e tij.</p> <p>Lidhja mes kanaleve kulluese të sipërfaqes së vendosur në nivele të ndryshme të landfillit mund të realizohet me kanalet e elementeve të mbivendosura prej betoni, të vendosura në sipërfaqen e mbetjeve dhe duke arritur në drenimin e jashtëm menjë strukturë të përforcuar (p.sh. gurë të thyer apo bazën betoni).</p> <p>Më pas, uji i mbledhur drejtohet drejt daljes, që duhet të jetë një lum apo liqen. Duhet të ndërtohet një strukturë me gurë të thyer që të mbrojnë pikën e daljes nga erozioni (p.sh., basen i qëndrueshëm i mbushur me zhavorr të trashë).</p>	

Plane/figura





<p>ZBATIMI I RUAJTJES DHE I RIQARKULLIMI T TËGAZIT DHE TË UJITQË DEL NGA KULLMI (LEACHATE)</p>	<p>Objektivat: Të kufizohet çlirimi i gazit dheujërave nga kullimi.</p>	<p>Risqet që lidhen me këtë: Ndotja e ujërave sipërfaqësore; Ndotja e ujërave nëntokësore.</p>
	<p>Gazi dhe ujërat që dalin nga kullimi janë lëngjet mbetje që vijnë nga filtrimi i ujit përmes një materiali, një fraksion i të cilit mund të jetë i tretshëm, në këtë rast mbetjet. Ndotja që pritet nga një landfill mbetjesh lokale, e caktuar nga bashkia, është kryesisht organike. Për një landfill konsiderohet që 60% e ujit të shiut kalon nëpër mbetjet dhe bëhet leachate: gaz dhe ujë që del nga kullimi. Për një landfill të mbuluar me materiale inerte, rrjedhja është më e lartë dhe si rezultat gazi dhe uji që del nga kullimi (leachate) do të jetë rreth 40% e ujit të shiut. Për një landfill të rregulluar me pjerrësi minimalisht prej 5-10%, drenimi sipërfaqësor dhe i mbuluar me materiale inerte, gazi dhe ujërat nga kullimi (leachate) mund të llogariten deri në 20% të reshjeve vjetore. Reshjet e dendura rrisin sasinë e (leachate) gazit dhe të ujit nga kullimi. Në varësi të përbërjes së mbetjeve në landfillin e mbetjeve dhe të sasisë së shiut, karakteristikat e (leachate) gazit dhe të ujit nga kullimi do të jenë të ndryshme. Gazi dhe uji nga kullimi (leachates) duhet të mbledhen dhe përpunohen. Për të ulur volumin që do të përpunohet, zbatohet riqarkullimi i (leachates) gazit dhe i ujit nga kullimi, nëpër masën e mbetjeve.</p> <p>Për të realizuar këtë, duhet të ndërtohet një rezervuar për të mbledhur (leachates) gazin dhe ujin nga kullimi, në dalje të sistemit të jashtëm të drenimit (shiko masën “Drenimi dhe mbledhja e (leachate) gazit dhe e ujit nga kullimi”). Një pompë me motor e lidhur me një tub fleksibël përdoret për të rishpërndarë (leachate) gazin dhe ujin nga kullimi, nëpër landfille.</p> <p>Riqarkullimi i (leachate) gazit dhe i ujit nga kullimi është një mënyrë shumë pak e kushtueshme për të përpunuar (leachate) gazin dhe ujin nga kullimi dhe për të mbrojtur mjedisin.</p> <p>Është e rëndësishme që të rifutet (leachate) gazi dhe uji që del nga kullimi, me shkarkim të ulët dhe duhet të mos tejkalojë kapacitetin e infiltrimit që ka landfilli i mbetjeve, përndryshe lëngjet do të rrjedhin në sistemin e drenimit të ujit dhe do të drejtohet në mjedis pa u përpunuar. Rishpërndarja e shpeshtë e sasive të vogla të (leachate) gazit dhe ujit nga kullimi, preferohet më shumë se sa rishpërndarja e rrallë e sasive më të mëdha.</p> <p>Riqarkullimi i (leachate) gazit dhe i ujit që del nga kullimi është veçanërisht efikas në sezonet e nxehta ose të thata dhe më pak në dimër dhe në kohë me shi. Riqarkullimi kontribuon fort në reduktimin e komponentit organik të (leachate) gazit dhe të ujit që del nga kullimi dhe vendhedhja funksionon si një tretës organik. Avullimi dhe prodhimi i</p>	

	<p>gazit kontribuon në reduktimin e sasisë së filtruar.</p> <p>Riqarkullimi i (leachate) gazit dhe i ujit që del nga kullimi rrit prodhimin e gazit dhe mund të gjenerojë më shumë erë të keqe. Për këtë arsye, riqarkullimi i (leachate) gazit dhe i ujit që del nga kullimi) zakonisht kombinohet me sistemin e kapjes dhe të djegies së gazit.</p>
--	---

<p>ZBATIMI I PËRPUNIMIT TË (LEACHATE) GAZIT DHE UJIT NGA KULLIMI</p>	<p>Objektivat: Përpunimi i çlirimeve të (leachate) gazit dhe të ujit nga kullimi.</p>	<p>Risqet që lidhen me të: Ndotja e ujit sipërfaqësor; Ndotja e ujërave nëntokësore.</p>
<p>Përshkrimi</p>	<p>Leachate (gazi dhe uji nga kullimi) është lëngu mbetje që vjen nga filtrimi i ujit nëpërmjet një materiali një fraksion i të cilit mund të jetë i tretshëm, në këtë rast mbetjet. Niveli i ndotjes nga leachate (gazit dhe ujit nga kullimi) varet nga poroziteti i materialit dhe nga përbërja e tij. Leachate (gazi dhe uji nga kullimi) mund të ndotë tokën, ujërat nëntokësore dhe ujërat sipërfaqësore. Reshjet rrisin sasinë e (leachate) gazit dhe e ujit nga kullimi. Për një landfill mund të thuhet që 60% e reshjeve kalon mes mbetjeve dhe bëhet leachate (gaz dhe ujë që del nga kullimi).</p> <p>Për një landfill të mbuluar me materiale inerte, rrjedhja e ujit është më e madhe dhe si rezultat leachate (gazi dhe uji nga kullimi) do të jetë rreth 40% të reshjeve. Për një landfill të rregullt me pjerrësi minimalisht prej 5–10%, drenimi sipërfaqësor dhe i mbuluar me materiale inerte, leachate (gazi dhe uji nga kullimi) mund të llogaritet deri në 20% të reshjeve vjetore.</p>	


	<p>Në varësi të përbërjes së mbetjeve në landfillin e mbetjeve dhe sasisë së shiut, ndryshojnë dhe karakteristikat e (leachate) gazi dhe e uji nga kullimi. Leachate (gazi dhe uji nga kullimi) që nuk mund të riqarkullohen duhet të grumbullohen dhe përpunohen.</p> <p>Lidhja me rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura: Kur është e mundur, mënyra më e thjeshtë për të përpunuar (leachate) gazin dhe ujin nga kullimi, e landfillit është duke i lidhur ato me sistemin e kanalizimeve urbane të ujërave të ndotura.</p> <p>Përpunimi i avullimit leachate (gazi dhe uji nga kullimi) largohen në një pellg për grumbullimin e tyre. Zgjidhja më e thjeshtë është përdorimi i një pellgu avullimi për të avulluar leachate (gazin dhe ujin nga kullimi) falë diellit dhe erës. Kjo lloj teknike është efikase kur ka reshje të ulta dhe avullim të lartë, dhe është shumë e përshtatshme në klima të thata. Leachate (gazi dhe uji nga kullimi) mund të avullojnë gjithashtu edhe nga vendhedhja nëse zbatohet riqarkullimi i (leachate) gazit dhe i ujit nga kullimi (shiko “zbatimi i masës së riqarkullimit të (leachate) gazit dhe të ujit nga kullimi”).</p> <p>Filtri anaerobik dhe aerobik: Direkt nga landfilli ose pas riqarkullimit apo pellgut të avullimit apo një rezervuari, kanalet kulluese mund të lidhen me një filtër fizik bazë anaerobik, me këto dimensione: një ose më shumë basene me një gjatësi 10 m, gjerësi 3 m, thellësi 1 m, mbushur me zhavorr, me një gradient granulometrie, siç jepet në figurën e mëposhtme. Koha e qëndrimit duhet të jetë minimalisht 9 orë për të siguruar përpunimin e 80% të ndotjes organike dhe nga 1 deri në 2 ditë për të arritur në 90%. Rekomandohet që filtri anaerobik të plotësohet me një filtër aerobik, ku uji rrjedh poshtë, nëpër zhavorrin e ajrosur (32/50 mm dhe më të madh), me një gradient lartësie për të oksigjenuar lëngjet, para se ato të çlirohen në lumë apo liqen. Filtrat aerobikë janë të pastruara gjatë gjithë kohës.</p> <p>Basenet e filtrit mund të ndërtohen me çdo material kundër ujit (beton, veshje plastike etj.). Materiali filtër duhet të jetë i qëndrueshëm brenda filtrit dhe nuk duhet ta marrë rrjedha e leachate (gazi dhe uji nga kullimi). Nuk ka nevojë për një pengesë fizike ndërmjet materialeve me diametër të ndryshëm. Në rast se materiali mobilizohet, është i mjaftueshëm përdorimi i një rrjete për të ndarë materialin por duke lënë ujin të rrjedhë.</p>
--	--


<p>NDËRTIMI I DIGAVE PËR STABILITETIN E MBETJEVE</p>	<p>Objektivat: Stabilizimi i mbetjeve; Përbëjnë një barrierë rreth mbetjeve. Lejon të fshehtë operimin e landfillit të mbetjeve, duke reduktuar ndikimin në peizazh; Lejon operimin e landfillit në shtresa (kursen hapësirën).</p>	<p>Risqet që lidhen me to: Shpërndarja e mbetjeve; Përdorimi i tokës.</p>
<p>Përshkrimi</p>	<p>Digat janë objekte mbështetëse me përmasa fikse, të cilat ndërtohen rreth vendit kudo të hidhen mbetjet. Digat përdoren për të kufizuar kufijtë e landfillit, për të stabilizuar mbetjet brenda tij dhe për të lejuar mbushjen e landfillit me shtresa. Në një zonë të sheshtë, çdo shtresë është më e vogël se shtresa më poshtë, kështu që në fund landfilli do të ketë formën e një “mali”.</p> <p>Diga ka një pjerrësi maksimalisht prej 2:3 dhe me një lartësi maksimale prej 2.5 m, për të garantuar stabilitetin. Është e rëndësishme të vëmë në dukje që stabiliteti mund të ndryshojë në varësi të llojit të materialit, por pirgjet nuk duhet të jenë asnjëherë më të pjerrëta sesa 2:3.</p> <p>Materialet që përdoren për ndërtimin e digave mund të jenë material ndërtimi (tulla, gurë, beton i thyer etj.) ose edhe mbetje të zgjedhura. Pas ndërtimit të digës, duhet të përdoret një shtresë dheu prej të paktën 0.2 m trashësi për të mbuluar pjesën e jashtme të digave, për të shmangur erozionin, për të lehtësuar vegjetimin dhe për të integruar këtë strukturë në peizazhin rrethues.</p> <p>Nuk është e nevojshme të ndërtohet një digë nëse aty ka mure (ose relieve natyrore). Kur arrihet deri te niveli i murit/relievit natyror atëherë sipër saj vendoset një digë.</p>	

<p>Plane/figura</p>	 <p>Figura 5. Digat (me ngjyrë jeshile) vendosen për të kufizuar dhe stabilizuar mbetjet që do të hidhen. Vija e zezë përfaqëson formën e mëparshme të landfillit, para modelimit të saj me diga.</p>	
<p>NDËRTIMI I PENGESAVE PËR MBROJTJE/STABILIZIM</p>	<p>Objektivat: Të vendosen kufijtë dhe limiti i zonës së landfillit; Të stabilizojë mbetjet nga faktorët e jashtëm (p.sh., lumi); Të shmangë që landfilli të jetë i dukshëm.</p>	<p>Risqet e lidhura me të Stabiliteti i mbetjeve dhe risku në lidhje me objekte sensitive; Lëvizja e mbetjeve për shkak të periudhave meshumë ujë.</p>
<p>Përshkrimi</p>	<p>Pengesat ndërtohen që të mbahen mbetjet ose për të mbrojtur mbetjet nga agjentë të jashtëm si përmbytjet, por edhe për të mbrojtur objektet sensitive të vendosura në rrjedhën e poshtme, si për shembull: shtëpi, lumenj apo ndërtesa të tjera. Në varësi të riskut të gjendjes specifike, mund të merren në konsideratë veprime të ndryshme:</p> <p>Para se të ndërtohet një pengesë, përgjet e mbetjeve duhet të përshtaten ose në rastet kur mbetjet janë duke shkaktuar rreziqe (si për shembull, mbetjet në shtretërit e lumenjve), ato duhet të largohen. Stabilizimi i përgjeteve mund të zbatohet edhe si masë parandaluese.</p> <p>Nëse do të ndërtohet një pengesë mbrojtëse, ajo duhet të jetë një strukturë e rëndë dhe e qëndrueshme. Përdorimi i togjeve me gurë të mbushur me gurë të rëndë siguron stabilitetin dhe përshkueshmërinë që kërkohet.</p> <p>Në rastin kur nevojitet mbrojtja nga përmbytjet, mund të vendoset zhavorr i trashë në fund të togjeve me gurë për të ulur erozionin dhe si rezultat dhe destabilizimin e gabionëve (togjeve me gurë).</p>	
<p>Plane/figura</p> <p>→ Përshtatja/rregullimi i përgjeteve</p> <p>→ Pjerrësia maksimale</p>	 <p>Figura 6. Rrezik për shtëpitë: stabilizimi i mbetjeve me një rregullim të përgjeteve. Rasti</p>	

(A) paraqet një risk të madh kolapsi. Edhe nëse nuk vihet në funksionim, sipërfaqja e landfillit do të modelohet deri në një pjerrësi maksimale prej 2:3.

→ Për t'u larguar




	<p>Figura 7. Mbetjet e vjetra të depozituara dhe materiali që ka marrë pjerrësinë e stabilitetit. Vazhdimi i funksionimit mund të realizohet mbi strukturën e vjetër, pasimbetjet poshtë janë ngjeshur tashmë. Një drenim periferik duhet të instalohet në fund të pirgut për të larguar ujin e shiut dhe për të parandaluar destabilizimin e mbetjeve.</p>  <p>Figura 8. Nëse ka mbetje në shtratin e lumit, ato duhet të largohen dhe duhet vendosur pengesa e mbrojtjes mbi nivelin e ujit për të rritur stabilitetin e strukturës; materiali prej zhavorr të trashë mund të depozitohet në bazën e pengesës, nga ana e lumit. Kjo do të mbrojtë pengesën në rast përmytjesh. Një sistem kullimi për leachate (gazin dhe ujërat nga kullimit) do të vendoset në pjesën e brendshme të pengesës për të shmangur grumbullimin e (leachate) gazit dhe të ujit nga kullimi dhe destabilizimin e murit.</p>
--	---


<p>ZBATIMI I SISTEMIT TË LARGIMIT TËGAZIT</p>	<p>Objektivat: Reduktimi i çlirimeve të gazi dhe erës së keqe nga landfilli i mbetjeve; Reduktimi i ndikimit në cilësinë e ajrit dhe efektin e gazeve të serrave në klimën globale; Shmangia e risqeve për rënie zjarresh; Rikuperimi i energjisë.</p>	<p>Risqet që lidhen me të: Shpërthime gazi/marrja flakë; Erë e keqe e fortë.</p>
<p>Përshkrimi</p>	<p>Ndërsa mbetjet dekompozohen, gjenerohet gaz. Gazi do të fillojë të çlirohet brenda pak javësh që nga fillimi i depozitimit të mbetjeve dhe mund të gjenerohet për dekada të tëra edhe pas mbylljes së landfillit të mbetjeve. Mbetjet në landfill prodhojnë gaz me anë të dekompozimit biologjik në kushte anaerobike (pa oksigjen). Gazet përmbajnë një sasi të madhe metani (CH₄), që është dhe shkaku i rënies së zjarreve apo të shpërthimeve nëse grumbullohet në xhepat e gazit. Akumulimi i gazit mund të shkaktojë dhe asfiksi.</p> <p>Sistemi i evakuimit të gazit duhet të planifikohet si një seri oxhakësh të vendosur afërsisht çdo 20 metra, të ndërtuar me tuba metalikë të mbushur me gurë apo materiale inerte (përshkueshmëri e lartë).</p> <p>Struktura metalike me doreza instalohet paraprakisht te depozitimi i mbetjeve dhe mbushet me material të trashë.</p> <p>Kur niveli i mbetjeve arrin pjesën lart të tubit metalik, përdorni një makinë për të tërhequr lart tubin metalik, siç tregohet në figurë dhe mbushet sërish me gurë. Në rast se nuk ka makinë për këtë qëllim, kjo mund të realizohet dhe me dorë edhe pse kërkon fuqi.</p> <p>Materialet inerte do të mbeten në shtresën e mbetjeve, duke krijuar një mënyrë preferenciale të qarkullimit të gazit. Tubi i ngritur duhet të mbushet me material të trashë, para se të hidhen mbetjet rreth e rrotull saj.</p>	

Oxhaku duhet të ketë një “gyp të fiksuar mbrapsht” për ta përqendruar gazin në një pikë ku do të ndizet për të djegur gazin e prodhuar nga mbetjet e asgjësuar. Ky gyp hiqet kur oxhaku tërhiqet lart.

Plane/figura



oxhakun e gazit. Një gyp vendoset mbrapsht në krye të oxhaqeve për të përqendruar çlirimin e gazeve dhe për ta ndezur (djegur atë). Çlirimi i gazit nga një landfill në një tjetër ndryshon. Djegia e gazit duhet të bëhet nën mbikëqyrje të rreptë dhe stafi duhet të jetë i informuar dhe i trajnuar për këtë praktikë specifike.



ZBATIMI I MBULIMIT FINAL DHE I MBYLLJES SË LANDFILLIT

Objektivat:
 Siguria afër një landfilli të mbetjeve që nuk përdoret më;
 Moslejimi i përdoruesve të hyjnë në landfillin e mbetjeve dhe për të pasur kontakt me mbetjet;

Risqet e lidhura me të:
 Përdorim i vazhdueshëm i landfillit;
 Kontakti i njerëzve dhe i kafshëve me ndotjen e mundshme;
 Krijimi i barrierave shtesë për mbrojtje dhe integrimi i landfillit në

	Rikthimi i florës lokale/vegjetimit/peizazhit natyror.	peizazh.
Përshkrimi	<p>Mbulimi final garanton mbylljen e sigurt të operimit pasi krijon një barrierë mes mbetjeve dhe popullsisë ose faunës. Përveç kësaj, ai favorizon integrimin në peizazh, duke rikrijuar një mbulesë vegjetacioni dhe kufizon sasinë e ujit që hyn në landfillin e mbetjeve dhe prodhon leachate (gaz dhe ujë nga kullimi).</p> <p>Landfilli i mbyllur nevojitet të mbulohet plotësisht me 80 centimetra material drenimi dhe 30 centimetra dhé:</p> <p>Materiali i drenimit konsiston në zhavorr ose gurë ose materiale të përzgjedhura ndërtimi (tulla, gurë, beton i thyer etj.). Diametri duhet të jetë ndërmjet 3 mm dhe 15 mm.</p> <p>Qëllimi i vendosjes së dheut është stabilizimi i materialit të drenimit dhe për të mundësuar zhvillimin e vegjetacionit në sipërfaqen e landfillit të mbetjeve.</p> <p>Është e rëndësishme të mirëmbahen përgjetet e landfillit edhe pas mbylljes së landfillit të mbetjeve, për të shmangur akumulimin e ujit të mbetjet dhe riskun që vjen nga kjo, atë të destabilizimit dhe të ndotjes së ujit. Gjithashtu, është e rëndësishme të zbatohen mënyrat për rrjedhjet e ujit me qëllim që të kontrollohet erozioni nga uji.</p> <p>Nëse ka oxhaqe gazi, ato duhet të mbahen me qëllim që të garantojnë evakuimin e gazit edhe pas mbylljes, dhe për të shmangur akumulimin e gazit në landfillin e mbetjeve. Nëse ato nuk janë prezent këshillohet që të krijohen, me qëllim që të shmangët akumulimi i gazit dhe si rezultat gjenerimi i riskut.</p>	

Plane/figura




Figura 11. E gjithë sipërfaqja e landfillit të mbetjeve duhet të mbulohet. Duhet të instalohen oxhaqe gazesh në pikat më të larta për të shmangur akumulimin e gazit nën shtresën finale të mbulimit. Instalohet një gyp metalik mbrapsht pasi mbyllet landfilli i mbetjeve me qëllim që të përqendrohen gazrat që çlirohen dhe të mundësohet kontrolli i ndezjes së tyre (djegies). Ky veprim duhet të zbatohet duke marrënë konsideratë të gjitha masat e sigurisë dhe të ruajtjes.

KUSHTET MINIMALE OPERACIONALE

Operimi i përgjithshëm

Kur zbatohen masat fizike, operimi i landfillit mund të organizohet sipas standardeve të mëposhtme minimale të operimit me qëllim që të garantohet jetëgjatësia e masave fizike që janë ndërmarrë dhe për të përmirësuar ruajtjen dhe sigurinë e operimit:

- Prania dhe respektimi i një plani asgjësimi: mbetjet asgjësohen sipas një plani, i cili tregon landfillin e asgjësimit, nevojën e ndarjes (d.m.th., materiale ndërtimi apo inerte që më vonë përdoren për mbulim) dhe trashësinë dhe gjerësinë e shtresës. Qëllimi i planit të asgjësimit është të minimizojë ndikimin ndërkohë që optimizon përpjekjet e operimit.
- Qarkullimi i kamionit duhet të jetë i organizuar dhe i sinjalizuar (nëpërmjet koneve plastike apo mjete të tjera të ngjashme), me qëllim që të kontribuojnë në ngjeshjen e mbetjeve.
- Mbetjet asgjësohen direkt në vend nga kamionët, në fasha prej 3 m deri në 5 m të gjera, 2 deri në 3 m në thellësi.
- Mbulimi i mbetjeve të depozituara së fundmi çdo ditë ose javë, me 0.15 m dhé ose inerte të tjera ose materiale ndërtimi.
- Hendeqet dhe kanalet e kullimit duhet të mbahen të pastra për të shmangur bllokimin e tyre në kohë me shi.
- Hyrja në landfillin e mbetjeve, si dhe porta dhe gardhet, duhet të mirëmbahen për të bërë të mundur që klientët të depozitojnë mbetjet shpejt dhe me rregull dhe të ndalohet prania e kafshëve dhe njerëzve jo të autorizuar.
- Regjistrimi i dorëzimit të mbetjeve dhe pagesat e tarifave hyrëse, nëse ka.

Plani i asgjësimit

Mbetjet duhet të hidhen në një mënyrë të organizuar, që realizohet nga operatori përgjegjës, në shtresa prej 2 deri në 3 m të trasha.

Për të minimizuar ujin e shiut që infiltrohet te mbetjet, zona e operimit duhet të jetë minimale. Për këtë arsye, rendi i veprimeve me mbetjet hyrëse duhet të planifikohet dhe landfilli duhet të ndahet në qeliza.

Qelizat mbushen me mbetje, njëra pas tjetrës. Një qelizë i korrespondon sasisë së mbetjeve që hidhet çdo ditë.

Mbuloni qelizën me materiale inerte çdo ditë pune.

Filloni me qelizat në pikat më të largëta për të siguruar një qarkullim më të thjeshtë me automjetin tuaj.

Mbulimi që kryhet çdo ditë

Sipërfaqja e hapur që përdoret për hedhjen e mbetjeve duhet të jetë shumë e kufizuar. Të gjitha sipërfaqet e tjera joaktive duhet të mbulohen me dhé ose mbetje inerte.

Ky mbulim është shumë efikas: për të reduktuar infiltrimin e ujit të shiut, për të reduktuar infektimet nga insektet, për të ulur tërheqjen e zogjve, minjve dhe kafshëve të tjera si rezultat i mbetjeve, për të parandaluar rënien e zjarreve, për të dekurajuar, për të reduktuar ekspozimin ndaj kushteve atmosferike, për të reduktuar shtyrjen nga era të mbetjeve plastike nëpërlandfillin e mbetjeve.

Mbetjet duhet të mbulohen rregullisht me 15 cm mbetje inerte apo dhera, nëse është e mundur të bëhet çdo ditë (ose çdo javë minimumi).

Për të zbatuar mbulimin në landfill duhet të ketë material të disponueshëm. Ai mund të variojë nga materiale inerte në mbetje nga ndërtimet dhe nuk ka kërkesa specifike për to, megjithëse duhen eliminuar materiale organike apo elemente të lehta (plastika, letra etj.).

Ky mbulim mundëson qarkullimin e kamionëve të cilët ngjeshin mbetjet.

Monitorimi i ndikimit në landfillin e mbetjeve

Me qëllim që të vlerësohet nëse një landfill paraqet një risk apo jo ose nëse ka një ndikim të caktuar, nevojitet të kryhet një monitorim rutinë për të gjitha elementet e pranishme në landfillin e mbetjeve. Kjo ka si qëllim vëzhgimin sistematik të ndikimit të mundshëm të një landfilli mbetjesh dhe të organizojë masat që lidhen me ndikimin që keni vlerësuar.

Monitorimi ul riskun e neglizhimit të rreziqeve potenciale në landfillin e mbetjeve, sipër shembull:

- a) Kolapsi i brendshëm i landfillit të mbetjeve;
- b) Kolapsi i landfillit të mbetjeve,
- c) shpërthimi i digës;
- d) Përmbytja e landfillit të mbetjeve ose krijimi i “pellgjeve” në sipërfaqe; Djegia e landfillit të mbetjeve;
- e) Mbyllja e landfillit të mbetjeve për shkak se nuk ka më hapësirë të disponueshme. Lista e kontrollit për monitorimin duhet të përmbajë veprimet e mëposhtme:
- f) Monitorimi i gjendjes në tërësi të landfillit;
- g) Monitorimi i gjendjes së digës kryesore; Monitorimi i gjendjes së murit mbajtës;
- h) Monitorimi i rrjedhës brenda dhe jashtë tubave të landfillit të mbetjeve;
- i) Monitorimi i gjendjes së gardhit;
- j) Monitorimi i sistemit të kullimit; Monitorimi i sistemit të çlirimit të gazit;
- k) Monitorimi i përputhshmërisë me modelin e shtresëzimit që është vendosur për landfillin e mbetjeve;
- l) Monitorimi i pjerrësisë së sipërfaqes së mbetjeve që duhet respektuar (5–10%), me qëllim që të mundësohet largimi i rrjedhës së ujit sipërfaqësor.

Monitorimi duhet të përmblihet në një raport të thjeshtë, ku vendoset data, si dhe shënimet e

nevojshme në lidhje me pikat e përmendura më sipër.

SHTOJCA V

VLERËSIMI I SIGURISË PËR PRANIMIN E MBETJEVE NË LANDFILLET NËNTOKËSORE

1. Filozofia e sigurisë për depozitimin nëntokësor: të gjitha llojet

1.1. Rëndësia e barrierave gjeologjike

Objektivi përfundimtar i asgjësimit final të mbetjeve në depozitimet nëntokësore është izolimi i mbetjeve nga biosfera. Mbetjet, barrierat gjeologjike dhe kavitetet, përfshirë çdo lloj strukturë inxhinierike përbëjnë një sistem që duhet të përmbushë kërkesat e veta së bashku me të gjitha aspektet e tjera teknike.

Kërkesat e ligjit “Për menaxhimin e integruar të ujërave” mund të përmbushen vetëm duke demonstruar sigurinë afatgjatë të instalimit (shikoni seksionin 1.2.7). Ligji “Për menaxhimin e integruar të ujërave” në përgjithësi ndalon shkarkimin drejtpërdrejt të ndotësve në ujërat nëntokësore. Ligji kërkon, gjithashtu, që të merren masa për të parandaluar përkeqësimin e statusit të të gjithë trupave ujqorë nëntokësorë.

1.2. Vlerësimi i riskut të vendit specifik

Vlerësimi i riskut kërkon identifikimin e:

- rrezikut (në këtë rast mbetjet e depozituara);
- marrësve (në këtë rast biosfera dhe ndoshta ujërat nëntokësore);
- rrugëve nëpërmjet të cilave substancat që derivojnë nga mbetjet mund të arrijnë biosferën; dhe
- vlerësimit të ndikimit të substancave që mund të arrijnë biosferën.

Kriteret e pranimit për depozitim nëntokësor, duhet të rrjedhin nga, mes të tjerash, analiza e shkëmbit bujtës, prandaj duhet konfirmuar që në këtë vend nuk ekzistojnë kushte që kanë lidhje me ato të specifikuar në Shtojcën I të këtij vendimi (me përjashtim të Shtojcës I (2), (3), (4) dhe (5).

Kriteret e pranimit për depozitim nëntokësor mund të përftohen vetëm duke iu referuar kushteve lokale. Kjo kërkon demonstrimin e përshtatshmërisë së shtresave për krijimin e një depozitimi, d.m.th. një vlerësim të risqeve për vendin mbajtës, duke marrë në konsideratë gjithë sistemin e mbetjeve, strukturat inxhinierike dhe kavitetet dhe trupin shkëmbor bujtës.

Vlerësimi i riskut të instalimit në atë vend specifik kryhet si për fazën operacionale, ashtu edhe për atë pas operacionale. Nga këto vlerësime, mund të nxirren masat e sigurisë dhe të kontrollit të kërkuar dhe mund të zhvillohen kriteret e pranimit.

Do të përgatitet analiza e integruar e vlerësimit të performancës që përfshin komponentët e mëposhtëm:

1. vlerësimin gjeologjik;
2. vlerësimin gjeomekanik;
3. vlerësimin hidrogeologjik;
4. vlerësimin gjeokimik;
5. vlerësimin e ndikimit në biosferë;
6. vlerësimin e fazës operacionale;
7. vlerësimin afatgjatë;
8. vlerësimin e ndikimit të të gjitha impianteve sipërfaqësore në këtë vend.

1.2.1. Vlerësimi gjeologjik

Për formacionin gjeologjik të vendit të depozitimit kërkohet njohuri apo investigim i plotë. Kjo përfshin investigimet dhe analizat e llojeve të shkëmbinjve, tokës dhe topografisë. Vlerësimi gjeologjik duhet të demonstrojë përshtatshmërinë e vendit për depozitim nëntokësor. Ai duhet të përfshijë vendndodhjen, frekuencën dhe strukturën e çdo lloj defekti apo frakturimi në shtresat rrethuese gjeologjike dhe ndikimin potencial të aktivitetit sizmik në këto struktura. Duhet marrë në konsideratë edhe vende të tjera alternative.

1.2.2. Vlerësimi gjeomekanik

Qëndrueshmëria e kaviteve duhet demonstruar nëpërmjet investigimeve dhe parashikimeve të përshtatshme. Mbetjet e depozituara duhet të jenë pjesë e këtij vlerësimi. Proceset duhet të analizohen dhe dokumentohen në mënyrë sistematike.

Duhet demonstruar sa më poshtë vijon:

1. që gjatë dhe pas krijimit të kaviteve, nuk pritet të ndodhë ndonjë deformim madhor te vetë kaviteti apo në sipërfaqen e tokës, gjë që do të pengonte përdorueshmërinë e depozitës nëntokësore ose do të krijonte një mundësi kalimi për në biosferë;
2. që kapaciteti bartës i kavitetit është i mjaftueshëm për të parandaluar shembjen e tij gjatë operacionit;
3. që materialet e depozituara duhet të kenë qëndrueshmërinë e nevojshme në përputhje me vetitë gjeomekanike të shkëmbit bujtës.

1.2.3. Vlerësimi hidrogeologjik

Kërkohet investigimi i plotë i vetive hidraulike për të vlerësuar modelin e rrjedhës së ujërave nëntokësore në shtresat rrethuese bazuar në informacionin mbi konduktivitetin hidraulik të masës shkëmbore, frakturave dhe gradientëve hidraulikë.

1.2.4. Vlerësimi gjeologjik

Kërkohet investigimi i plotë i shkëmbit dhe përbërjes së ujërave nëntokësore me qëllim vlerësimin e përbërjes aktuale të ujërave nëntokësore dhe evolucionin e tyre potencial në kohë, natyrën dhe pasurinë (bollshmërinë) me minerale frakturë mbushëse, si edhe përshkrimin sasiore mineralor të shkëmbit bujtës. Duhet vlerësuar ndikimi i ndryshueshmërisë në sistemin gjeokimik.

1.2.5. Vlerësimi i ndikimit në biosferë

Kërkohet investigimi i biosferës që mund të ndikohej nga depozitimi nëntokësor. Duhet kryer studime bazë për të përcaktuar nivelet e rrethanave natyrore lokale të substancave përkatëse.

1.2.6. Vlerësimi i fazës operacionale

Për fazën operacionale, analiza duhet të demonstrojë sa më poshtë vijon:

1. qëndrueshmërinë e kaviteve, siç përcaktohet në seksionin 1.2.2 të kësaj shtojce;
2. asnjë risk të papranueshëm të rrugëkalimit së përshkruar midis mbetjeve dhe biosferës;
3. asnjë risk të papranueshëm që ndikon në funksionimin e impiantit.

Në rastet e demonstrimit të sigurisë operacionale, duhet kryer një analizë sistematike e operacionit të impiantit në bazë të të dhënave specifike mbi inventarin e mbetjeve, menaxhimit të impiantit dhe skemës së operimit. Duhet treguar që mbetjet nuk do të ndërveprojnë me shkëmbin në ndonjë mënyrë kimike apo fizike, gjë e cila do të dëmtonte forcën dhe ngurtësinë e shkëmbit dhe do të rrezikonte vetë depozitimin. Për këto arsye, përveç mbetjeve që ndalohen nga neni 43/1 i ligjit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, nuk duhet të pranohen as mbetjet që kanë predispozicion për t'u djegur spontanisht nën kushtet e depozitimit (temperatura,

lagështira), produktet e gazta, mbetjet e avullueshme, mbetjet që vijnë nga grumbuj përzierjesh të paidentifikuara.

Duhet identifikuar incidentet e veçanta që në fazën operacionale mund të çojnë në krijimin e një rrugëkalimi midis mbetjeve dhe biosferës. Llojet e ndryshme të risqeve potenciale operacionale duhen përmbledhur në kategori specifike. Duhet vlerësuar efektet e tyre të mundshme. Duhet treguar se nuk ekziston asnjë risk i papranueshëm që të prishet kontrolli i operacionit. Duhet të jepen masat e emergjencës.

1.2.7. Vlerësimi afatgjatë

Me qëllim që të respektohen objektivat e asgjësimit të qëndrueshëm në landfill, vlerësimi i riskut duhet të bëhet për periudha afatgjata. Duhet siguruar që nuk do të krijohet asnjë rrugëkalim për në biosferë gjatë periudhës afatgjatë pasoperacionit të depozitimit nëntokësor.

Barrierat e vendit të depozitimit nëntokësor (p.sh. cilësia e mbetjeve, strukturat inxhinierike, mbushja dhe mbyllja e tubave dhe shpimeve), performanca e shkëmbit bujtës, shtresat rrethuese dhe mbingarkesa duhet të përlllogariten në mënyrë sasiore për një periudhë afatgjatë dhe të vlerësohen në bazë të të dhënave të vendit specifik ose supozimeve mjaftueshmërisht konservative. Duhet marrë në konsideratë kushtet gjeokimike dhe gjeohidrologjike, të tilla si rrjedha e ujërave tokësorë (shikoni seksionet 1.2.3 dhe 1.2.4 të kësaj shtojce), efica e barrierës, pakësimi natyror, si edhe kullimi i lëngjeve nga mbetjet e depozituara.

Siguria afatgjatë e një depozitimi nëntokësor duhet demonstruar nga vlerësimi i sigurisë, përfshirë përshkrimin e statusit fillestar në një kohë të specifikuar (p.sh. koha e mbylljes) pasuar nga një skenar që nxjerr në pah ndryshimet e rëndësishme që priten përgjatë kohës gjeologjike. Përfundimisht, pasojat e çlirimit të substancave përkatëse nga depozitimi nëntokësor duhet të vlerësohen për skenarë të ndryshëm që reflektojnë evolucionin afatgjatë të biosferës, gjeosferës dhe depozitimit nëntokësor.

Për shkak të jetëgjatësisë së tyre të kufizuar konteinerët dhe shtresa e kavitetit nuk duhet të merren në konsideratë kur vlerësohen risqet afatgjata të depozitave të mbetjeve.

1.2.8. Vlerësimi i ndikimit të impianteve marrëse sipërfaqësore

Megjithëse mbetjet e marra në atë vend mund të jenë të destinuara për asgjësim nësipërfaqësor, ato do të shkarkohen, testohen dhe mundësisht të depozitohen mbi sipërfaqe, para se të arrijnë në destinacionin e tyre final. Impiantet marrëse duhet të projektohen dhe operohen në mënyrë të tillë që parandalon dëmtimin e shëndetit të njeriut dhe mjedisit lokal. Ato duhet të plotësojnë të njëjtat kërkesa si çdo lloj tjetër impianti marrës mbetjesh.

1.2.9. Vlerësimi i risqeve

Me qëllim mbrojtjen e punëtorëve, mbetjet duhet të depozitohen vetëm në depozitimin nëntokësor të veçuar në mënyrë të sigurt nga aktivitetet minerare. Mbetjet nuk duhet të pranohen n.q.s. përmbajnë ose mund të gjenerojnë substance të rrezikshme që mund të dëmtojnë shëndetin e njeriut, p.sh. mikrobet patogjene të sëmundjeve ngjitëse.

2. Kriteret e pranimit për depozitim nëntokësor – të gjitha llojet

2.1. Mbetjet e përjashtuara

a) Nën dritën e seksioneve 1.2.1 deri 1.2.8, mbetjet që mund t'i nënshtrohen transformimeve të padëshiruara fizike, kimike ose biologjike pasi të jenë depozituar, nuk duhet të asgjësohen në landfillin nëntokësor. Këtu përfshihen sa më poshtë:

b) mbetjet e listuara në nenin 35 të ligjit të menaxhimit të integruar të mbetjeve;

c) mbetjet dhe përbërësit e tyre që mund të hyjnë në reaksion me ujin ose shkëmbin bujtës nën kushtet e depozitimit nëntokësor dhe që mund të çojnë në:

- ndryshimin e vëllimit;

- gjenerimin e substancave apo gazrave të vetëpërflakshëm, toksikë ose shpërthyes; ose
- çdo reaksion tjetër që mund të rrezikojë sigurinë operacionale dhe/ose integritetin e barrierës.

Mbetjet që mund të hyjnë në reaksion me njëra tjetrën duhet të përcaktohen dhe të klasifikohen në grupet e përputhshmërisë; grupet e ndryshme që nuk përputhen duhet të ndahen fizikisht në depozitim;

- a) mbetjet që janë të biodegradueshme;
- b) mbetjet që kanë erë të fortë;
- c) mbetjet që mund të gjenerojnë një përzierje ajër-gaz që është toksike ose shpërthyes.

Në mënyrë të veçantë kjo i referohet mbetjeve që:

- shkaktojnë përqendrime gazi toksik në sajë të trysnisë së pjesshme të përbërësve të tyre,
- formojnë përqendrime kur saturohen brenda një konteneri, të cilat janë më të larta se

10 % e përqendrimit që korrespondon me kufirin e ulët shpërthyes;

d) mbetjet me qëndrueshmëri të pamjaftueshme për t'ju përshtatur kushteve gjeomekanike;

e) mbetjet e vetëpërflakshme ose të predispozuara për t'u djegur spontanisht nën kushtet e depozitimit, produktet e gazta, mbetjet e avullueshme, mbetjet që vijnë nga grumbuj përzierjesh të paidentifikuara.

f) mbetjet që përmbajnë, ose mund të gjenerojnë mikrobe patogjene të sëmundjeve ngjitëse.

2.2. Vlerësimi i riskut të vendit specifik

Pranimi i mbetjeve në një vend specifik duhet t'i nënshtrohet vlerësimit të riskut të atij vendi specifik.

Vlerësimet e vendit specifik të raviguara në seksionin 1.2 për mbetjet që do të pranohen në një depozitim nëntokësor duhet të demonstrojnë që niveli i izolimit nga biosfera është i pranueshëm. Kriteret duhet të përmbushen nën kushtet e depozitimit.

2.3 Kushtet e pranimit

Mbetjet mund të depozitohen vetëm në një depozitim nëntokësor të veçuar, në mënyrë të sigurt nga aktivitetet minerare.

Mbetjet që mund të hyjnë në reaksion me njëra tjetrën duhet të përcaktohen dhe të klasifikohen në grupet e përputhshmërisë; grupet e ndryshme që nuk përputhen duhet të ndahen fizikisht në depozitim.

3. Konsiderata shtesë: minierat e kripës

3.1. Rëndësia e barrierave gjeologjike

Në filozofinë e sigurisë për minierat e kripës, shkëmbi që rrethon mbetjet ka një rol të dyfishtë:

- vepron si shkëmb bujtës në të cilin mbetjet futen si në një mburojë;
- së bashku me shtresat e papërshkrueshme shkëmbore të sipërme dhe të poshtme (p.sh. anhidritet), vepron si barrierë gjeologjike që synon të parandalojë hyrjen e ujërave nëntokësore në landfill dhe, ku është e nevojshme, të ndalojë në mënyrë të efektshme lëngjet ose gazrat të dalin nga zona e asgjësimit. Në rastet kur kjo barrierë gjeologjike është dëmtuar nga tubat dhe pusët, ato duhet të mbyllen gjatë operimit në mënyrë që të pengohet hyrja e ujit, dhe duhet të jenë të mbyllura hermetikisht pasi landfilli nëntokësor të pushojë së operuari. N.q.s. nxjerrja e mineraleve vazhdon për një kohë më të gjatë se operimi i landfillit, zona e asgjësimit të mbetjeve, pasi landfilli të ketë pushuar së operuari duhet të mbyllet me një digë të papërshkrueshme hidraulikisht, e cila ndërtohet sipas trysnisë operuese hidraulike të llogaritur që i korrespondon thellësisë, në mënyrë të tillë që uji që mund të rrjedhë në minierën që është

ende operationale, të mos mund tëpenetrojë në zonën e landfillit;

- në minierat e kripës, kripa konsiderohet se siguron kontroll total. Mbetjet do të kenë kontakt me biosferën vetëm në rastin e një aksidenti ose të një ngjarje në kohë gjeologjike siç është lëvizja e tokës ose erozioni (për shembull, e lidhur me ngritjen e nivelit të detit). Mbetjet nuk kanë gjasa të ndryshojnë në landfill, dhe pasojat e skenarëve të tillë të dështimit duhet të merren në konsideratë.

3.2. Vlerësimi afatgjatë

Demonstrimi i sigurisë afatgjatë të asgjësimit nëntokësor në një shkëmb kripor duhet të ndërmerret parimisht duke e përcaktuar shkëmbin kripor si shkëmb barrierë. Shkëmbi kripor përmbush kërkesën e papërshkrisë ndaj gazrave dhe lëngjeve, të mbështjelljes së mbetjeve në sajë të konvergjençës së tij dhe të kufizimit plotësisht të mbetjeve në fund të procesit të transformimit.

Konvergjenca e shkëmbit kripor nuk kontradikton kërkesën për të pasur kavitate të qëndrueshme në fazën e operimit. Qëndrueshmëria është e rëndësishme për të garantuar sigurinë operationale dhe mirëmbajtjen e integritetit të barrierave gjeologjike për një kohë të pakufizuar në mënyrë që të sigurojë mbrojtje të vazhdueshme të biosferës. Mbetjet duhen izoluar në mënyrë të përhershme nga biosfera. Rrëshqitja/fundosja e kontrolluar e mbingarkesës ose defekte të tjera në periudha të gjata kohore janë të pranueshme vetëm nëqse mund të tregohet se do të ndodhin vetëm transformime pa çarje, se integriteti i barrierës gjeologjike mirëmbahet dhe se nuk formohet asnjë rrugëkalim nëpërmjet të cilit uji do të mund të kontaktonte mbetjet apo mbetjet apo përbërësit e mbetjeve do të mund të migronin në biosferë.

4. Konsiderata shtesë: shkëmbi i fortë

Depozitimi i thellë në shkëmb të fortë këtu përkufizohet si një depozitim nëntokësor në thellësi disa qindra metra, ku shkëmbi i fortë përfshin shkëmbinj vullkanik, p.sh. granit ose gneise, gjithashtu mund të përfshijë shkëmbinj sedimentarë, p.sh. gur gëlqeror dhe gur ranor.

4.1. Filozofia e sigurisë

Depozitimi i thellë në një shkëmb të fortë është një mënyrë praktike për të shmangur brezat e ardhshëm nga përgjegjësia për mbetjet meqë do të ndërtohet për të qenë pasiv dhe nuk do të ketë nevojë për mirëmbajtje. Për më tepër, ndërtimi nuk do të pengojë rikuperimin e mbetjeve ose mundësinë për të ndërmarrë masa korrektuese në të ardhmen. Gjithashtu ai duhet projektuar në mënyrë të tillë që të sigurojë që efektet negative apo përgjegjësitë mjedisore që rrjedhin nga aktivitetet e brezave të sotëm, të mos bien mbi brezat e ardhshëm.

Në filozofinë e sigurisë së asgjësimit nëntokësor të mbetjeve, koncepti kryesor është izolimi i mbetjeve nga biosfera, si edhe pakësimi natyror i çdo lloji ndotësi që kullon nga mbetjet. Për lloje të caktuara substancash dhe mbetjesh të rrezikshme, është identifikuar nevoja për të mbrojtur shoqërinë dhe mjedisin nga ekspozimi i qëndrueshëm përgjatë periudhave të stërzgjatura kohore. Një periudhë kohore e stërzgjatur nënkupton disa mijëra vjet. Nivele të tilla mbrojtjeje mund të arrihen nëpërmjet depozitimit të thellë në shkëmb të fortë. Depozitimi i thellë i mbetjeve në shkëmb të fortë mund të bëhet ose në një ish-minierë, ku aktiviteti i nxjerrjes së mineraleve ka përfunduar, ose në një impiant të ri depozitimi.

Në rastin e depozitimit në shkëmb të fortë, nuk është i mundur kontrolli total. Në këtë rast, depozitimi nëntokësor duhet ndërtuar në mënyrë të tillë që hollimi natyror i shtresave rrethuese të ndërmjetësorë efektin e ndotësve në atë masë që ato të mos kenë efekte negative të pakthyeshme në mjedis. Kjo do të thotë që kapaciteti i mjedisit të afërt për të pakësuar dhe degraduar ndotësit do të përcaktojë pranueshmërinë e shkarkimit/çlirimit të ndotësve nga një impiant i tillë.

Kërkesat e të ligjit të menaxhimit të integruar të ujerave mund të përmbushen vetëm duke demonstruar sigurinë afatgjatë të instalimit (shikoni seksionin 1.2.7). Performanca e një sistemi depozitimi të thellë duhet vlerësuar në mënyrë holistike, duke shpjeguar funksionin koherent të përbërësve të ndryshëm të sistemit. Ligji i menaxhimit të integruar të ujerave ndalon në përgjithësi, shkarkimin e ndotësve drejtpërdrejt në ujërat nëntokësore. Ligji kërkon gjithashtu që të merren masa që të parandalohet përkeqësimi i statusit të të gjithë trupave ujorë nëntokësorë. Për depozitimin e thellë në shkëmb të fortë kjo kërkesë respektohet kur asnjë shkarkim i substancave të rrezikshme nga depozitimi nuk arrin biosferën (përfshirë pjesët e sipërme të sistemit të ujerave nëntokësore të aksesueshme për biosferën) në sasi apo përqendrime që shkaktojnë efekte negative. Për këtë arsye duhet të vlerësohen rrugëkalimet e ujit në dhe për në biosferë. Duhet vlerësuar ndikimi i ndryshueshmërisë në sistemin gjeohidraulik.

Formimi i gazit në depozitimin e thellë në shkëmb të fortë mund të ndodhë për shkak të prishjes afatgjatë të mbetjeve, ambalazhimit dhe strukturave inxhinierike. Për këtë arsye, kjo gjë duhet marrë në konsideratë në projektimin e vendit për depozitimin e thellë në shkëmb të fortë.

SHTOJCA VI

PËRMBLEDHJE E OPSIONEVE TË ASGJËSIMIT NË LANDFILL TË PËRCAKTUARA NGA KY VENDIM

Hyrje

Figura 1 pasqyron një përmbledhje të opsioneve për asgjësimin në landfill të mbetjeve siç përcaktohen nga ky vendim së bashku me disa shembuj të nënkategorive të kategorive kryesore të landfilleve. Pika e fillimit (këndi i majtë sipër) përfaqëson një mbetje që duhet të asgjësohet në landfill. Në përputhje me nenin 34 të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, para asgjësimit në landfill për shumicën e mbetjeve kërkohet të bëhen disa trajtime. Përkufizimi i përgjithshëm i “trajtimit” është relativisht i gjerë dhe në një masë të madhe i është lënë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Mbetja nuk i përket asnjë prej kategorive të listuara në nenin 34 të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

1. Landfillet e mbetjeve inerte

Pyetja e parë që lind është nëse mbetja mund të klasifikohet ose jo si e rrezikshme. Nëse mbetja nuk është e rrezikshme (sipas ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe listës aktuale të mbetjeve), pyetja tjetër që lind është nëse mbetja mund të jetë mbetje inerte apo jo.

N.q.s. plotëson kriteret e mbetjeve që mund të asgjësohen në një landfill mbetjesh inerte (kategoria A, shihni figurën 1 dhe tabelën 1), mbetja mund të vendoset në një landfill për mbetjet inerte.

Mbetjet inerte mund të vendosen edhe në landfillet e mbetjeve jo të rrezikshme me kusht që të plotësojnë kriteret e përshtatshme (që në përgjithësi duhet t’i plotësojnë).

2. Landfillet e mbetjeve jo të rrezikshme dhe nënkategoritë e tyre

Nëse mbetjet nuk janë të rrezikshme apo inerte, d.m.th. jo të rrezikshme, duhet të shkojnë në landfillin e mbetjeve jo të rrezikshme.

Tri nënkategoritë kryesore të landfilleve për mbetjet jo të rrezikshme tregohen në figurën 1: landfilli për mbetjet inorganike me përmbajtje të ulët organike/të biodegradueshme (B1), landfilli për mbetjet organike (B2) dhe landfilli për mbetjet e përziera jo të rrezikshme me përmbajtje të konsiderueshme materialesh si organike/të biodegradueshme ashtu edhe inorganike. Vendet e nënkategorisë B1 mund të ndahen më tej në vende për mbetjet që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në seksionin 2.2.2 për mbetjet jo të rrezikshme inorganike që

mund të asgjësohen bashkë me mbetjet e rrezikshme të qëndrueshme jo reaktive (B1a) dhe vende për mbetjet që i plotësojnë këto kritere (B1b). Vendet e nënkategorisë B2 mund, për shembull, të ndahen më tej në landfille bioreaktive dhe landfille për mbetje më pak reaktive, të trajtuara biologjikisht. Monofillet dhe landfillet për mbetjet e ngurtësuara/monolite mund të përcaktohen brenda çdo nënkategorie (shikoni shënimin në fund të faqes poshtë tabelës 1).

Të gjitha mbetjet jo të rrezikshme (subjekt i klauzolave të nenit 34 të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, dhe paragrafit 3 të këtij vendimi) mund të shkojnë në landfillin për mbetjet jo të rrezikshme të përziera (nënkategoria B3).

3. Vendosja e mbetjeve të rrezikshme të qëndrueshme jo reaktive në landfillin e mbetjeve jo të rrezikshme

N.q.s. mbetjet janë të rrezikshme, përmes trajtimit të tyre mund të bëhet e mundur që ato të mund të plotësojnë kriteret për vendosjen e mbetjeve të rrezikshme të qëndrueshme jo reaktive në landfillet e mbetjeve jo të rrezikshme brenda qelizave të ngushta për mbetjet inorganike me përmbajtje të ulët organike/të biodegradueshme që plotësojnë kriteret në seksionin 2.2.2 (nënkategoria B1b). Mbetjet mund të jenë granulore (të bëra kimikisht të qëndrueshme) ose të ngurtësuara/monolite.

4. Landfillet e mbetjeve të rrezikshme

Nëse mbetjet e rrezikshme nuk plotësojnë kriteret për vendosjen në një landfill të kategorisë B1b apo qelizë për mbetjet jo të rrezikshme, pyetja tjetër mund të jetë nëse ato i plotësojnë ose jo kriteret për pranim në landfillin e mbetjeve të rrezikshme (kategoria C). Nëse kriteret plotësohen, atëherë mbetjet mund të vendosen në landfillin e mbetjeve të rrezikshme.

Nëse kriteret për pranim në landfillin e mbetjeve të rrezikshme nuk plotësohen, mbetjet mund t'i nënshtrohen trajtimit të mëtejshëm dhe të testohen përsëri kundrejt kriterëve, deri sa ato të plotësohen.

5. Depozitimi nëntokësor

Në mënyrë alternative, mbetjet mund të testohen kundrejt kriterëve për depozitimin nëntokësor. Nëse plotësohen kriteret, mbetjet mund të shkojnë në një impiant depozitimi nëntokësor për mbetjet e rrezikshme (kategoria e landfillit DHAZ). Nëse nuk plotësohen kriteret e depozitimit nëntokësor, mbetjet mund t'i nënshtrohen trajtimit të mëtejshëm dhe të testohen përsëri.

Megjithëse depozitimi nëntokësor ka mundësi të rezervohet për mbetje të rrezikshme speciale, kjo nënkategori, në parim, mund të përdoret gjithashtu edhe për mbetjet inerte (kategoria DINERT) dhe mbetjet jo të rrezikshme (kategoria DNON-HAZ).

Diagrami më poshtë tregon opsionet e asgjësimit në landfill të përcaktuara nga ky vendim.

Pasqyra e kategorive të landfillit dhe shembuj të nënkategorive.

Kategoria e landfillit	Nënkategoritë madhore (impiantet e depozitimit nëntokësor, monofillet dhe landfillet për mbetjet e ngurtësuarra monolite (*) të mundshme për të gjitha kategoritë e landfillit)	Identifikimi	Kriteret e pranimit
Landfilli i mbetjeve inerte	Landfilli që pranon mbetjet inerte	A	Kriteret për kullimin e lëngjeve nga landfilli dhe përmbajtjen përbërësve organikë janë përcaktuar (seksioni 2.1.2). Kriteret për përmbajtjen e komponentëve inorganikë duhen përcaktuar.
Landfilli i mbetjeve jo të rrezikshme	Landfilli për mbetjet jo të rrezikshme inorganike me përmbajtje të ulët lëndësh organike/të biodegradueshme, në rastet kur mbetjet nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në seksionin 2.2.2. për ato mbetje inorganike jo të rrezikshme që mund të asgjësohen në landfill së bashku me mbetjet e rrezikshme të qëndrueshme jo reaktive	B1a	Kriteret për kullimin e lëngjeve nga landfilli dhe përmbajtjen totale
	Landfilli për mbetjet jo të rrezikshme inorganike me përmbajtje të ulët lëndësh organike/të biodegradueshme	B1b	Kriteret për kullimin e lëngjeve nga landfilli dhe përmbajtjen e karbonit organik total (TOC) dhe veçoritë e tjera janë përcaktuar të përbashkëta për mbetjet granulare jo të rrezikshme dhe mbetjet e qëndrueshme të rrezikshme jo reaktive (seksioni 2.2). Gjithashtu, për këtë të fundit, janë përcaktuar edhe kriteret shtesë të qëndrueshmërisë. Kriteret për mbetjet monolite duhen përcaktuar

Landfilli për mbetjet organike jo të rrezikshme	B2	Kriteret për kullimin e lëngjeve nga landfilli dhe përmbajtjen totale
Landfilli për mbetjet e përziera jo të rrezikshme me përmbajtje të konsiderueshme si të mbetjeve organike/të biodegradueshme ashtu edhe të mbetjeve inorganike.	B3	Kriteret për kullimin e lëngjeve nga landfilli dhe përmbajtjen totale

Landfilli i Mbetjeve të rrezikshme	Landfilli sipërfaqësor për mbetjet e rrezikshme	C	Kriteret për kullimin e lëngjeve nga landfilli për mbetjet granulare të rrezikshme dhe përmbajtjen totale të disa komponentëve janë përcaktuar (seksioni 2.4). Kriteret për mbetjet monolite duhen përcaktuar. Kriteret shtesë për përmbajtjen e ndotësve duhen përcaktuar.
	Vendi i depozitimit nëntokësor	DHAZ	Kërkesat e veçanta janë listuar në Shtojcën III.

(*) Nënkatëgoritë e mbetjeve monolite kanë lidhje vetëm me B1, C dhe DHAZ, dhe ndoshta A.

SHTOJCA VII

METODOLOGJIA PËR LLOGARITJEN E GARANCISË FINANCIARE PËR MBYLLJEN DHE KUJDESIN PAS MBYLLJES SË LANDFILLEVE

Kjo metodologji përcakton mënyrën e llogaritjes së vlerës minimale të garancisë financiare që operatori i landfillit është i detyruar të depozitojë për:

- mbylljen teknike të landfillit;
- monitorimin dhe mirëmbajtjen pas mbylljes për një periudhë jo më pak se 30 vjet;
- rehabilitimin mjedisor;
- ndërhyrjet emergjente.

1. Elementët përbërës të kostos

Garancia (G) përbëhet nga këto elementë:

- K_1 – Kosto e mbylljes teknike;
- K_2 – Kosto e monitorimit 30-vjeçar;
- K_3 – Kosto e trajtimit të lëngjeve kulluese dhe gazrave pas mbylljes;
- K_4 – Kosto e rehabilitimit mjedisor;
- K_5 – Fondi i rrezikut për emergjenca mjedisore;
- I – Indeksi i inflacionit.

2. Formula bazë dhe të detajuara për përlllogaritjen e secilit element të garancisë

Formula baze e garancise $G = (K_1 + K_2 + K_3 + K_4 + K_5) \times I$

Formula të detajuara për secilin komponent

2.1 Kosto e mbylljes teknike (K_1)

$$K_1 = A \times C_m$$

A = sipërfaqja e landfillit (m^2)

C_m = kosto mesatare për mbyllje teknike (EUR/ m^2), sipas çmimeve të miratuara nga ministria

2.2 Kosto e monitorimit 30-vjeçar (K_2)

$$K_2 = (C_u + C_a + C_g + C_r) \times 30$$

C_u = kosto vjetore e monitorimit të ujërave

C_a = kosto e monitorimit të ajrit

C_g = kosto e monitorimit të gazrave

C_r = kosto e mirëmbajtjes strukturore

2.3 Kosto e trajtimit të lëngjeve kulluese dhe gazrave (K_3)

$$K_3 = Q_l \times C_l \times T$$

Q_l = sasia vjetore e lëngjeve kulluese (m^3)

C_l = kosto për trajtimin e 1 m^3

T = 30 vjet minimum

2.4 Kosto e rehabilitimit mjedisor (K_4)

$$K_4 = A \times Crm$$

Crm = kosto mesatare e rehabilitimit për m²

2.5 Fondi i rrezikut për emergjenca (K₅)

$$K_5 = 15\% \text{ e } (K_1 + K_2 + K_3 + K_4)$$

2.6 Indeksimi i inflacionit (I)

$$I = (1 + \text{inflacioni vjetor mesatar})^{30}$$

SHTOJCA VIII
PROCEDURA, DOKUMENTACIONI DHE PËRDORIMI I GARANCISË DHE I
SIGURACIONIT

A. Garancia për mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes

1. Dokumentacioni për vendosjen e garancisë financiare

Operatori depoziton pranë AKM:

- Studimin teknik të mbylljes;
- Studimin e monitorimit 30-vjeçar;
- Preventivin financiar sipas Aneksit xx (1)?;
- Kontratën e garancisë bankare;
- Sigurimin shtesë për katastrofa;
- Planin e emergjencës mjedisore.

2. Procedura e miratimit

- AKM verifikon dokumentacionin brenda 45 ditëve.
- Ministria nxjerr akt miratimi.
- Pa këtë akt nuk jepet leja mjedisore/miratimi për mbylljen e landfillit.

3. Administrimi financiar

Garancia financiare lëshohet nga një bankë e nivelit të dytë e licensuar nga BSH ose depozitohet shuma e përlogaritur e garancisë në një llogari *escroë*:

4. Aktivizimi/ përdorimi i siguracionit

Siguracioni aktivizohet me vendim të ministrit në rast:

- falimentimi;
- braktisje e veprimtarisë;
- ndotje e rëndë;
- mosmbyllje në afat;
- rrezik për jetën.

SHTOJCA IX

REGJIMI OPERACIONAL DHE KATEGORIZIMI I LANDFILL-EVE

1. Qëllimi

Ky aneks përcakton mënyrën e funksionimit, kategoritë, nënkategoritë dhe kriteret për pranimin e mbetjeve në landfill-et ekzistuese dhe të reja, në përputhje me këtë vendim dhe në zbatim të nenit 14/1 për landfill-et ekzistuese.

Ky aneks zbatohet:

- për landfill-et në operim;
- për landfill-et ekzistuese në periudhë tranzicioni;
- për landfill-et në proces mbylljeje dhe kujdesi pas mbylljes.

2. Klasifikimi i landfill-eve dhe nënkategorive

Kategoria	Nënkategoria	Përshkrimi	Kriteret e pranimit
Landfill i mbetjeve inerte	A	Landfill që pranon vetëm mbetje inerte	Kriteret përcaktohen sipas këtij vendimi dhe anekseve përkatëse për pranimin e mbetjeve
Landfill i mbetjeve jo të rrezikshme	B1a	Mbetje inorganike me përmbajtje të ulët organike që nuk plotësojnë kriteret për B1b	Kriteret e pranimit përcaktohen sipas këtij vendimi dhe anekseve përkatëse
	B1b	Mbetje inorganike me përmbajtje të ulët organike që plotësojnë kriteret për mbetje të qëndrueshme jo reaktive	Kriteret e pranimit dhe testimit përcaktohen sipas këtij vendimi
	B2	Mbetje organike jo të rrezikshme	Kriteret e pranimit përcaktohen sipas këtij vendimi
	B3	Mbetje të përziera jo të rrezikshme	Kriteret e pranimit përcaktohen sipas këtij vendimi
Landfill i mbetjeve të rrezikshme	C	Landfill për të mbetje rrezikshme	Kriteret e pranimit përcaktohen sipas këtij vendimi dhe kërkesave për mbetjet e rrezikshme
Depozitim nëntokësor	DHAZ	Depozitim për mbetje të	Kriteret dhe kërkesat përcaktohen sipas këtij

		rrezikshme dhe kategori të tjera sipas rastit	vendimi dhe anekseve përkatëse
--	--	---	--------------------------------

3. Trajtimi dhe pranimi i mbetjeve

- Të gjitha mbetjet i nënshtrohen trajtimit përpara depozitimit në landfill, në përputhje me këtë vendim.
- Pranimi i mbetjeve në landfill kryhet vetëm nëse:
 - klasifikohen sipas kategorive të këtij Aneksi;
 - plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara në këtë vendim;
 - janë të shoqëruara me dokumentacionin përkatës teknik dhe mjedisor.
- Procedurat e kontrollit dhe vetëmonitorimit zbatohen në përputhje me **Shtojcën III të këtij vendimi**.

4. Regjimi operacional për landfill-et ekzistuese (lidhje me nenin 14/1)

- Landfill-et ekzistuese i nënshtrohen një regjimi të veçantë tranzitor, në përputhje me **nenin 14 dhe nenin 14/1 të këtij vendimi**.
- Operatori është i detyruar të:
 - hartojë plan përmirësimi;
 - klasifikojë mbetjet sipas këtij Aneksi;
 - përcaktojë masat teknike për përputhshmëri graduale me këtë vendim.
- Plani i përmirësimit:
 - bazohet në këtë Aneks IX;
 - integrohet në lejen e mjedisit;
 - është detyruar për zbatim.

5. Monitorimi dhe kontrolli

- Monitorimi i landfill-eve:
 - gjatë operimit;
 - gjatë mbylljes;
 - gjatë kujdesit pas mbylljes, kryhet në përputhje me **Shtojcën III të këtij vendimi**.
- Për landfill-et ekzistuese:
 - programi i monitorimit përcaktohet në planin e përmirësimit;
 - përfshin minimalisht monitorimin e ujërave, ajrit, gazrave dhe stabilitetit të landfillit.

6. Trajtimi i mbetjeve që nuk plotësojnë kriteret

- Në rast se mbetjet nuk plotësojnë kriteret e pranimit:
 - ato nuk pranohen në landfill;
 - i nënshtrohen trajtimit të mëtejshëm;
 - rivlerësohen për pranueshmëri.
- Ky proces dokumentohet dhe kontrollon nga autoriteti kompetent.

7. Lidhja me dispozitat për garancitë financiare dhe mbylljen

- Masat për mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes së landfill-eve zbatohen në përputhje me dispozitat e këtij vendimi.
- Garancia financiare për mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes:
 - llogaritet sipas metodologjisë së përcaktuar në Shtojcën VII të këtij vendimi;
 - përfshin kostot për mbylljen teknike, monitorimin afatgjatë, trajtimin e lëngjeve kulluese dhe gazrave, rehabilitimin mjedisor dhe fondin e emergjencës.
- Procedurat për vendosjen, administrimin dhe aktivizimin e garancisë financiare, zbatohen në përputhje me Shtojcën VIII të këtij vendimi.
- Për landfill-et ekzistuese:
 - garancia financiare përcaktohet në kuadër të planit të përmirësimit;
 - llogaritet dhe përditësohet sipas kërkesave të Shtojcës VII;
 - është pjesë e detyrueshme e lejes së përditësuar të mjedisit.